

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje të sigurisë - 4

ÇËSHTJE TË SIGURISË *Security Issues*

Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Nr. 4, verë 2007

Bordi botues:***Kryetar***

Gj. Lt. (rez.) Pëllumb Qazimi

Anëtarë

Prof. dr. Dhori Karaj – Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale

Franko Egro – Publicist, Kryeredaktor i TV Koha

Agri Verrija – Këshilltar i Kryeministrit

Sotiraq Hroni – Drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Konsulentë

Geron Kamberi – M.A. në Studime Evropiane

Artan Karini – M.A. në Administrim Publik

Redaktor Përgjegjës

Enis Sulstarova – M. Sc. Shkenca Politike dhe Administrim Publik

*Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare
të Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s në Bruksel dhe të
Shtëpisë Botuese Toena*

PËRMBAJTJA

Gjergji Vurmo Enis Sulstarova Perceptime shqiptare për integrimin në NATO	7
<i>Në fokus të këtij numri: Demokracia e brendshme në forcat e armatosura</i>	<i>27</i>
Bordi botues Realiteti i demokracisë së brendshme në FA	27
Kol. Skënder Kadiu Përfaqësia e ushtarakëve si formë e “sindikalizmit” në forcat e armatosura italiane	29
Arben Zani Shoqata e ushtarakëve gjermanë	41
Leo Michel Vendimmarrja në NATO: Si funksionon “rregullorja e konsensusit?”	48
Gary King Christopher J. L Murray	67
Rikonsiderimi i sigurisë njerëzore (II)	67
UNDP& DCAF Rekomandime për përmirësimin e drejtimit dhe kontrollit demokratik të sektorit të sigurisë	88

Kol. (Rez.) Dr. Kudret Mita

Zgjerimi i njohurive mbi aleancën e Atlantikut të Veriut me
anë të ribotimit të manualit të NATO-s 115

Roland Tashi

Siguria, e nevojshme kudo, e domosdoshme
për të gjithë 150

English summary 157

Gjergji Vurmo
Enis Sulstarova

PERCEPTIME SHQIPTARE PËR INTEGRIMIN NË NATO

Hyrje

Në fillimin e viteve 1990 Shqipëria ishte e para midis vendeve ish-komuniste që aplikoi për anëtarësi në NATO. Qysh atëherë elita politike dhe intelektuale janë zotuar vazhdimisht për përkushtimin e tyre në kryerjen e reformave të nevojshme për të arritur anëtarësinë. Shqipëria ka qenë anëtare e programit Partneritet për Paqe dhe tani ndodhet midis vendeve partnere të NATO-s.

Me arritjen e përparimeve domethënëse në demokratizim dhe reformat e ekonomisë së tregut, po bëhet gjithmonë e më shumë e qartë për shoqërinë shqiptare që qenia anëtar i NATO-s nënkupton përgjegjësi dhe kontribute, dhe nuk mund të jesh vetëm përfitues i sigurisë kolektive. Për më tepër, procesi i integritit ka hyrë në një fazë vendimtare, e cila kërkon përfshirjen e shumë aktorëve shtetërorë dhe atyre të shoqërisë civile, si edhe pjesëmarrjen e publikut. Mirëpo, ndërsa vendosmëria e aktorëve politikë për t'u integruar në NATO duket e palëkundur, shumë pak dihet mbi perceptimet e publikut mbi integrimin në NATO dhe mbi përgjegjësitë e Shqipërisë si një anëtare e ardhshme e Aleancës. Anketimi i fundit i opinionit mbi integrimin në NATO është bërë në vitet 1990.

Për këtë arsye, IDN në periudhën mars-maj 2007 zhvilloi një anketim të opinionëve të shqiptarëve mbi procesin e integritit në NATO. Anketimi u mbështet nga Divizioni i Diplomacisë Publike në Bruksel. Qëllimi ynë ishte zbulimi dhe vlerësimi i perceptimeve të publikut mbi NATO-n, brenda perceptimeve të përgjithshme mbi sigurinë, njohjen e NATO-s, rolin e institucioneve shtetërore për integrimin evro-atlantik,

sigurinë rajonale, si edhe përfshirjen e Forcave të Armatosura (FA) shqiptare në operacione jashtë territorit shtetëror. Për pasojë, të gjitha këto çështje u pasqyruan në hartimin e pyetësorit dhe në renditjen e pyetjeve. Ky artikull paraqet gjetjet kryesore të anketimit. Për metodologjinë e ndjekur, rezultat e plota si edhe për një diskutim mbi tendencat e anketimit, lexuesit mund t'i adresohen broshurës që IDN ka botuar me të njëjtin titull, varianti elektronik i së cilës gjendet në faqen e internetit www.idmalbania.org.¹

Rezultatet e përftuara nga anketimi janë një shprehje fotografike, në një çast të dhënë e në një rrethanë të caktuar politiko-shoqërore, e perceptimeve shqiptare mbi sigurinë dhe integrimin në NATO. Megjithatë, duke qenë të vetëdijshëm mbi kufizimet inherente të një qasjeje të tillë studimore, rezultatet e anketimit po botohen në një kohë të rëndësishme për përpjekjet e Shqipërisë për t'u integruar në NATO. Prandaj, ne besojmë se rezultatet do t'u shërbejnë politikëbërësve, aktorëve të shoqërisë civile, rretheve akademike, analistëve, gazetarëve, si edhe bashkësisë ndërkombëtare, jo vetëm për të njohur perceptimet publike mbi aspekte të veçanta të sigurisë kombëtare, nivelin e dijeve të publikut mbi Aleancën dhe proceset integruese evropatlantike, por edhe për të shtruar rrugën për strategjitë e duhura dhe të bashkërenduara midis aktorëve shtetërorë dhe joshetërorë për thellimin e sigurisë së vendit dhe për të arritur rezultate më të mëdha gjatë procesit të integritit në NATO.

Përshkrimi i kampionit

Anketimi u zhvillua në 10 qytetet kryesore të Shqipërisë: Tirana, Durrësi, Elbasani, Korça, Vlora, Berati, Gjirokastra, Shkodra, Kukësi dhe Peshkopia. Ai u zbatua në një kampion përfaqësues në shkallë kombëtare prej 1200 qytetarësh të moshës mbi 18 vjeç, gjë që lejon një gabim kampionimi prej 2-3%. Shih Tabelën 1.

¹ Përfitojmë nga rasti për t'i shprehur mirënjohjen ekipit të IDN-së që punoi me anketimin dhe të gjithë atyre që bashkëpunuan dhe lehtësuan punën në terren. Falënderojmë veçanërisht z. Kliti Ceca (Fakulteti i Shkencave të Natyrës i Universitetit të Tiranës) për përkushtimin dhe këshillat e tij gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

Tabela 1: Të anketuarit sipas gjeografisë (vetëm qytete)

Qyteti	%
Berat	5.8
Durrës	9.9
Elbasan	10.2
Gjirokastër	2.9
Korçë	7.3
Kukës	2.8
Peshkopi	3.9
Shkodër	6.0
Tirana	44.4
Vlorë	6.8
Total	100

Siç tregohet edhe në Tabelën 2 (shih më poshtë), kampioni ka arritur një përfaqësim pothuajse të barabartë të gjinive, ku përqindja e të anketuarve femra është pak më e lartë (2.4%) se e meshkujve. Për sa i përket nivelit të arsimit, $\frac{3}{4}$ e të anketuarve kanë një diplomë universitare (61%) apo pasuniversitare (14%), ndërsa të tjerët kanë arsim të mesëm (20.4%) ose 8-vjeçar (4.1%). Parashikoheshin variacione sipas nivelit arsimor në përgjigjet e pyetjeve që nënkuptonin një nivel të caktuar të njohurive mbi NATO-n dhe çështje specifike të procesit të integritit të Shqipërisë në NATO.

Tabela 2: Kategoritë dhe tiparet e kampionit (%)

Kategoritë e anketuara	Administrata publike e qeverisjes qendrore	16.9 %
	Administrata e qeverisjes vendore	12.2 %
	Biznesi	16.7 %
	OJF	10.9 %
	Akademia	10.0 %
	Qytetarët	33.3 %
Mosha	18 - 25 vjeç	18.4 %
	26 - 35 vjeç	29.2 %
	36 - 50 vjeç	34.8 %
	51 - 65 vjeç	14.8 %
	Mbi 65 vjeç	2.8 %

Arsimi	Arsimi 8-vjeçar	4.1 %
	Shkolla e mesme	20.4 %
	Universitar	61.4 %
	Pasuniversitar	14.1 %
Gjinia	Mashkull	48.8 %
	Femër	51.2 %

Përfaqësimi mbizotërues i të anketuarve me diplomë universitare apo më të lartë, u përcaktua nga fakti se kampioni u përqendrua në kategori specifike të qytetarëve, angazhimi profesionist i të cilëve kërkon një nivel të lartë arsimimi. Këto kategori janë administrata publike qendrore, administrata publike vendore, punonjësit e organizatave jofitimprurëse, pedagogët e universiteteve të përfshirë në kategorinë e akademisë dhe biznesit. Kampioni është i organizuar sipas këtyre kategorive, sepse ato janë më të angazhuara në qeverisje dhe çështje publike dhe megjithëse çështjet e sigurisë dhe të integritimit në NATO mund të mos jenë të lidhura drejtpërdrejt me pozicionin dhe punën e tyre, puna e tyre ose është e lidhur me arritjen e standardeve për integritimin në NATO, ose ndikohet nga procesi i integritimit. Ky është rasti i administratës publike, si në nivelin qendror po ashtu edhe atë vendor, por edhe me kategori si përfaqësuesit e OJF-ve, akademia dhe biznesi. Kampioni i administratës publike qendrore përbëhet nga punonjës civilë deri në nivelin e drejtorëve të drejtorive që punojnë për qeverinë (kryeministria dhe 14 ministritë). Kampioni i administratës publike vendore përbëhet nga zyrtarë të bashkive, duke përfshirë vetë kryetarët e bashkive, por duke përfshirë stafin dhe ndihmësit e tyre politikë. Të anketuarit e përfshirë në kategoritë e përfaqësuesve të OJF-ve, akademisë dhe biznesit vijnë nga gjeografia e mbuluar nga anketimi.

Përveç këtyre kategorive, 33.3% e të anketuarve u intervistuan rastësisht në lagje të ndryshme në secilin qytet, për të marrë të dhëna prej kategorive të tjera të qytetarëve, me anë të të cilave mund të krahasohen dhe kontrollohen ato të kategorive të përzgjedhura. Ky grup i të anketuarve është emërtuar “Qytetarët”. Shumica e të anketuarve (64%) hyjnë në grupmoshën nga 26 në 50 vjeç, të cilat janë kohortat më aktive në profesione të ndryshme të përfshira në kategoritë e


përzgjedhura, me përjashtim të akademisë, ku shumica e studentëve janë të moshave nga 18 në 25 vjeç.

Rezultatet e anketimit

1. Perceptimet mbi sigurinë dhe çështje të mbrojtjes

Të anketuarit janë në kundërshti kur pyeten për ekzistencën e kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare të Shqipërisë. Konkretisht, ndërsa 46.2% mendojnë se nuk ka kërcënim ndaj sigurisë kombëtare, 31.8% besojnë në ekzistencën e kërcënimeve të ndryshme. Pjesa tjetër prej 22.1% nuk kanë përgjigje për këtë pyetje. Më tej të anketuarve u kërkohet të vlerësojnë në një shkallë nga 1 (aspak) në 6 (shumë) disa faktorë të brendshëm dhe të jashtëm që mund të rrezikojnë sigurinë kombëtare. Siç tregohet në figurën më poshtë, *risqet më pak të mundshme për të vënë në rrezik sigurinë kombëtare janë “konfliktet fetare” dhe ndonjë “sulm ushtarak prej vendeve fqinjë” me përkatësisht 1.74 dhe 1.97 pikë. Është me interes të theksohet se këta faktorë kanë devijimin standard më të vogël, që do të thotë se shumica e të anketuarve janë dakord me vlerësimin e dhënë. Shih Figurën 1.*

Figura 1 – Kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare



Në mënyrë interesante, katër faktorët më të rrezikshëm që sipas të anketuarve mund të përbëjnë kërcënim ndaj sigurisë kombëtare janë ata që në opinionin publik perceptohen (dhe që shpesh debatohen prej aktorëve politikë) si shqetësimet më të mëdha me të cilat përballet vendi – korrupsioni (4.69), varfëria dhe stanjacioni ekonomik (4.04), dështimi i reformave demokratike (3.91) dhe krimi i organizuar (3.64). Prandaj, të anketuarit perceptojnë faktorët e brendshëm (korrupsionin, stanjacionin ekonomik, krimin e organizuar) si kërcënimet më të rëndësishme ndaj sigurisë kombëtare, përkundër faktorëve të jashtëm (terrorizmi ndërkombëtar, apo sulm ushtarak prej shteteve fqinjë). Për më tepër, figura e mësipërme tregon se një konflikt fetar ka shumë pak gjasa të shfaqet si një faktor i rëndësishëm që vë në rrezik sigurinë kombëtare.

Anketimi u përpoq të identifikojë opinionet dhe familjaritetin e të anketuarve me situatën e tanishme të FA-ve. Në përgjithësi ekziston një opinion pozitiv midis individëve të anketuar në lidhje me FA-të. Më shumë se gjysma e të anketuarve deklarojnë se ushtria “funksionon mirë dhe është e mirorganizuar” (9.3%), ose se ajo “Ka disa mangësi, por funksionon mirë në përgjithësi” (44.7%). Shih Tabelën 1.

Tabela 1 - Cili është opinionin tuaj për gjendjen e tanishme të ushtrisë shqiptare?

Funksionon mirë dhe është e mirorganizuar	9.3%
Ka disa mangësi, por funksionon mirë në përgjithësi	44.7%
Nuk funksionon mirë	27.4%
Nuk e di / Refuzim	18.7 %

Megjithatë, sipas shumicës së të anketuarve problemi më i rëndësishëm i ushtrisë ka të bëjë me “armë dhe pajisje të amortizuara” (33.7%), ndërsa 24.1% e tyre besojnë se “stërvitja profesionale” përbën problemin kryesor. Vetëm 13.8% e individëve të pyetur besojnë se “keqpërdorimi i fondeve” është problemi kryesor. Shih Figurën 2.

Figura 2 – Problemi kryesor i FA-ve

Opinionet e të anketuarve nuk janë dhe aq të ndryshme kur ata pyeten për masat që duhen ndërmarrë për të rritur efikasitetin në FA. Konkretisht, shumica bien në një mendje për të marrë masa të tilla si “niveli më i vogël i blerjeve të armëve ushtarësh, por të përgatitur me teknikat bashkëkohore” (48%), dhe “armatime moderne” (29.8%).

Anketimi më tutje u kërkonte të anketuarve të shprehnin parapëlqimet e tyre për aleancat potenciale që shërbejnë më mirë interesave të Shqipërisë dhe prishmërisë së tyre prej vendeve specifike partneret e tyre të luftës dhe të sigurtë ndaj sigurisë dhe të rendit publik. Shumica (42.6%) preferon që SHBA të ndihmojnë Shqipërinë në rast të kërcënimit të sigurisë dhe të destabilitetit të rendit publik në vend, ndërsa prishmëria më e madhe është SHBA (33.7%) dhe SHBA (13.9%).

Figura 2 – Problemi kryesor i FA-ve
 te cili shtet do të shpresonit më shumë që të ndërhynte për të ndihmuar?

Megjithatë këto të dhëna nuk mund të japin interpretimin se shqiptarët parapëlqejnë SHBA në vend të vendeve evropiane si partnerë. Të dhënat e mëposhtme e konfirmojnë këtë fakt. Figura e mëposhtme (Figura 4) tregon se shumica e të anketuarve (52%) i mendon njëloj të barabarta aleancën e Shqipërisë me BE apo atë me SHBA.






Figura 3 – Pritshmëria e të anketuarve nga vendet partnere

Pyetja: Sipas mendimit tuaj, cila prej aleancave të mundshme është më e rëndësishme për të mbrojtur interesat jetësore të Shqipërisë?

Figura 4 – Aleancat e Shqipërisë me BE dhe SHBA

Pjesa vijuese e analizës përqendrohet te perceptimet dhe mbështetja e të anketuarve për procesin e integrimit në NATO.

2. Perceptimet mbi procesin e integritimit në NATO

Anketimi tregon se publiku i gjerë shqiptar ka një opinion pozitiv për NATO-n. Konkretisht 88.8% kanë ose opinion pozitiv (48.1%), ose shumë pozitiv (40.7%) për NATO-n si organizatë dhe vetëm 1.7% kanë qëndrime negative ose shumë negative.

Është interesante se gati S& e qytetarëve të anketuar mendojnë se anëtarësimi në NATO është thjesht propagandë politike, përballë 49.2% që besojnë të kundërtën dhe 17.1% që nuk kanë dhënë përgjigje. Kjo tendencë vihet re në të gjitha kategoritë e anketuara, brenda të cilave përqindja e të anketuarve që e shohin këtë qëllim si propagandë të politikës së ditës varion nga 27.5% tek “Akademia” dhe ngrihet në pothuajse 39% të të anketuarve të “Administratës publike qendrore”. Megjithatë, këto të dhëna zbulojnë qëndrimet e të anketuarve ndaj mënyrës se si trajtohet prej elitës politike qëllimi i anëtarësimit në NATO dhe ato nuk kanë aspak të bëjnë as me NATO-n si organizatë (88.8% e të anketuarve kanë opinion pozitiv për NATO-n), dhe as me mbështetjen për anëtarësimin në NATO.¹ Konkretisht një shumicë e gjerë e të anketuarve (89.4%) shpallin mbështetjen e tyre për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Shih Figurën 5.

Pyetja: *Nëse nesër do të zhvillohej një referendum mbi anëtarësimin e Shqipërisë në NATO ju si do të votonit?*

Kategoria që përkrah më shumë anëtarësimin në NATO është ajo e shoqërisë civile – OJF me gati 97%, ndërsa përkrahja më e ulët vjen nga kategoria e Biznesit – 83% e të anketuarve do të votonin PRO në një referendum. Pothuajse 50% e të anketuarve e lidhin anëtarësimin në NATO me sigurinë dhe stabilitetin kur pyeten se “Çfarë nënkupton për ju anëtarësimi i vendit në NATO?” Një numër i konsiderueshëm i tyre besojnë se anëtarësimin në NATO mund të ketë një ndikim në zhvillimin dhe mirëqenien e përgjithshme. Shih Figurën 6.

¹ Në fakt një përfundim i tillë përforcohet prej të dhënave të tjera të paraqitura më poshtë.

Figura 5 – Mbështetja për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO





Figura 6 – Çfarë nënkupton anëtarësimi në NATO?



Prej një këndvështrimi më të gjerë, 85.2% e të anketuarve besojnë se hyrja e Shqipërisë në NATO do të ndikojë pozitivisht në pozitën e vendit në arenën ndërkombëtare, përkundër vetëm 0.7% që thonë të kundërtën dhe 7.8% që nuk shohin ndonjë ndikim.

Në mënyrë që të kuptohen më mirë opinionet dhe perceptimet e të anketuarve mbi procesin e integritimit në NATO, si edhe mbështetja që ata i japin anëtarësimit të Shqipërisë në këtë organizatë, duhet analizuar edhe niveli i familjaritetit dhe ndërgjegjësimit për kërkesat dhe pasojat që sjell ky proces. 54.2% e të anketuarve do të pranonin që trupat dhe personeli i NATO-s të vendoseshin për periudha të gjata kohore në territorin shqiptar, ndërsa 26.3% thonë se nuk do ta pranonin. Megjithatë, kur pyeten nëse do të pranonin që NATO të ndërhynte për të rivendosur rendin publik në rast të kërcënimit të tij në Shqipëri, një shumicë e gjerë (84.4%) thonë PO dhe vetëm 6.2% janë kundër (9.4% nuk japin përgjigje).

Buxheti i FA-ve në nivelin e 2% të GDP (Prodhimit të Brendshëm Bruto) është një detyrim i rëndësishëm që Shqipëria e ka pranuar në kuadër të procesit të integritimit. Megjithatë, duket se ky detyrim nuk është shumë i qartë për një numër të konsiderueshëm të të anketuarve. Konkretisht 38.7% e tyre nuk i janë përgjigjur pyetjes: *“A do ta pranoni një nivel buxheti të Forcave të Armatosura në vlerën prej 2% të Prodhimit të Brendshëm Bruto për integritimin e vendit në NATO?”*. Përqindja e të anketuarve që janë pro “nivelit prej 2% të GDP” ndryshon nga kjo shifër me vetëm 0.4%. Shih Tabelën 2.


Tabela 2 – *Mbështetja e të anketuarve për detyrimin e “2% të nivelit të GDP për buxhetin e FA-ve” për anëtarësimin në NATO*

PO	38.3 %
JO	23 %
NUK E DI / PA PËRGJIGJE	38.7 %

Ndërsa shumica e të anketuarve janë dakord që integrimi në NATO nuk ka të bëjë vetëm me standardet ushtarake, shumica e tyre e perceptojnë Ministrinë e Mbrojtjes si institucionin kryesor përgjegjës për garantimin e përparimit drejt anëtarësisë. Shih Figurën 7.


Pyetja: *Për mendimin tuaj, cili institucion ka barrën kryesore për të siguruar mbarëvajtjen e procesit të integritimit në NATO?*

Figura 7 – Institucioni kryesor përgjegjës për përparimin e procesit të integrimit në NATO



Mirëpo, siç e përmendëm më parë, të anketuarit nuk e lidhin anëtarësimin në NATO vetëm me përparimin dhe standardet ushtarake. Përkundrazi, shumica e të anketuarve besojnë se kriteret që Shqipëria duhet të përmbushë për të hyrë në NATO përfshijnë edhe standardet e të drejtave njerëzore dhe demokratike, standardet ekonomike dhe të mirëqenies, përveç atyre ushtarake. Shih Figurën 8.

Figura 8 – Kriteret më të rëndësishme për anëtarësimin e Shqipërisë



Prej një këndvështrimi rajonal, shumica e të anketuarve, gjithashtu, besojnë se bashkëpunimi rajonal në Evropën Juglindore mbetet një kusht i rëndësishëm që vendet e rajonit duhet ta përmbushin për t'u integruar në NATO. Konkretisht, gati 62% e të anketuarve mendojnë në këtë mënyrë, kurse për 12% bashkëpunimi rajonal nuk është kusht.

Në të njëjtën linjë me këto tendenca, shqiptarët nuk e shohin FA si institucion që mbart fajin kryesor në rast se vendi dështon për të marrë një ftesë për të hyrë në NATO. As nuk nguten për t'ia lënë fajin ekskluzivisht elitës politike në pushtet (qeverisë). Shumica e të anketuarve besojnë se “*Dështimi i klasës politike për të ndërtuar një sistem demokratik të qëndrueshëm*” do të ishte shkaku kryesor nëse Shqipëria nuk do ta merrte ftesën për të hyrë në NATO. Shih Tabelën 3.

Pyetja: *Në rast se Shqipëria nuk e merr ftesën për të hyrë në NATO, cili sipas jush do të ishte shkaku kryesor për këtë?*

Tabela 3 – Arsyeja kryesore pas mosmarrjes së ftesës për të hyrë në NATO

Dështimi i <i>klasës politike</i> për të ndërtuar një sistem demokratik të qëndrueshëm	39.4 %
Dështimi i <i>qeverisë</i> në realizimin e reformave të nevojshme	24.0 %
Dështimi i <i>Forcave të Armatosura</i> për të arritur standardet e NATO-s	20.6 %
Performanca e dobët <i>ekonomike</i> e vendit	6.7 %
Tjetër	2.7 %
Nuk e di	6.7 %


Të anketuarit nga të gjitha kategoritë (si edhe të gjitha nivelet e arsimit) dëshmojnë të njëjtën tendencë si në kampionin e përgjithshëm – që do të thotë se klasa politike në përgjithësi (pozita dhe opozita) duhet të mbajnë përgjegjësi nëse vendi nuk merr ftesën për të hyrë në NATO. Megjithatë ndryshe nga perceptimi i përgjithshëm (kampionit të përgjithshëm), në rastin e kategorive të qytetarëve dhe të Administratës Publike Qendore, Forcat e Armatosura dhe jo qeveria (sikurse në kampionin e përgjithshëm) janë të radhitura në vendin e

dytë si institucioni që duhet “fajësuar” nëse Shqipëria nuk merr ftesën e anëtarësimit në NATO. Këto të dhëna konfirmojnë që të anketuarit nuk e perceptojnë anëtarësimin në NATO si një “çështje ushtarake” dhe as si një proces për të cilin aktorët politikë përgjegjës ndryshojnë sa herë që ka një ndryshim të elitës politike në fuqi. Në vend të këtyre, integrimi në NATO është një proces që duhet të përfshijë përpjekjet e të gjithë aktorëve politikë me qëllim që të sigurohet një zhvillim i shëndoshë dhe standarde të larta në lidhje me përparimin social-ekonomik, demokratizimin dhe shtetin ligjor.

Të anketuarit në përgjithësi ndihen pozitivë kur pyeten për operacionet ushtarake të ardhshme jashtë territorit shqiptar. Megjithatë, mbështetja e tyre ndryshon me afro 20% më pak për operacionet kolektive ushtarake jashtë territorit të NATO-s (krahasuar me mbështetjen për një anëtar të NATO-s), duke supozuar se anëtarësimi në NATO do të jetë arritur ndërkohë. Grafiku i mëposhtëm tregon mbështetjen e të anketuarve ndaj ndihmës ushtarake për vende të tjera të NATO-s në rast se ata sulmohen. Shih Figurën 9.

Pyetja: Nëse Shqipëria do të ishte anëtare e NATO-s, a mendoni se ajo duhet të japë ndihmë ushtarake për vendet e tjera anëtare nëse ato sulmohen?


Figura 9 – Mbështetja për ndihmën ushtarake anëtarëve të NATO-s



Mirëpo, mbështetja bie në 61.7% kur të anketuarit pyeten për operacione ushtarake kolektive jashtë territorit të NATO-s, gjithmonë duke supozuar se Shqipëria është një anëtare e organizatës. Numri i kundërshtarëve në këtë rast rritet në gati 17% dhe po kështu edhe numri i të anketuarve që nuk kanë një qëndrim të qartë për këtë rast (21.4%). Shih Figurën 10.


Pyetje: Nëse Shqipëria do të ishte anëtare e NATO-s a mendoni se ajo duhet të marrë pjesë në operacione kolektive ushtarake jashtë territorit të vendeve anëtare të NATO-s?

Figura 10 – Mbështetja për operacione kolektive ushtarake jashtë territorit të NATO-s



Është interesante, por jo domosdoshmërisht e lidhur me këtë, që një përqindje gati e njëjtë e të anketuarve (si ata që mbështesin operacionet ushtarake jashtë territorit të NATO-s) besojnë se pjesëmarrja e tanishme e Shqipërisë në operacione ushtarake ndërkombëtare është ose brenda (48.3%), ose nën mundësitë reale që ka vendi (11.3%). Konkretisht, kur pyeten që të vlerësojnë pjesëmarrjen e Shqipërisë në kësi operacionesh në Bosnjë-Hercegovinë, Afganistan dhe Irak, vetëm 26% e tyre mendojnë se këto operacione i kanë kaluar mundësitë reale të vendit. Shih Figurën 11.

Figura 11 – Pjesëmarrja e Shqipërisë në operacione ushtarake në Bosnjë-Hercegovinë, Afganistan dhe Irak



Të dhënat brenda kategorive të anketuara pak a shumë konfirmojnë të njëjtën tendencë si të kampionit të përgjithshëm, që do të thotë se më shumë se gjysma e të anketuarve në secilën kategori besojnë se pjesëmarrja e tanishme e Shqipërisë në operacione ushtarake ndërkombëtare është ose brenda, ose nën mundësitë reale të vendit.

Të dhënat e paraqitura në disa raste më sipër krijojnë përshtypjen e një audience shqiptare që është miqësore ndaj NATO-s. Kjo përshtypje ripohohet edhe në pyetjen e mëposhtme mbi parapëlqimet e të anketuarve për trupat shqiptare që marrin pjesë në operacione kolektive në një konflikt diku në botë. Siç e tregon figura e mëposhtme, shumica e të anketuarve do të parapëlqenin që trupat shqiptare të merrnin pjesë në operacione ushtarake të drejtuara nga NATO (49.3%). Shih Figurën 12.

Pyetja: Në rrethanat e tanishme, nëse trupat shqiptare do të merrnin pjesë në operacione kolektive në një konflikt diku në botë, cilën prej alternativave do të preferonit?


Figura 12 – Pjesëmarrja e FA-së shqiptare në operacione kolektive ushtarake

Në fund, anketimi u përpoq të identifikonte lidhjen midis proceseve integruese në NATO dhe BE, sipas perceptimeve të të anketuarve. Ndërsa shumica e tyre e kishin bërë të qartë më parë

se integrimi në BE do të çonte në një shtet më të sigurt dhe më stabil, një shumicë e gjerë e të anketuarve mendojnë se anëtarësimi në NATO do ta shpejtonte rrugën e integrimit të vendit në BE. Shih Figurën 13.

Pyetja: A mendoni se anëtarësimi në NATO do të përshpejtonte integrimin në BE?

Figura 13 – Anëtarësimi në NATO si përshpejtues për integrimin në BE



Përmbledhje e gjetjeve kryesore

Anketimi identifikoi një **audiencë shqiptare miqësore ndaj NATO-s**, e cila është optimiste për procesin e integritit të vendit në NATO. Megjithatë, nivele të larta të përgjigjeve “NUK E DI” dhe mospërputhje të tjera veçanërisht në lidhje me faktorët që ndikojnë në çështjet e sigurisë, ose me pasojat që rrjedhin nga procesi i integritit në NATO na çojnë drejt përfundimit që të anketuarit shpesh ofrojnë mbështetjen e tyre për “gjithçka që nevojitet” për anëtarësinë, pa u menduar gjatë për teknikalitetet e procesit. Individët e anketuar shpeshherë humbasin në përgjigjet “NUK E DI” në pyetje specifike që kërkojnë një nivel të caktuar ndërgjegjësimi dhe njohje me procesin e integritit në NATO. Ndërsa të anketuarit me arsim më të lartë duket se janë më të vetëdijshëm mbi parakushtet apo pasojat e anëtarësimit në NATO, ky përfundim nuk është gjithmonë i vlefshëm.

Të anketuarit nuk janë në një mendje në lidhje me ekzistencën e kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare të Shqipërisë. Konkretisht, ndërsa 46.2% mendojnë se sigurisë kombëtare nuk i kanosen kërcënime, 31.8% besojnë tek ekzistenca e kërcënimeve të ndryshme.

Megjithatë, shumica e të anketuarve janë në një mendje se procesi i integritit në NATO nuk ka të bëjë vetëm me standardet ushtarake. Shumica besojnë se kriteret që Shqipëria duhet të plotësojë për t’u anëtarësuar në NATO përfshijnë edhe standardet demokratike dhe të të drejtave të njeriut, standardet ekonomike dhe të mirëqenies, përveç standardeve ushtarake. Këto të dhëna përforcojnë përfundimin se **të anketuarit nuk e perceptojnë anëtarësimin në NATO vetëm si një “çështje ushtarake” dhe as si një proces për të cilin aktorët politikë përgjegjës ndryshojnë sa herë që ka një ndryshim në elitën politike në fuqi**. Përkundrazi, anëtarësimi në NATO është një proces që duhet të përfshijë përpjekjet e të gjithë faktorëve politikë në mënyrë që të sigurohet një zhvillim i qenësishëm dhe standarde të larta të përparimit socio-ekonomik, demokratizimit dhe shtetit ligjor. Për më tepër, shumica e tyre e kanë të qartë më parë se

anëtarësimi në NATO nënkupton mbi të gjitha “siguri dhe stabilitet” (gati 50% e të anketuarve; shih më poshtë), dhe një shumicë e gjerë e të anketuarve besojnë se anëtarësimi në NATO do ta shpejtojë rrugën e integritit të vendit në Bashkimin Evropian.

Të anketuarit perceptojnë **faktorët e brendshëm – korrupsionin, stanjacionin ekonomik, krimin e organizuar - si kërcënimet më të mëdha ndaj sigurisë kombëtare**, përkundër faktorëve të jashtëm (terrorizmi ndërkombëtar ose sulm ushtarak prej vendeve fqinje). Risqet më pak të mundshme që mund të vënë në rrezik sigurinë kombëtare, sipas të anketuarve janë “konfliktet fetare” dhe “sulm ushtarak nga vendet fqinje”.

Në përgjithësi ka një **opinion pozitiv midis individëve të anketuar në lidhje me Forcat e Armatosura (FA)**. Më shumë se gjysma e të anketuarve shprehën se ushtria “funksionon mirë dhe është e mirorganizuar”, ose se ajo “funksionon mirë në përgjithësi” pavarësisht disa mangësive. Për më tepër, shqiptarët nuk i shohin FA-të si fajtorët kryesorë në rast se vendi dështon në marrjen e një ftese për të hyrë në NATO. Ata nuk ia drejtojnë gishtin vetëm elitës politike në fuqi (qeverisë). Shumica e të anketuarve besojnë se “dështimi i klasës politike për të ndërtuar një sistem demokratik të qëndrueshëm” do të ishte shkaku kryesor nëse Shqipëria nuk do të merrte një ftesë për t’iu bashkuar NATO-s.

Anketimi tregon se publiku shqiptar, në një masë të madhe, ka një **opinion pozitiv mbi NATO-n**. Konkretisht, 88.8% kanë ose një opinion pozitiv, ose një opinion shumë pozitiv për NATO-n si organizatë. Pritshmëria e të anketuarve prej anëtarësisë së Shqipërisë në NATO është relativisht e lartë – një shumicë e gjerë e të anketuarve besojnë se anëtarësimi në NATO garanton sigurinë kombëtare dhe se arritja e këtij qëllimi do ta shpejtonte edhe anëtarësimin tonë në BE.

Rezultati më kryesor i anketimit mund të konsiderohet mbështetja e anëtarësimit të vendit në NATO (89.4%), gjë që i jep mbështetje supozimeve të deritanishme se procesi i integritit në NATO i nisur nga elitat politike në fillimet e viteve '90, gëzon një

përkrahje të gjerë në publikun shqiptar. Në këtë fazë të integritit është detyra e klasës politike, por edhe e mbështetjes së shoqërisë civile, që kjo përkrahje popullore të përkthehet në politika të qarta e të vendosura për të plotësuar standardet e kërkuara për anëtarësimin në Aleancën e Atlantikut të Veriut.

Bordi botues

NË FOKUS TË KËTIJ NUMRI:
DEMOKRACIA E BRENDSHME NË FORCAT
E ARMATOSURA

REALITETI I DEMOKRACISË SË BRENDSHME NË FA

Revista “Çështje të Sigurisë” ka synuar në numrat e saj për të qenë sa më pranë ndryshimeve dhe zhvillimeve në sektorin e sigurisë në vendin tonë, rajon dhe më gjerë. Nëse në numrat e deritanishëm ne kemi parashtruar detyrimet që rrjedhin nga misionet dhe legjislacioni për të qenë sa më funksionalë në ushtrimin e misioneve të tyre për ruajtjen e sigurisë në rrafsh, rajonal e ndërkombëtar, këtë radhë zgjodhëm të fokusohemi në një çështje bashkëkohore që duket se ka të bëjë ngushtësisht me interesat e ushtarakëve, por në realitet ka rezonancë në efikasitetin e përmbushjes së misioneve të reja dhe përherë e më impenjuese që FA-të kanë për përballimin e sfidave të sigurisë. Tematika e dy artikujve vijues ka të bëjë me aspekte të demokracisë së brendshme dhe vetorganizimit të ushtarakëve në dy vende demokratike dhe anëtare të NATO-s: Italia dhe Gjermania.

Ideja e demokracisë në ushtri dikujt mund t’i duket paradoksale, nisur nga çka njihet dhe pranohet gjithësisht se FA-të i shërbejnë rendit kushtetues dhe demokracisë, por duhet të “vuajnë” disa kufizime të lirive dhe të drejtave të këtyre qytetarëve në uniformë. Profesionit i ushtarakut është nga të radhët ku qytetari vullnetarisht zgjedh të rekrutohet dhe të shërbejë nën armë duke pranuar t’i cenohen disa nga liritë dhe të drejtat në krahasim me qytetarët e tjerë, duke iu nënshtruar një jete profesionale ndryshe në disa aspekte nga ajo civile. Natyra e këtyre kufizimeve ka të bëjë me disiplinën, bindjen, hierarkinë dhe shërbimin në kushte të atilla, që në disa raste mund të kërkojnë prej ushtarakut edhe vetëmohimin,

deri në vetësakrifikim për hir të misionit. Betimi i ushtarakut ka një vlerë jo thjesht morale dhe patriotike, por prej tij rrjedhin një sërë detyrimesh dhe sanksionesh që ndikojnë tërë jetën e ushtarakut.

Megjithëse ushtaraku e ka zgjedhur me vullnetin e tij këtë profesion, ndonjëherë ka ndodhur që në emër të “arsyes shtetërore”, “detyrës”, “betimit”, apo “misionit” është abuzuar, duke i tejkuluar kufizimet e pranuar. Në këto raste lind pyetja: a duhet që ushtarakët, krahas pranimin të sakrificave që burojnë nga natyra e profesionit, të kenë të drejtën të ankohen dhe të mbrohen kolektivisht, nga teprimet e burokracisë ushtarake? Kësaj pyetjeje është tentuar t’i jepet përgjigje pozitive dhjetëra vjet më parë, siç del edhe nga dy shkrimet që po botojmë mbi këtë temë. Duke sjellë te lexuesi i revistës përvojën e vetorganizimit në FA-të italiane dhe gjermane, Bordi ka synuar që të bëjë të njohur këtë realitet dhe të hapë rrugën për një refleksion lidhur me përafrimin e forcave tona të armatosura me standardet, jo vetëm të karakterit operacional, por edhe të organizimit të tyre të brendshëm dhe të marrëdhënieve të tyre me institucionet kushtetuese. Kjo tentativë ndjek vazhden e reformave dhe të ndryshimeve që kanë ndodhur në FA-të shqiptare, të cilat, veçanërisht në vitet e fundit, jo vetëm janë bërë më operacionale, por edhe kanë arritur nivele të përparuara të organizimit të jetës së brendshme, sipas standardeve të një shoqërie demokratike dhe të atyre që kërkohen për integrimin në NATO. Ftojmë specialistët dhe analistët që, bazuar mbi përvojat e tyre, vizionin e FA-ve shqiptare dhe çështjet e trajtuara në dy artikujt e këtij numri, të marrin pjesë në këtë diskutim në numrat e ardhshëm të “Çështje të Sigurisë”, me synimin që ai do t’i shërbejë zhvillimeve bashkëkohore dhe përvetësimin të përvojave të përparuara.

Kol. Skënder Kadiu

PËRFAQËSIA E USHTARAKËVE SI FORMË E “SINDIKALIZMIT” NË FORCAT E ARMATOSURA ITALIANE

1. Mbrojtja e interesave kolektive të personelit ushtarak në FA

Fenomeni i sindikalizmit në Forcat e Armatosura lindi dhe u zhvillua në fillim të shek. XX në vendet skandinave, atje ku lindën edhe eksperiencat e para të demokracisë industriale. Fillimisht u konsiderua si një fakt privat dhe u tolerua nga shteti, në kuadrin e lirive të mëdha të garantuara nga këto sisteme të demokracive të avancuara. Më vonë ato u njohën dhe veprimtaria e tyre u rregullua nga shteti në të njëjtën mënyrë si dhe sindikatat e tjera. Megjithatë, ky proces që i ngadaltë dhe mund të themi se u kompletua pak a shumë në epokën e Luftës së Dytë Botërore.

Rënia e regjimeve totalitare dhe zhvillimi i konsolidimi i demokracive të Evropës Perëndimore krijuan hapësira më të mëdha edhe për zhvillimin e sindikalizmit pak a shumë në të gjitha vendet e Evropës, aty ku ishte e mundur shprehja e lirë e kërkesave dhe vullnetit të qytetarëve. Sot, sindikalizmi në FA, ndonëse në forma të ndryshme, ushtrohet pothuajse në të gjitha vendet e NATO-s dhe të BE-së.

Cilat janë arsytet, shkaqet, tendencat që i shtyjnë njerëzit me uniformë drejt sindikalizmit? Disa autorë mbështesin idenë se si institucioni ushtarak, duke filluar nga konflikti botëror, pësoi një rënie të përgjithshme të nivelit të jetesës, e cila, e kombinuar me një tendencë të përgjithshme drejt marrëdhëniesh të reja ndërmjet eprorëve dhe vartësve, kushtëzoi nevojën e organizimit për mbrojtjen e të drejtave

kolektive të ushtarakëve. Kjo duhet parë edhe në optikën e zhvillimeve të shkaktuara nga marrëdhëniet e punës në shoqëritë perëndimore, të cilat karakterizoheshin nga një pjesëmarrje më e gjerë e qytetarëve në mbrojtje të interesave të tyre dhe nga kalimi gradual nga raportet individuale të punës në ato kolektive.

Një arsye tjetër, sipas Victor Werner,¹ është ndryshimi i statusit, ose i pozicionit social të ushtarakëve. P.sh. ndërsa në Luftën e Parë Botërore në disa vende të Evropës profesioni ushtarak gëzonte një status për t'u pasur zili, duke i vendosur FA-të në një pozicion të privilegjuar në raport me pjesën tjetër të shoqërisë, pas Luftës së Dytë Botërore karriera ushtarake nuk ishte më objekt i vëmendjes dhe preokupacionit të shtetit. Në planin konkret vëmendja u spostua drejt rilindjes ekonomike, problemeve të punësimit dhe zhvillimit industrial. Pozicioni material i personelit ushtarak u bë nën këtë aspekt gjithnjë e më pak i favorshëm.

Një arsye tjetër e zhvillimit të sindikalizmit në FA evidentohet nga David Cortright,² i cili i referohet realitetit amerikan në vitet 1960 me një rritje të sindikalizmit të administratës publike, e cila nuk mund të mos kishte ndikimin e vet në FA. Megjithatë, vëren autori nuk duhet harruar se nxitja e sindikalizmit në FA nuk është bërë nga sindikalistët, nuk janë ata që krijuan pakënaqësinë dhe zhgënjimin. Këta faktorë lindin në kushtet e përditshme të punës dhe varen nga aftësitë dhe mundësitë që zinxhiri i komandimit ka për të përballuar dhe zgjidhur problemet e kategorive të ndryshme të personelit.

Sipas David R. Segal, motivimi kryesor duhet kërkuar në veçoritë e institucionit ushtarak, i cili sintetizohet si vijon:

Për shkak të unitetit të funksionimit të tij, institucioni ushtarak i kërkon personelit të tij një shkallë përkushtimi më të ndryshëm nga ai që i kërkohet organizatave të tjera moderne. Personeli ushtarak ndryshe nga ai civil, vendos një kontratë

¹ Victor Werner, "Les Militaires de carriere le droit syndacal" Pallats 4/1964, p. 5-10

² David Cortright, *Soldier in revolt* (Anchor Press, New York 1975), p. 33

me një afat të palimituar me punëdhënësin. Në fakt një personel i tillë nuk mund të mbarojë kontratën e punës kur dëshiron ai, ndërkohë ai është objekt i transferimeve të ndryshme dhe i kryerjes së shërbimit në çdo vend që kërkohet. Shpesh atij i kërkohet që të vendosë interesat e shërbimit/detyrës mbi ato familjare dhe është kështu subjekt i periudhave të gjata larg familjes. Atij i kërkohet shpesh të zhvillojë një veprimtari edhe jashtë 8-orëshit pa marrë asnjë kompensim, ose pagesë të veçantë dhe në kohë lufte ai duhet të përballojë situata të gjata të rrezikshme dhe mund të humbasë edhe jetën... Veçoria nuk qëndron vetëm në fushën e rreziqeve me të cilat supozohet të ndeshet, por edhe në kufizimet dhe racionaliteti i veçantë që i kërkohen të zbatohë në luftim në situata të ndërlikuara. Kjo sjell një lloj shoqërizimi të veçantë.³

Sipas Willam Taylor e Roger Argano, në një studim të kryer në SHBA në vitet 1980, shumë nga motivacionet pro dhe kundër një sindikalizimi të personelit ushtarak shfaqen retorike dhe të pastuduara plotësisht. Ata që mbështesin një pozicion të kritikës negative, p.sh. pohojnë se një sindikalizim i personelit do të degradonte disiplinën ushtarake, do të ishte një rrezik në hierarkinë e zinxhirit të komandimit dhe mbi të gjitha do të minonte aftësitë e instrumentit ushtarak për të përmbushur misionin që i është ngarkuar.⁴

Këta autorë, nëpërmjet një analize konkrete, evidentojnë edhe avantazhet dhe disavantazhet e një procesi të tillë. Si avantazhe evidentohen: rritja më e madhe e kuptimit të sigurisë individuale; një vlerësim më i madh për dinjitetin personal të individit; një përmirësim i komunikimit social; një kompetitivitet më i madh me llojet e tjera të punësimit dhe profesionet e tjera në rekrutimin e personelit. Si disavantazhe evidentohen: rreziku i prishjes së kohezionit të brendshëm të forcave dhe rritja e kostos së personelit.

³ Cap. Bernardino GAMBONI: Tesi di laure di laura in Diritto Amministrativo: La rappresentanza militare del Ministero della Difesa: Funzioni, Compiti e differenze rispetto alle organizzazioni sindacali di categoria. Aspetti innovativi del progetto di riforma, 2004, pag 22.

⁴ Williaam Taylor dhe Roger Argano: "Military effectiveness: the basic issue of military unionization in military union" London 1977, pag.254-256.

Gjithsesi, qëllimi i këtij artikulli nuk është të shpjegojë se si ka lindur sindikalizmi në FA dhe se cilat janë pozicionet teorike rreth këtij problemi. Edhe këto janë të rëndësishme, por qëllimi i shkrimit është të japë një informacion mbi një formë të sindikalizmit, atë të FA-ve italiane.

2. Përfaqësia e ushtarakeve si formë e sindikalizmit në Forcat e Armatosura italiane.

a) Lindja dhe evoluimi

Si në vendet e tjera edhe në Itali tentativat e para për mbrojtjen e interesave të personelit ushtarak të karrierës u bënë nga shoqatat profesionale të ushtarakëve në rezervë të krijuara në vitet 1950. Në fund të viteve 1960 disa nga shoqatat e mësipërme krijuan shoqatat me karakter sindikal, të cilat ishin të hapura edhe për personelin e shërbimit aktiv të të tre llojeve të forcave (ushtrisë, marinës dhe aviacionit). Në fillim të viteve 1970 u zhvillua një debat i gjerë që nuk kishte të bënte vetëm me aspektet e përfaqësimit të interesave profesionale të ushtarakëve, por edhe me demokratizimin e tyre.

Në vitin 1969 për herë të parë Admirali Marengo i kërkoi Ministrin të Mbrojtjes autorizimin për krijimin e një shoqate sindikale të Marinës. Autorizimi nuk u dha, por kjo nxiti krijimin e një hetimi parlamentar dhe përgatitjen e një projektligji mbi ushtrimin e të drejtave civile dhe politike të qytetarëve që i përkasin FA-ve, i cili futi për herë të parë të drejtën e organizimit në sindikata të personelit ushtarak. Në vitet 1970 Andreotti, si ish-kryeministër i Italisë, theksonte shqetësimin e personelit ushtarak, i cili duke mos pasur një sindikatë të vetën nuk kishte mundësi të mbështeste dhe mbronte kërkesat e veta. Debatu politik mbi këtë problem vijoi deri më 11 korrik 1978, kur Parlamenti Italian miratoi ligjin “*Norma parimore mbi disiplinën ushtarake*”. Ky ligj sanksionon edhe mënyrën e përfaqësimit të interesave kolektive të ushtarakëve në FA-të italiane.

Shoqatat sindikale të ushtarakëve sot janë lejuar në pjesën më të madhe të vendeve të Evropës, dy nga të cilat, Austria

dhe Zvicra, lejojnë edhe të drejtën e grevës në FA.⁵ Gjithashtu, Gjermania ka krijuar një komision parlamentar, i cili ushtron funksionin e “sindikatës inspektuese” për mbrojtjen e të drejtave themelore të personelit. Përkundrazi, ligjvënësi italian i ka ndaluar ushtarakët të organizohen në mënyrë sindikale dhe ka krijuar një sistem institucional për mbrojtjen e interesave kolektive, i ashtuquajtur “*Rappresentanza militare*” – “Përfaqësia e ushtarakëve”, i cili është i vendosur brenda sistemit organizativ të forcave dhe ushtron veprimtarinë e tij nëpërmjet organeve kolegjinale të zgjedhura. Organet e përfaqësimit ndahen në tre nivele:

- Këshilli Qendror i Përfaqësisë së Ushtarakëve (COCER), si organ qendror dhe interforce i përfaqësimit, përbëhet nga të gjitha kategoritë e personelit. Ai organizohet në seksione për çdo lloj force dhe komisione sipas kategorive të ushtarakëve (oficer, nënoficer dhe vullnetar).
- Këshillat e Ndërmjetme të Perfaqësimit (COIR) organizohen pranë komandave të larta, zakonisht të drejtuara nga gjeneral leitnant dhe gjeneralmajor ose grada korresponduese me to.
- Organet bazë të përfaqësisë së ushtarakëve (COBAR), me karakter lokal, të cilat krijohen pranë njërive bazë, zakonisht të nivelit korpus ose të një niveli kompatibël me strukturat e llojeve të forcave, sipas kriterit që të vendosen në krah të një autoriteti hierarkik, i cili ka kompetencë të marrë vendime për probleme të karakterit lokal. Këto organe krijohen edhe pranë institucioneve, akademive, shkollave, kolegjeve dhe reparteve, të cilat merren me edukimin dhe kualifikimin ushtarak, si dhe pranë përfaqësive ushtarake italiane në komandat e NATO-s.

⁵ Cap. Bernardino GAMBONI: Tesi di laure di laura in Diritto Amministrativo: La rappresentanza militare del Ministero della Difesa: Funzioni, Compiti e differenze rispetto alle organizzazioni sindacali di categoria. Aspetti innovativi del progetto di riforma, 2004, pag. 26

b) Konsiderata të përgjithshme

Është e rëndësishme të theksohet se në pikëpamje juridike ligjvënësi ka ruajtur me kujdes *parimet themelore të disiplinës ushtarake, raportin hierarkik brenda FA dhe në përgjithësi të gjithë statusin e qytetarit që kryen shërbimin në organizimin ushtarak*.⁶ Qëllimi i institucionit të përfaqësisë së ushtarakëve është të nxisë shpirtin e pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit brenda njërive dhe reparteve dhe të kontribuojë në mbajtjen lart të kushteve morale dhe materiale të personelit. Filozofia e këtij ligji buron nga e drejta për t'i dhënë ushtarakut të drejtat e njohura përgjithësisht qytetarëve, përveç kufizimeve të bëra për shkak të misionit të Forcave të Armatosura. Në këtë kuptim, të drejtat e ushtarakëve mund të kufizohen vetëm në raste të jashtëzakonshme, të cilat janë të lidhura ngushtë me detyrat e caktuara. Për sa i përket të drejtës për t'u organizuar në sindikata, ligjvënësi ka gjetur një zgjidhje të mesme ndërmjet atyre që mbështesin aplikimin e parimit të demokratizimit të FA-ve, sipas Kushtetutës, dhe atyre që mbështesin idenë e papajtueshmërisë në lidhje me funksionet që i janë caktuar institucionit ushtarak. Në këto kushte organeve të përfaqësimit dhe ushtarakëve u ndalohet e drejta e grevës dhe e krijimit të shoqatave profesionale me karakter sindikal, si dhe e drejta e pjesëmarrjes në shoqata të tjera sindikale.

3. Organet e sistemit të përfaqësimit të ushtarakëve, përbërja, organizimi dhe kompetencat e tyre

Organet e përfaqësimit të ushtarakëve ndërtohen sipas një formule të përfaqësimit organik, d.m.th. në mënyrë proporcionale me përqindjen e çdo lloji force, ose korpusi, ose kategorie të veçantë përfaqësimi, duke përcaktuar megjithatë një minimum të domosdoshëm prej dy përfaqësuesish cilado qoftë përqindja sidomos për organet bazë të përfaqësimit. Ato kanë funksion të formulojnë mendime, propozime dhe kërkesa në respekt të fushave ligjërish të përcaktuara dhe t'ua bëjnë të ditura institucioneve përkatëse të karakterit kolektiv.

⁶ Stegagnini: "Le rappresentanze militari" Firenze, 1981, pag 23.

Përfaqësia e ushtarakëve përbën një institucion novativ, i cili kontribuon në ndryshimin e vetë fytyrës së disiplinës ushtarake, e cila nga një sistem ekskluzivisht autoritativ transformohet në një sistem të marrëdhënieve/raporteve ndërorganike shumë komplekse, ku gjejnë hapësirë të rëndësishme pjesëmarrja dhe bashkëpunimi dialektik i të gjithë ushtarakëve. Në interes të komponentëve të organeve të përfaqësimit parashikohen disa garanci në ushtrimin e mandatit të tyre si ndalimi i çdo akti direkt për të kondicionuar dhe kufizuar ushtrimin e mandatit të përfaqësuesve dhe nevojën për të koordinuar transferimin e ushtarakëve përfaqësues me organet përkatëse të përfaqësimit.

Veprimtaritë e tyre janë të planifikuara edhe në planin financiar dhe shpenzimet e funksionimit të tyre përballohen nga buxheti i Mbrojtjes. Në pikëpamje juridike, veprimtaria e tyre rregullohet nga ligji dhe rregullore të veçanta, të cilët disiplinojnë organet e përfaqësimit, strukturat e tyre, kompetencat, ushtrimin e përfaqësimit, procedurat elektorale, veprimtaritë e organeve përkatëse, etj.

a) Kompetencat e organeve të përfaqësimit të ushtarakëve

Kompetencat e organeve të përfaqësimit ushtarak janë:⁷ *formulimi i mendimeve, propozimeve dhe i kërkesave mbi të gjitha fushat që janë objekt i normave legislative për*

- kushtet e trajtimit të ushtarakëve
- mbrojtjen e natyrës ekonomike
- sigurimeve shoqërore
- kulturore dhe morale

Përfshihen nga kompetencat, fushat që kanë të bëjnë me:

- organizimin
- stërvitjen
- operacionet
- mbështetjen logjistike operacionale
- raportet hierarkike funksionale
- përdorimin e personelit ushtarak

⁷ Art. 2 e 3, D.P.R. 4 novembre 1979, n 619. "Regolamento di attuazione della Rappresentanza Militare"

Janë objekt i trajtimit të këtyre organeve të përfaqësimit edhe problematika të tilla si:⁸

- orari javor i punës;
- lejet e zakonshme dhe lejet e shkurtra për motive personale, ose për shkak të paaftësisë së përkohshme në punë;
- trajtimi ekonomik kur ushtaraku është me mision, transferimi dhe puna jashtë orarit;
- trajtimi i raporteve mjekësore dhe format e pensioneve suplementare;
- kriteret për organet e kontrollit të shërbimit të mensave dhe dyqaneve, bareve, restoranteve për zhvillimin e aktiviteteve të mbrojtjes sociale dhe të mirëqenies së ushtarakëve, përfshirë ngritjen kulturore dhe menaxhimin e enteve të asistencës së personelit;
- krijimi i fondeve integrale për shërbimin sanitar kombëtar.

b) Kompetenca të veçanta të organeve të përfaqësimit të ushtarakëve

Administrata ushtarake, si e vetmja kompetente të mbajë raporte me rajonet, provincat dhe komunat, mund të mbështetet për këtë qëllim, me kërkesën e organeve të përfaqësisë së ushtarakëve, në mënyrë të veçantë të COIR dhe COBAR, të cilat kanë karakter zonal dhe lokal, për trajtimin e çështjeve të tilla si veprimtaritë e asistencës, kulturore, çlodhëse, të promovimit social dhe të veprimtarive në interes të familjarëve. Në lidhje me këtë, administrata ushtarake pasi dëgjon organet e përfaqësisë dhe organet e administratës lokale harton programet për zhvillimin e raporteve të komunitetit të ushtarakëve me popullsinë lokale.

Forma të tilla bashkëpunimi mund të jenë: përdorimi i impianteve publike ose private; krijimi i kushteve lehtësuese ekonomike për hyrjen dhe ndjekjen e shfaqjeve teatrale dhe sportive, muzikore dhe kulturore në objektet që zotëron Komuna, Provinca ose Rajoni; planifikimi i koncerteve kulturore dhe shfaqjeve kinematografike brenda kazermave;

⁸ Art.8 e 9, D.P.R, 4 novembre 1979, n 619. "Regolamento di attuazione della Rappresentanza Militare"

promovimi i iniciativave të ndryshme për parandalimin e drogave; organizimi i vizitave kulturore edhe me pjesëmarrjen e studentëve civilë, etj.

Këshillat bazë të përfaqësimit me përfaqësuesit e tyre, në koordinim me “bërthamat për mbështetjen e familjeve të ushtarakëve” me misione jashtë, mbështesin familjet e ushtarakëve në plotësimin e praktikave administrative si dhe në raste urgjencash dhe sëmundjesh të rënda.

c) Ndarja e Personelit

*Si objekt i sistemit të përfaqësimit janë ushtarakët e ushtrisë, marinës, aviacionit, karabinierisë, policisë financiare (guardia di finanza) dhe kapitanerisë së porteve.*⁹ Për qëllime përfaqësimi dhe organizimi personeli ushtarak ndahet në disa kategori:

Kategoria A: Oficerët dhe aspirantët oficerë të shërbimit të përhershëm

Kategoria B: Nënoficerët e shërbimit të përhershëm

Kategoria C: Profesionistët (studentet e akademive, studentët e shkollave ushtarake, studentët nënoficerë të karabinierisë, financës)

Kategoria D: Oficerët dhe aspirantët për oficerë të plotësimin

Kategoria E: Ushtarët e shërbimit të detyrueshëm ushtarak

Ndërmjet përfaqësuesve të zgjedhur nuk bëjnë pjesë kapelanët dhe ushtarakët e policisë gjyqësore. Të parët sepse nuk konsiderohen ushtarakë dhe të dytët për faktin se statusi i tyre është i njëjtë me atë të funksionarëve civilë.

4. Mënyra e funksionimit dhe ushtrimit të përfaqësimit.

a) Ushtrimi i të drejtës së përfaqësimit

Ushtarakët e zgjedhur si përfaqësues përfaqësojnë kategoritë e personelit ku bëjnë pjesë. Ata zhvillojnë veprimtarinë e tyre

⁹ Art. 2 e 3, D.P.R. 4 novembre 1979, n 619. “Regolamento di attuazione della Rappresentanza Militare”

“për arsye shërbimi”. Ushtrimi i mandatit të tyre është i kufizuar dhe ndërkohë mban në konsideratë edhe të drejtat dhe detyrat që burojnë nga statusi i ushtarakut. Anëtarëve përfaqësues të organeve përkatëse u krijohen kushte dhe u sigurohet koha e nevojshme për ushtimin e mandatit të tyre, me përjashtim të rasteve, të cilat kanë të bëjnë me nevoja operationale dhe shërbimi, të cilat nuk mund të zgjidhen ndryshe.

Delegatëve u ndalohej të formulonin mendime, propozime dhe kërkesa që s’janë kompetencë e tyre; të lëshojnë komunikata shtypi ose deklarata ose të zhvillojnë veprimtari përfaqësimi jashtë organeve; të kenë raporte të çdo lloji jashtë forcave të armatosura; të zhvillojnë veprimtari, e cila është kompetencë e organeve kolegjiale të përfaqësimit; të grumbullojnë firma për qëllime të ushtimit të veprimtarisë së tyre. Të drejtën e komunikimit me shtypin dhe të bërjes së deklaratave e ka organi qendror i përfaqësimit të ushtarakëve.

Kohëzgjatja e mandatit të tyre është e ndryshme dhe kjo varet nga kategoria e personelit që përfaqësojnë. Në tërësi ajo varion nga 6 muaj deri në tre vjet: p.sh. për oficerët e shërbimit të përhershëm është 3 vjet, për profesionistët nga 1-3 vjet dhe për ushtarët e shërbimit të detyrueshëm 6 muaj. Kohëzgjatja e mandatit të kursantëve, akademistëve, studentëve përgjithësisht përputhet me kohëzgjatjen e kursit, por nuk duhet të kalojë 1 vit, ndërsa për ushtarakët e misionë në komandat e NATO-s, etj. kjo periudhë përputhet me kohën e qëndrimit të personelit jashtë dhe duhet të jetë nga 6 muaj deri në 2 vjet.

Ushtarakët e zgjedhur si përfaqësues mund të lënë mandatin e tyre në rast se:¹⁰ ushtaraku del në rezervë; ndryshon kategorinë, të cilës i përket; transferohet dhe kur ka marrë dy vërejtje për shkak të shkëljes së normave të përcaktuara për ushtimin e përfaqësimit, etj. Gjithashtu, në mënyrë të detajuar specifikohen edhe raportet ndërmjet delegatëve gjatë mbledhjes së këshillave. Ushtaraku me gradën më të lartë, ose më i vjetri në moshë merr edhe përfaqësimin e këshillit

¹⁰ Art. 13 dh 19, D.P.R., 4 novembre 1979, n 619. “Regolamento di attuazione della Rappresentanza Militare”

në cilësinë e presidentit të tij. Veprimtaria e ushtarakëve si përfaqësues në organe të përfaqësimit është objekt i vlerësimit dhe i dokumentimit në dokumentet karakteristike.

b) Procedurat elektorale

Zgjedhja e përfaqësuesve bëhet nëpërmjet zbatimit të një sistemi zgjedhor direkt, nominativ dhe të fshehtë në radhët e FA-ve. Zgjedhjet mbahen me një urdhër të përbashkët të ministrit të Mbrojtjes dhe atij të Financave. Ministri i Mbrojtjes përcakton afatin e zhvillimit të tyre. Brenda 15 ditësh nga zgjedhja e përfaqësuesve të organeve bazë të përfaqësimit zgjidhen përfaqësuesit e organit qendror dhe atyre të ndërmjetme. Gjatë zhvillimit të zgjedhjeve lejohet zhvillimi i fushatës verbale ose të shkruar. Nuk lejohet përdorimi i filmave, diapozitivave, pllakateve, tabelave, etj. Fushata fillon 10 ditë para zhvillimit të zgjedhjeve. Ajo mbahet brenda kazermave, zhvillohet brenda orarit të punës dhe vazhdon jo më shumë se 2 ditë.

c) Veprimtaria e organeve të përfaqësimit

Organe të përfaqësimit të ushtarakëve siç e kemi thënë edhe më lart e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin përkatës dhe rregulloret e nxjerra për këtë qëllim. Në lidhje me fushat e përgjegjësive dhe kompetencat respektive organet e përfaqësimit, pasi sigurojnë informacionin e nevojshëm, bëjnë propozime, kërkesa ose japin mendime kundrejt organeve më të larta të përfaqësimit. Organi qendror i përfaqësimit të ushtarakëve në ushtrimin e përgjegjësive të tij u drejtohet organeve më të larta të piramidës politiko-ushtarake si dhe komisioneve të parlamentit italian. Me kërkesën e tij COCER mund të dëgjohet direkt nga komisione të veçanta të dhomës së deputetëve.

5. Konkluzion

Duke ushtruar veprimtarinë e saj për gati 30 vjet, përfaqësia e ushtarakëve - si formë e sindikalizmit në Forcat e Armatosura

Italiane - ka luajtur një rol efektiv në mbrojtje të të drejtave kolektive të ushtarakëve. Ajo ka rritur pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e ushtarakëve në çështje të tilla si kushtet, trajtimi, mbrojtja ekonomike, juridike, shëndetësore, sigurimet shoqërore, etj. Një sektor i rëndësishëm për veprimtarinë e saj këshilluese dhe propozuese ka rezultuar fusha e mbrojtjes sociale të ushtarakëve dhe kontributi i saj gjatë përgatitjes së buxhetit të mbrojtjes. Druajtja për krijimin e këtyre organeve në Forcat e Armatosura italiane nuk rezultoi reale. Kursesi veprimtaria e tyre nuk e ka cenuar misionin dhe organizimin hierarkik të FA-ve. Përkundrazi, si mbrojtëse të interesave të ushtarakëve, këto shoqata janë “ndihmëse” të organeve komanduese të FA-ve. Nisur nga ky realitet, tashmë organet e përfaqësimit në FA-ve italiane janë përfshirë nga debati për reformimin e tyre dhe transformimin në shoqata sindikale të vërteta.

Kolonel Skënder KADIU është Shef i Departamentit të Operacioneve në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”

Arben Zani

SHOQATA E USHTARAKËVE GJERMANË

“Shoqata e Ushtarakëve Gjermanë”, ose siç u quajt ndryshe “Koalicioni për të drejtat e Ushtarakëve” u themelua më 14 korrik të vitit 1956. Mbështetur në Nenin 9, pika 1 dhe 3 të Ligjit Themelor Gjerman, 55 ushtarakë, oficerë, nënoficerë dhe ushtarë të Shkollës së Trupave Tankiste, nisur nga bindja e tyre se interesat e ushtarakëve dhe familjarëve të tyre do të respektoheshin më mirë nëpërmjet një përfaqësie të tyre profesionale, themeluan “Koalicionin për të drejtat e Ushtarakëve”, i cili nuk ishte një organizatë sindikaliste, por një shoqatë që përfaqësonte interesat e Ushtarakëve Gjermanë.

Megjithëse lëvizja sindikaliste gjermane fillimet e saj i ka rreth vitit 1848, me themelimin e shoqatave lokale të punëtorëve, ushtarakëve gjermanë asnjëherë nuk iu dha e drejta për t’u organizuar në shoqata dhe organizata të tilla për të mbrojtur interesat e tyre. Lëvizja sindikaliste pësoi një rritje të ndjeshme, megjithëse deri në fund të sundimit perandorak nuk u njoh nga ana ligjore. Në këtë kuadër edhe një përfaqësim i interesave të ushtarakëve nëpërmjet organizatave të tilla ishte i pakonceptueshëm. Mbështetjen e saj ligjore kjo lëvizje e gjeti vetëm në Kushtetutën e Republikës së Veimarit, e cila siguronte lirinë për krijimin e shoqatave dhe organizatave, që do të bënin të mundur ruajtjen dhe nxitjen e kushteve të punës dhe atyre ekonomike për të gjithë qytetarët dhe profesionet. Kjo krijoi dhe bazën teorike që dhe ushtarakët të organizoheshin. Kështu në muajt e fundit të Luftës së Parë Botërore dhe më vonë u themeluan disa shoqata dhe organizata. Më të rëndësishmet nga këto ishin: Bashkimi i Oficerëve Gjermanë, në nëntor të vitit 1918 dhe Shoqata Kombëtare e Oficerëve Gjermanë, në dhjetor të vitit 1918. Në mars të vitit 1919 brenda ligjit për krijimin paraprakisht, të një Force të Armatosur, u hodhën

bazat për zgjedhjen dhe veprimtarinë e personave të besueshëm. Në qershor të vitit 1920, me një urdhëresë të presidentit të atëhershëm, u krijuan të ashtuquajturat “Dhoma e Përkohshme e Forcave Tokësore” dhe “Dhoma e Përkohshme e Forcave Detare”. Të dyja këto institucione do të kishin funksione konsultative, si për shembull në hartimin e drafteve ligjore në fushën e mbrojtjes, sipas specialitetit përkatës.

Me gjithë anët pozitive që kishte Kushtetuta e Republikës së Veimarit, në fushën ushtarake asnjëherë nuk u krijua një shoqatë, organizatë, ose edhe një sindikatë profesioniste e ushtarakëve aktivë. Arsyeja për këtë ishte ligji për shërbimin ushtarak i vitit 1921, i cili në kundërshtim me kushtetutën, i hiqte ushtarakëve të drejtën e lirisë së formimit të koalicioneve.

Me ardhjen në fuqi të nacionalsocialistëve, në ligjin për disa ndryshime në ligjin për shërbimin ushtarak, datë 20 qershor 1933, u shfuqizuan të dyja institucionet në Forcat e Armatosura, si institucioni i personit të besuar ashtu dhe ai i dhomave të përkohshme për të dyja forcat. Ky ishte dhe hapi i parë në rrugën drejt diktaturës. Në rrugë ilegale u shfuqizuan dhe ato pak organizata sindikaliste të krijuara deri atëherë dhe vendin e tyre në rrugë jozyrtare e zuri “Fronti Punëtor Gjerman”. Në rrugë formale sindikatat e lira u shfuqizuan me një ligj të datës 24 tetor 1934 dhe u zëvendësuan me “Frontin Punëtor Gjerman”. Me heqjen e të drejtës për krijimin dhe marrjen pjesë në koalicione, u hoq dhe mundësia e ushtarakëve për t’u organizuar edhe nëse ata do ta dëshironin një gjë të tillë.

Ligji Themelor i Republikës Federale Gjermane, i vitit 1949, jo vetëm që lejoi përsëri organizimin e lirë të punëmarrësve në sindikata, ose shoqata profesionale, por edhe ktheu të drejtën e qytetarëve për të formuar koalicione në një të drejtë themelore të tyre. Në ligjin Themelor të Republikës Gjermane dhe pikërisht në Nenin 9, pika 1 dhe 3, thuhet:

Të gjithë qytetarët gjermanë gëzojnë të drejtën e formimit të shoqatave dhe organizatave. E drejta e formimit të shoqatave, për ruajtjen dhe nxitjen e kushteve të punës dhe atyre

ekonomike, është e garantuar për të gjithë qytetarët dhe për të gjitha profesionet. Marrëveshjet që kërkojnë të kufizojnë, ose të pengojnë këtë të drejtë janë të pavlefshme, të gjitha masat e marra në këtë drejtim janë të kundërligjshme.

Mbështetur në këtë të drejtë kushtetuese, ushtarakët gjermanë u organizuan dhe themeluan “Shoqatën e Ushtarakëve Gjermanë”, e cila kishte si qëllim përfaqësimin e interesave profesionale dhe sociale të ushtarakëve në organet parlamentare dhe administrative të Republikës Gjermane. Për realizimin e këtij qëllimi, menjëherë pas themelimit të kësaj shoqate u përcaktuan dhe detyrat kryesore të saj:

1. Bashkëpunimi në përgatitjen e legjislacionit, në fushën e karrierës, trajtimit financiar dhe përkujdesjes së ushtarakëve.
2. Këshillimi dhe mbrojtja në fushën juridike për të gjitha aspektet që përmban profesioni i ushtarakut.
3. Mbrojtja e të drejtave themelore të ushtarakëve, të cilat janë të garantuara me kushtetutë.

Kjo shoqatë e re, menjëherë pas themelimit të saj, përpunoi dhe parimet bazë të punës së saj:

1. Organizimi, arsimimi dhe drejtimi ushtarak i trupave nuk bën pjesë në kompetencat e Shoqatës.
2. Rregullorja dhe disiplina ushtarake duhet të zbatohen prej saj pa kufizime.
3. Kërkimi dhe mbrojtja e të drejtave nuk duhet kurrsesi të cenojnë frymën e traditës dhe të virtytit të rregulloreve ushtarake për disiplinën.
4. Besnikëria e të gjithë ushtarakëve përballë shtetit parlamentar-demokratik të së drejtës.
5. Duke u nisur nga përvoja historike e Gjermanisë, shoqata duhet të kristalizohet si një bashkim i lirë profesional i anëtarëve të saj, ku të respektohet forma demokratike e shtetit.
6. Shoqata përpara së gjithash duhet t’i shërbejë detyrave të etikës profesionale, por njëkohësisht nuk duhet të nënvleftësojë

dhe interesat materiale të ushtarakëve, për të dhënë kontributin e saj në krijimin e një rregulloreje moderne dhe sociale për Forcat e Armatosura.

7. Shoqata duhet të jetë në të njëjtën masë e hapur për të gjithë ushtarakët e Forcave të Armatosura Gjermane, qofshin ata oficerë, nënoficerë apo ushtarë.

Më 14 korrik 2007, Shoqata e Ushtarakëve Gjermanë përmbush një histori 51-vjeçare dhe është një institucion mbipartiak dhe financiarisht i pavarur, i cili tashmë përfaqëson interesat e 210.000 anëtarëve – ushtarë të shërbimit të detyrueshëm ushtarak, ushtarakë aktivë dhe rezervistë të të gjitha gradave, si dhe familjarë të tyre. Shoqata njeh dhe mbron principin e “qytetarit në uniformë”, i cili parimisht gëzon të njëjtat të drejta dhe detyrime si çdo qytetar tjetër. Mbështetur në këtë princip si dhe për të realizuar detyrën e saj, ajo bashkëpunon ngushtë me të gjitha organet parlamentare dhe qeveritare dhe me shumë organizata ndërkombëtare, në hartimin e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore që prekin interesat e ushtarakëve dhe familjarëve të tyre.

Për të pasur një përfaqësim sa më të mirë dhe sa më të gjerë të interesave të ushtarakëve, shoqata ka një strukturë me tre nivele: strukturat vendore, strukturat rajonale (filialet veri, jug, lindje, perëndim) dhe strukturat kombëtare. Anëtarësimi në shoqatë është i lirë dhe anëtarë të shoqatës mund të jenë: ushtarakë profesionistë, ushtarakë me kontratë të kufizuar në kohë, ushtarë të shërbimit të detyrueshëm ushtarak, ish-ushtarakë, ushtarakë të shërbimit në rezervë si dhe familjarë të të gjithë këtyre që përmendëm më sipër.

Të gjithë anëtarët e shoqatës janë të detyruar të përfaqësojnë interesat e shoqatës dhe të nxisin realizimin e qëllimeve të saj. Ndalohet anëtarësimi njëkohësisht i anëtarëve të shoqatës në organizata të tjera, veprimtaria e të cilave është e drejtuar kundër shtetit demokratik të së drejtës, forcave të armatosura gjermane dhe qëllimeve të kësaj shoqate.

Aktiviteti i shoqatës drejtohet nga organet kryesore të saj, të cilat janë: asambleja kombëtare, konferenca kombëtare, kryesia, asambleja rajonale dhe kryesia rajonale. Asambleja

kombëtare e shoqatës zhvillohet një herë në katër vjet. Përveç bilancit të punës katërvjeçare, asambleja zgjedh drejtuesit e rinj të organeve të saj për katërvjeçarin pasardhës. Vendimet e shoqatës në përgjithësi merren me shumicë të thjeshtë votash. Ndërmjet hapësirës kohore të zhvillimit të dy asambleve duhet të zhvillohet të paktën një konferencë kombëtare, e cila përbëhet nga anëtarët e kryesisë kombëtare dhe rajonale. Konferenca ka karakter informativ dhe merr masat e duhura për vënien në jetë të vendimeve të asamblesë. Kjo mënyrë e drejtimit të shoqatës shtrihet deri në rang rajonal.

Si organ kryesor drejtues i shoqatës është kryesia e shoqatës. Kryesia ndjek zbatimin e vendimeve të asamblesë kombëtare dhe është përgjegjëse për hartimin e raportit vjetor për konkretizimin e të gjitha këtyre vendimeve. Në kuadër të realizimit të qëllimit të saj, shoqatës i është vënë në dispozicion dhe një zyrë koordinimi me organet e Bashkimit Evropian në Bruksel.

Është e natyrshme që mbas 51 vjetësh punë intensive, të përmendësh edhe disa nga sukseset që kjo shoqatë ka arritur gjatë kësaj kohe. Kështu një nga sukseset më të reja që ka arritur Shoqata është miratimi i ligjit të ri mbi trajtimin e ushtarakëve në misionet paqeruajtëse. Në vitin 2001 me ndikimin direkt të shoqatës u arrit t'i jepej fund ndalimit të profesionit të ushtarakut për gratë, të cilat deri në atë kohë shërbenin vetëm në mjekësinë ushtarake dhe jo në trupat luftarake.

Përfaqësimi i interesave të ushtarakëve, në Republikën e Gjermanisë, krahas Shoqatës së Ushtarakëve, realizohet edhe nëpërmjet institucionit “I dërguari i Parlamentit Gjerman për Forcat e Armatosura”. Ky institucion është një organ ndihmës i parlamentit, nëpërmjet të cilit ai realizon kontrollin parlamentar mbi Forcat e Armatosura, mbron të drejtat themelore të ushtarakëve dhe mbikëqyr zbatimin e parimeve bazë të drejtimit të brendshëm në Forcat e Armatosura. I dërguari i Parlamentit Gjerman zgjidhet nga parlamenti nëpërmjet votimit të fshehtë. Të drejtën për propozim e ka Komisioni Parlamentar i Mbrojtjes, Grupet Parlamentare si dhe një grup i caktuar deputetësh. Të drejtën për t'u zgjedhur

në këtë detyrë e ka çdo qytetar gjerman që gëzon të drejtën për t'u zgjedhur në parlament.

Mbështetur në udhëzimet e Parlamentit Gjerman ose të Komisionit Parlamentar të Mbrojtjes, ky institucion ngarkohet me detyrën e kontrollit të procedurave të ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave themelore të ushtarakëve dhe zbatimin e parimeve bazë të drejtimit të brendshëm, në Forcat e Armatosura. Për realizimin e misionit të tij, i dërguari i Parlamentit Gjerman për Forcat e Armatosura ka autorizimin e Parlamentit për të marrë informacione nga të gjithë personat dhe instancat që janë në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Për procedura që kanë të bëjnë me ankesa të ndryshme të ushtarakëve thërret dhe dëgjon dëshmitarë që do ta ndihmonin në sqarimin e problemeve që ngrihen në këto ankesa. Mund të vizitohet në çdo kohë dhe pa paralajmërim të gjitha repartet dhe nënrepartet e Forcave të Armatosura Gjermane.

Të gjithë ushtarët e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, në fillim të kohës së tyre të shërbimit duhet të udhëzohen dhe të njihen nga eprorët e tyre për detyrat dhe kompetencat e këtij institucioni. Veçanërisht këto udhëzime duhet të përqendrohen në:

- a) Çdo ushtar gëzon të drejtën që për çdo problem, pa marrë parasysh rrugën e hierarkisë, t'i drejtohet këtij institucioni, duke përdorur të dhënat e tij personale. Çdo ushtari duhet t'i bëhet e njohur adresa dhe numri i telefonit i këtij institucioni.
- b) Ushtarakëve nuk u lejohej t'i drejtohen këtij institucioni në mënyrë kolektive.
- c) Pengimi i ushtarakëve nga eprorët e tyre për t'iu drejtuar institucionit të të dërguarit të parlamentit për Forcat e Armatosura, nëpërmjet urdhrave, kërcënimeve, premtimeve ose dhe dhuratave përbën thyerje disiplinore dhe njëkohësisht dhe vepër penale.
- d) Çdo ushtarak që i është drejtuar këtij institucioni duhet të trajtohet njësoj si të gjithë ushtarët e tjerë. Çdo veprim tjetër do të përbënte një thyerje disiplinore dhe mund të ndiqet penalisht.

Për të gjitha këto probleme, si dhe për të pasqyruar punën e tij vjetore, ky institucion duhet të raportojë me shkrim, një herë në vit, në parlament. Në raportin vjetor pasqyrohen problemet kryesore të këtyre fushave:

- Misionet paqeruajtëse jashtë kufijve të Gjermanisë
- Drejtimi ushtarak
- Politikat e personelit
- Femra në Forcat e Armatosura
- Shërbimi i detyrueshëm ushtarak
- Shërbimi rezervist
- Problemet e logjistikës
- Përkujdesja shëndetësore
- Trajtimi financiar
- Arsimitimi në FA
- Ekstremizmi i djathtë

Ndërmjet punës së këtij institucioni dhe Shoqatës së Ushtarakëve Gjermanë, ekzistojnë shumë paralele dhe pika të përbashkëta.

Kontaktet e vazhdueshme që institucioni “I të dërguarit të parlamentit gjerman për FA” me “Shoqatën e Ushtarakëve Gjermanë”, bën të mundur pasqyrimin e shumë problemeve të kësaj shoqate në raportin vjetor dërguar Parlamentit Gjerman. Përvoja e deritanishme ka dëshmuar se veprimtaria e këtyre institucioneve synon të harmonizojë detyrimin e ushtarakëve për të zbatuar kufizimet e të drejtave qytetare që burojnë nga ligji dhe veçoritë e profesionit, nga njëra anë, me tendencat burokratike të instancave eprore për të abuzuar me sloganin “në emër të shtetit, në emër të detyrës”.

Leo Michel

VENDIMMARRJA NË NATO: SI FUNKSIONON “RREGULLORJA E KONSENSUSIT?”

1. Hyrje

Në deklaratën e Samitit të Rigës në nëntor 2006, të 26 kryetarët e shteteve dhe të qeverive ripohuan që “NATO qëndron e hapur për pranimin e anëtarëve të rinj, sipas Nenit 10 të Traktatit të Atlantikut të Veriut”.¹ Siç pritej, kjo nuk u realizua për asnjë prej tri vendeve që zyrtarisht njihen si aspirantë - Kroacia, Maqedonia dhe Shqipëria. Megjithatë ata specifikuan se në samitin e radhës më 2008 “Aleanca synon që t’u ofrojë ftesa atyre vendeve që plotësojnë standardet e bazuara në performancën dhe që janë në gjendje të japin ndihmesë për sigurinë dhe stabilitetin evro-atlantik. Kjo i jep Kroacisë nxitje dhe kohë për zbatimin e reformave dhe ristrukturimet e nevojshme për t’u siguruar se do të ftohet të jetë pjesë e Aleancës. Kjo i jep publikut kroat më shumë kohë që të kuptojë, debatojë dhe të mbështesë aktivisht përgjegjësitë e pandashme të anëtarësimit në NATO. (Sigurisht që nuk është rastësi që Kroacia është i vetmi aspirant, të cilit deklarata e Samitit i sinjalizoi kërkesën “për t’u siguruar që aspiratat e saj për anëtarësim të përkrahen nga një mbështetje më e madhe popullore.”)

Për të shkuar drejt qëllimit për të zhvilluar këtë mbështetje publike, është e rëndësishme të kuptohet thelbi i vendimmarrjes së NATO-s.

¹ Varianti original i artikullit: Leo Michel, “NATO Decisionmaking: How the ‘Consensus Rule’ Works”, *Croatian International Relations Review*, 12 (42/43): 7-14 (shën. i red.).

2. ABC-ja e konsensusit

Megjithëse *cognoscenti* e çështjeve të sigurisë ndërkombëtare shpesh i referohen rregullores së konsensusit të NATO-s, Traktati i Atlantikut të Veriut nuk e specifikon se si duhet të merren vendimet e përbashkëta, me një përjashtim: dispozita e Nenit 10 thotë se “marrëveshja e njëzëshme” është e nevojshme për ta ftuar një shtet t’i bashkohet Aleancës. Me mungesën e një procedure të qartë votimi, NATO ka zhvilluar një sërë praktikash që janë bërë tashmë një ligj i pashkruar.

Shumica e vendimeve bazohen në një projekt-propozim që qarkullon te të gjithë aleatët nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili kryeson Këshillin e Atlantikut të Veriut (North Atlantic Council - NAC), ose nga kryetari i një prej qindra komiteteve dhe grupeve të punës të NATO-s.² Këto projekt-propozime mund të iniciohen nga Sekretari i Përgjithshëm, IS ose nga ndonjëri prej Aleatëve. Përgjithësisht propozimet e shkruara paraprihen nga konsultime në një larmi forumesh, përfshirë diskutime dypalëshe dhe shumëpalëshe në kryeqytetet e Aleatëve, misionet e Aleatëve në zyrat qendrore të NATO-s, në NAC dhe në komitetet dhe grupet e punës të themeluara nga NAC. Këto konsultime janë të dobishme – vërtet në disa raste janë mjaft kritike – për identifikimin e shqetësimeve apo kundërshtimeve të mundshme në gjirin e Aleatëve si dhe për t’i dhënë formë zgjidhjeve të pranueshme për të gjithë.

Kur është i nevojshëm një vendim i shkruar ose deklaram i pozicionit, shpesh ndodh që disa apo të gjithë Përfaqësuesit e Përhershëm (Perm Rep) nuk mund të ofrojnë pozicionet përkatëse kombëtare në përfundim të një takimi të caktuar të NAC apo komitetit tjetër. Në këto raste, Sekretari i Përgjithshëm ose kryetari i komitetit në fjalë mund të zgjedhë ta qarkullojë projekt-propozimin sipas një procedure të

² Shumica e komiteteve dhe e grupeve të punës së NATO-s kryesohen nga një anëtar i Stafit Ndërkombëtar (International Staff - IS) të NATO-s; me raste, me miratimin e Aleatëve të tjerë, kryetari mund të jetë një zyrtar me karrierë të gjatë që dërgohet nga kryeqyteti i vendit të tij, ose që shërben në një prej delegacioneve të përhershme të NATO-s.

heshtjes.³ Nëse asnjëri prej aleatëve nuk e “thyen heshtjen” – pra nuk e lajmëron IS me shkrim mbi kundërshtitë që ai ka, përpara kufirit të afatit të vendosur nga Sekretari i Përgjithshëm ose kryetari i Komitetit – atëherë propozimi konsiderohet i miratuar. Sidoqoftë, nëse një ose më shumë aleatë e thyejnë heshtjen, propozimi normalisht kthehet mbrapa në institucionin përkatës për t’u ripunuar në atë formë që të arrihet konsensusi. Si rregull, NATO nuk i identifikon publikisht se cilat vende e thyejnë heshtjen, ndonëse pozicionet e vendeve të veçanta mund t’i bëhen të njohura shtypit (ndonjëherë nga vetë vendet që thyejnë heshtjen) në qoftë se çështja është e kundërshtueshme. Veç kësaj, meqë nuk ka procedurë formale votimi, gjithashtu nuk ka as procedurë formale abstenimi.

Sekretari i Përgjithshëm në mënyrë rutinë ndihmon në arritjen e konsensusit ndërmjet diskutimeve jozyrtare me Perm Rep ose grupe të Perm Rep. Ai kërkon të ndikojë diskutimet e Aleancës nëpërmjet deklaratave publike dhe takimeve private e korrespondencën me zyrtarët me karrierë të gjatë, legjislatorë apo udhëheqës opinionesh të qeverive Aleate. Sidoqoftë, Sekretari i Përgjithshëm ose zyrtarë të tjerë të IS nuk mund të anulojnë pozicionin e një Aleati. Në të vërtetë, çdo përpjekje nga zyrtarë të NATO-s për të mos konsideruar kundërshtimet e një Aleati do të shkaktonte protesta të Aleatëve të tjerë që janë syçelët ndaj ndonjë precedenti që do të zvogëlonte privilegjet e tyre në të ardhmen.⁴

³ Çdo Aleat përfaqësohet në Këshillin e Atlantikut të Veriut (NAC) nga një Përfaqësues i Përhershëm (Perm Rep) në nivel ambasadori. Normalisht NAC mblidhet të paktën një herë në javë dhe, në varësi të çështjes, disa Perm Rep mund të kenë nevojë për udhëzim ose miratim nga autoritete më të larta në kryeqytetet e tyre. NAC mblidhet disa herë në vit në nivelet e ministrave të Jashtëm dhe të Mbrojtjes dhe mban samite periodike në nivelin e kryetarëve të shteteve dhe të qeverive. Rregull i konsensusit zbatohet edhe në vendimet apo deklaratat e bëra në takimet ministrore dhe samitet.

⁴ Praktika të ngjashme të zakonshme zbatohen në autoritetet ushtarake të NATO-s (NATO military authorities - NMA), të kryesuar nga Komiteti Ushtarak (Military Committee - MC). MC përfshin një përfaqësues ushtarak nga secili vend Aleat dhe kryetari i Komitetit Ushtarak i raporton dhe udhëzohet politikisht nga NAC. Stafi Ushtarak Ndërkombëtar, Komandanti Suprem i Aleancës, Komandanti Suprem i Aleancës në Evropë (SACEUR) dhe shtabet e komandave të tjera janë pjesë e strukturës së NMA.

3. Fuqia e rregullores

Rregullorja e konsensusit përfaqëson më shumë se një procedurë mekanike të vendimmarrjes. Ajo pasqyron strukturën e NATO-s si një aleancë e vendeve të pavarura dhe sovrane dhe jo si një ent mbikombëtar. Rregullorja është shembull i etosit e përkushtimit të organizatës ndaj mbrojtjes kolektive “një për të gjithë, të gjithë për një”.⁵ Vendimet e NATO-s janë shprehje e vullnetit të përbashkët të qeverive anëtare dhe si të tilla ato merren me miratim të përbashkët. Sipas rregullores, asnjë Aleat nuk mund të detyrohet të miratojë një pozicion apo të bëjë një veprim kundër dëshirës së vet. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për vendime mbi përdorimin potencial të forcës ushtarake, të cilat janë të ndjeshme politikisht për çdo Aleat.

Madje Neni 5, çelësi i dispozitës së mbrojtjes kolektive të Traktatit, nuk e specifikon natyrën e ndihmës që duhet të sigurohet nga çdo Aleat në rast të një sulmi kundër territorit të njërit prej Aleatëve. Është e rëndësishme të kujtojmë se Ekzekutivi i SHBA-ve, i cili ishte përgjegjës për negociimin e Traktatit, nguli këmbë për një gjuhë të kualifikuar në Nenin 5 për zbutjen e problemeve në Kongres. Kongresi i SHBA-ve, i cili ka autoritetin sipas kushtetutës të shpallë luftë, nuk donte t’ia dorëzonte këtë fuqi organizatave shumëpalëshe. Në të njëjtën kohë, rregullorja e konsensusit e lejon NATO-n të respektojë legjislacionet kombëtare të veçanta që mund të ndikojnë në aftësinë e Aleatëve për të kontribuar në operacione të caktuar të NATO-s. Për shembull, Norvegjia dhe Danimarka nuk lejojnë vendosjen e trupave apo armëve bërthamore në territorin e tyre në kohë paqeje. Në mënyrë të ngjashme, ligji gjerman kërkon një shumicë të thjeshtë parlamentare për miratimin e angazhimeve ushtarake jashtë Gjermanisë, ndërsa ligji hungarez kërkon një shumicë të cilësuar prej dy të tretave.⁶ Islanda nuk ka një forcë ushtarake

⁵ Motoja “një për të gjithë, të gjithë për një” gjendet në romanin *Tre Mosketierët* të Aleksandër Dymasë.

⁶ Kushtetuta e Kroacisë thotë që “Forcat e Armatosura të Republikës së Kroacisë mund të dalin jashtë kufijve ose të veprojnë në kufi vetëm më një vendim paraprak të Parlamentit Kroat”. Kushtetuta, gjithashtu, përcakton se vendimet mbi pozicionimin e Forcave të Armatosura “duhet

kombëtare. Sipas rregullores, NATO mund të ndërtojë solidaritet politik dhe ushtarak nëpërmjet Aleancës si një e tërë pa u imponuar standarde të njëjta anëtarëve të ndryshëm të Aleancës.

Rregullorja e konsensusit e detyron Aleancën të ndërmarrë konsultimet në shkallën më të gjerë të mundshme në mënyrë që të ndërtojë mbështetje për idetë e veta. Asnjë Aleat, i madh apo i vogël mund të merret i mirëqenë. Pavarësisht rolit të spikatur në Aleancë, SHBA mbështeten në rregulloren e konsensusit për të mbrojtur interesat e veta, formësuar këndvështrimet e të tjerëve dhe integruar idetë të ofruara nga të tjerët për përmirësimin e propozimeve të veta. Për më tepër, ndikimi i rregullores së konsensusit është nënvizuar nga fakti që NATO merr mijëra vendime çdo vit, secili prej të cilëve është i lidhur drejtpërsëdrejti ose jo me një procedurë konsensusi. Me pak përjashtime, këto vendime klasifikohen sipas pesë kategorive të gjera: strategjitë e përgjithshme politike dhe ushtarake, të cilat janë pasqyruar në dokumente si Koncepti Strategjik i Aleancës dhe në vendime që lidhen me zgjerimin; struktura ushtarake dhe funksionet planifikuese, që mbulojnë fusha si zhvillimin e kapaciteteve, planifikimin e kontingjentit operativ të lidhur me misionet ushtarake potenciale; autorizimi, monitorimi dhe rregullimi i mbrojtjes kolektive dhe operacioneve të menaxhimit të krizave; problemet menaxhuese dhe organizative, përfshirë përcaktimin e përgjegjësisë dhe mbikëqyrjen e operacioneve të IS, Stafit Ushtarak Ndërkombëtar, dhe agjencive të ndryshme të NATO-s; dhe çështjet e burimeve dhe të buxhetit që përfshijnë asetet e përbashkëta të NATO-s, personelin, infrastrukturën dhe financimet operative.

Megjithëse i shenjtë në parim, rregullorja ka rezultuar fleksibël në praktikë, siç dëshmohet në tre raste specifike.

të miratohen me dy të tretat e të gjithë përfaqësuesve”. Së bashku këto dispozita duket se vendosin një prag shumë të lartë për pozicionimin e forcave kroate në raste të urgjencave.

3.1 Lidhja franceze

Pas vendimit të Francës në vitin 1966 për t'u tërhequr nga Struktura e Integruar e NATO-s, Aleatët e tjerë iu drejtuan gjithnjë e më shumë drejt Komitetit Planifikues të Mbrojtjes (Defense Planning Committee - DPC) për të konsideruar dhe vendosur për shumicën e çështjeve të lidhura me planifikimin e mbrojtjes kolektive. I krijuar në 1963, DPC rrallë ishte përdorur përpara tërheqjes së Francës. Në mënyrë të ngjashme, një Grup i Planifikimit Bërthamor (Nuclear Planning Group - NPG), me të njëjtët anëtarë si DPC, u krijua menjëherë pas tërheqjes së Francës, për të diskutuar çështje specifike të politikave lidhur me forcat bërthamore. Pavarësisht aktivizimit në NAC, Franca nuk ishte as e lidhur, as kërkoi të pengonte vendimet e marra me konsensus në DPC ose NPG.

Më 1992, NATO po merrte në konsideratë angazhimin e parë të saj jashtë territorit të vet; ato ishin operacione të mbikëqyrjes detare dhe ajrore në Adriatik, për të mbështetur një Rezolutë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e cila vendosi një embargo të armëve ndaj Jugosllavisë. Aleatët në DPC ranë dakord me konsensus ta diskutojnë çështjen në NAC. Kjo lëvizje zbuti rrugën për pjesëmarrjen e Francës në operacion, i cili favorizohej nga Parisi dhe mirëpritet nga aleatë të tjerë. Kjo, gjithashtu, vendosi një precedent për rolin udhëheqës *de facto* të NAC (ndaj DPC) në operacionet kundërvepruese ndaj krizave pasuese në Bosnjë, Kosovë dhe Maqedoni.

Kështu, ndërsa zyrtarisht Franca ishte jashtë strukturave të integruara ushtarake, ajo ka qenë një aktor i rëndësishëm në vendimmarrje dhe planifikim – si edhe një kontribues kryesor në forca ushtarake – për të tre operacionet që nuk ishin në zbatim të Nenit 5. Ajo mori pjesë në prill 2003 në vendimet e NAC për ta vendosur nën komandën dhe kontrollin e NATO-s në gusht 2003 Forcën Ndihmëse të Sigurisë Ndërkombëtare në Afganistan (International Security Assistance Force - ISAF), forcë e mandatuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Franca, e cila iu bashkua ISAF-it që me formimin e tij në janar 2002, ka vazhduar të marrë pjesë në pozicione komandimi të

ndryshme të në NATO-ISAF si edhe është një kontribues i madh i trupave.

3.2 Kosova

Fushata ajrore e NATO-s në 1999 kundër Republikës Federale të Jugosllavisë është përshkruar gjerësisht - dhe qortuar nga disa - si një “luftë e komitetit”. Rrëfimet e ndryshme dallojnë deri diku për sa i përket procesit të vendimmarrjes së NATO-s gjatë fushatës, por pak prej tyre e sfidojnë ekzistencën e tendosjeve serioze brenda Aleancës. Këto varionin nga çështje që kishin të bënin me legjitimitimin e veprimeve ushtarake të NATO-s pa një vendim të qartë të KS-OKB, deri te strategjia dhe taktikat e ndjekura gjatë konfliktit.⁷ Në balancë, sidoqoftë, rregullorja e konsensusit dha më shumë ndihmë, sesa vështirësoi përpjekjet e suksesshme të NATO-s.

Rregullorja i lejoi Aleatët me këndvështrime të ndryshme - disa theksonin krizat humanitare dhe abuzimet e të drejtave njerëzore, disa të tjerë shqetësoheshin për precedentin e veprimit “sulmues” të NATO-s kundër një shteti sovran – të gjenin një terren të përbashkët sa për të miratuar, ose të paktën të mos pengonin operacionin. Rregullorja ishte veçanërisht e rëndësishme për qeverinë greke, e cila së fundmi vendosi të mos ta thyente heshtjen për vendimet kyçe të NAC për autorizimin e forcës pavarësisht se sondazhet treguan që 95% e publikut e kundërshtonte ndërhyrjen e NATO-s. Në të njëjtën kohë, Greqia zgjodhi të qëndronte jashtë një përfshirjeje të drejtpërdrejtë në operacionet luftarake.

Nuanca midis një procesi vendimmarrës që lejon një Aleat të pranojë në heshtje një vendim të përbashkët (pavarësisht rezervimit të tij publik apo privat) dhe një procedure që duhet të detyrojë që shteti të japë votën “po” ose “jo” në NAC, në pamje të parë mund të duket jo domethënës. Në praktikë, nuanca ka rëndësi të madhe. Në qoftë se Perm Rep do t’u

⁷ Wesley K. Clark, *Waging Modern War: Bosnia, Kosovo, and the Future of Combat* (New York: Public Affairs, 2001) ofron rrëfimin më të hollësishëm deri tani mbi vendimmarrjen gjatë fushatës ajrore në Kosovë.

ishite kërkuar të “ngrenë duart” për miratimin e operacionit, qeveria greke ka mundësi të mos ishte në gjendje t’i bënte ballë trysnisë politike në vend për të votuar kundër. Një lëvizje e tillë nga Greqia mund ta kishte bërë më të lehtë për një ose dy aleatë të tjerë ngurrues që të ndiqnin shembullin e saj.

Fleksibiliteti inherent i rregullit të konsensusit u shfaq në vendimmarrjet mbi strategjinë, afatet kohore dhe taktikat e *Forcës Aleate*. Për shembull, gjatë krizës, NAC shpeshherë vendosi të mos merrej me komitetet vartës. Kjo i mbajti vendimet e prekshme të NAC private dhe lehtësoi vendime të shpejta, normalisht brenda 48-orëve. Pastaj Sekretari i Përgjithshëm Javier Solana luajti një rol kyç në pajtimin e mendimeve të kundërta brenda NAC, duke përdorur një “përmbledhje të diskutimeve”, një nga teknikat e sajuaara për të shmangur vendosjen e papëlqyer në qendër të vëmendjes të çdo anëtari. Për më tepër, NAC i delegoi Sekretarit të Përgjithshëm autoritetin për zbatimin, pezullimin, ose përfundimin e Përgjigjes Ajrore të Kufizuar - faza e parë e luftës ajrore. Në këtë mënyrë, NAC ia kaloi (me konsensus) Sekretarit të Përgjithshëm fillimin e spektrit të paramiruar të sulmeve ajrore. Më vonë pati mospajtime ndërmjet Aleatëve në lidhje me shënjestrat e përzgjedhura për t’u goditur dhe caktimet e misionit, por këto përgjithësisht u zgjidhën nëpërmjet kanaleve dypalëshe jashtë NATO-s dhe përfshinë vetëm pjesëmarrësit e përfshirë drejtpërdrejt.

Në mënyrë të përmbledhur, ndërsa përpjekje të jashtëzakonshme u deshën për të ruajtur gjatë kohëzgjatjes së *Forcave Aleate*, ato ishin jetësore për mbrojtjen e solidaritetit të NATO-s dhe së fundmi për arritjen e objektivat të deklaruara në Kosovë.

3.3. Sulmet e 11 Shtatorit 2001

Rregullorja e konsensusit nuk e ndaloi NATO-n nga kundërveprimi i shpejtë - në fakt, brenda 24 orësh nga sulmet terroriste të 11 Shtatorit – që t’i drejtohej për herë të parë në historinë e saj Nenit 5. Pavarësisht se ndikimi operacional dhe i menjëhershëm i këtij veprimi ishte i papërfillshëm, vendimi

i NAC ishte një paraqitje e fuqishme politike e solidaritetit që u prit ngrohtë nga SHBA. Në fund të fundit, tronditja nga sulmet shpejt u shndërrua në paralajmërime të sulmeve të tjera, të pashmangshme terroriste dhe potencialisht katastrofale.

A e pengoi ekzistenca e rregullores NATO-n nga pretendimi për një rol më të rëndësishëm në luftën kundër terrorizmit, veçanërisht gjatë muajve të parë pas sulmeve të 11 Shtatorit? Me sa duket jo. Faktorë të tjerë e motivuan qartazi qasjen e SHBA, si p.sh. e drejta e padiskutueshme e Amerikës për vetëmbrojtje në përgjigje të një sulmi të drejtpërdrejtë në territorin e vet; një njohje e hershme që NATO nuk mund të bashkërendonte të gjitha mjetet - diplomatike, informative, ekonomike, financiare, zbatimin e ligjit, si edhe ushtarake – e nevojshme për një luftë të gjatë kundër organizatave si Al-Kaeda; dhe nevoja për rekrutuar dhe ruajtur mbështetjen nga pjesa më e madhe e shteteve që nuk bëjnë pjesë në NATO dhe ato shtete myslimane që kundërshtojnë terrorizmin. (Objektivi i fundit e bëri kritike shmangien e dërgimit të çdo sinjali publik që fushata ishte lufta e NATO-s kundër terrorizmit - ose më keq lufta e NATO-s kundër myslimanëve.)⁸ Një faktor shtesë në të menduarit amerikan në lidhje me fushatën në Afganistan ishte kapaciteti i kufizuar i shumicës së aleatëve për të mbështetur goditjen me rreze të gjatë veprimi. Kështu, SHBA mbështetën një rol të rëndësishëm, por jo udhëheqës për NATO-n.

Megjithatë, ekzistenca e rregullores pati disa efekte. Ajo ndoshta lehtësoi marrëveshjen e NAC më 4 tetor 2004 mbi tetë masat specifike të ndihmës së kërkuar nga SHBA, përfshirë angazhimin e pesë sistemeve të kontrollit dhe paralajmërimit ajror (AWACS) për mbrojtje të hapësirës ajrore të SHBA-ve. Procedura e konsensusit i lejoi secilit aleat të kontribuonte në përpjekjen kolektive në zonat e identifikuara të listës së

⁸ Zëvendësekretari i Mbrojtjes, Paul Wolfowitz i diskutoi këto pika në takimin e Ministrave të Mbrojtjes së NATO-s, më 26 shtator 2001. Transkripti i konferencës së tij të shtypit gjendet në http://www.defenselink.mil/news/Sep2001/t09272001_t0926na.html. Duhet theksuar se në atë kohë ministrat e tjerë Aleatë sugjeruan që NATO duhet të merrte udhëheqjen e operacioneve ushtarake kundër Al-Kaedës dhe Talibanëve.

miratuar, por nuk i detyronte aleatët të vepronin në çdo zonë. Në anën tjetër rregulli i konsensusit i dha të drejtën një Aleati - që nuk ishte SHBA - të bllokonte një propozim në NAC në 2001 që mund t'i kishte drejtuar NMA drejt zhvillimit të opsioneve planifikuese në mbështetje të NATO-s në operacionet e ndihmës humanitare në Afganistan.

4. Shqetësime rreth rregullores së konsensusit

Pavarësisht se rregullorja e konsensusit u duk se funksionoi relativisht mirë gjatë vitit 2001, ajo u kritikua në vitin 2002, veçanërisht nga SHBA. Dy lloje shqetësimesh ishin përgjegjës për këtë zhvillim: së pari, efekti i parashikuar i zgjerimit, së dyti, frika nga një rrugë pa krye në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e operacioneve të NATO-s. Ndërsa këto shqetësime ishin të lidhura midis tyre, kishte dhe ndryshime të dukshme në objektivat e tyre të supozuara.

4.1 Ankthet e zgjerimit

Përpara 11 Shtatorit 2001, anëtarët kryesorë të Kongresit dhe disa në ekzekutiv ishin me dy mendje për përmasën e një cikli të pestë të zgjerimit të NATO-s, megjithëse nuk kishte dyshim që Aleanca do t'u jepte ftesën të paktën disa shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore në samitin e Pragës në nëntor 2002.⁹ Nga njëra anë arsyeja gjeopolitike për një zgjerim të fuqishëm për të ndihmuar në plotësimin e një "Evrope të lirë si një e tërë" u pranua gjerësisht.¹⁰ Në anën tjetër, Kongresi në mënyrë të përsëritur sinjalizoi shqetësimin e tij – siç e kishte

⁹ Që nga viti 1949 Aleanca është rritur nga 12 në 26 anëtarë në 5 cikle zgjerimesh, duke pranuar Greqinë dhe Turqinë më 1952, Republikën Federale Gjermane më 1955, Spanjën më 1982 dhe Çekinë, Hungarinë dhe Poloninë më 1999. Në Pragë, NATO ftoi të bëheshin anëtarë të saj Bullgarinë, Estoninë, Letoninë, Lituaninë, Rumaninë, Sllovakinë dhe Slloveninë; të gjithë këto vende u bënë anëtarë më 2004.

¹⁰ Shtëpia e Bardhë, Zyra e Sekretarit të Shtypit, fjala e presidentit para stafit dhe studentëve të Universitetit të Varshavës, Varshavë, Poloni, 15 qershor 2001, që mund të lexohet në <http://www.whitehouse.gov/news/releases/2001/06/20010615-1.html>.

patur përpara hyrjes së Çekisë, Polonisë dhe Hungarisë më 1997 – që të ftuarit e Pragës duhet të jenë të përgatitur politikisht dhe ushtarakisht për t’u bërë “ofruer” dhe jo “konsumues” të sigurisë vis-a-vis NATO-s.

Shqetësimet politike u simbolizuan nga i ashtuquajtimi “problemi Meciar” në Sllovaki. Në 1998, Vladimir Meciar, kryeministri i korruptuar dhe autoritar sllovak qysh prej vitit 1992, u hoq nga pushteti prej një koalicioni të gjerë të partive opozitare, por ai mbeti një forcë politike me influencë. Disa në Uashington shqetësoheshin se mos NATO do të rrezikonte të turpërohej në rast se votat e popullit sllovak do ta sillnin sërish në pushtet Vladimir Meciarin, në kohën kur vendi ishte ftuar tashmë për t’u anëtarësuar në NATO. Të tjerë shqetësoheshin që, pas hyrjes së Sllovakisë në NATO, një qeveri e re e dominuar nga Meciar mund të mos hezitonte të abuzonte me rregulloren e konsensusit dhe do ta paralizonte Aleancën, nëse kjo gjë do t’i shërbente interesave të tij të ngushta politike. Për më tepër, Meciar nuk ishte rast i vetëm; shqetësime të ngjashme ishin përmendur, për shembull, në lidhje me ish-figurat politike rumune dhe bullgare.

Aftësia dhe vullneti i disa aspirantëve të NATO-s për të arritur kapacitetet e tyre mbrojtëse të premtuara Aleancës i shqetësonte ligjbërësit dhe zyrtarët amerikanë. I ashtuquajtimi debati i “ndarjes së barrës” ishte aq e vjetër sa vetë NATO dhe Anëtarët e Kongresit ishin të ndërgjegjësuar se disa Aleatë të vjetër – si edhe Aleatë të rinj, siç ishte Hungaria – dhanë rezultate zhgënjyese kur duhet të siguronin fuqitë dhe kapacitetet që Aleanca kërkonte prej tyre. Disa shqetësoheshin se një zgjerim i fuqishëm do të sillte më shumë “konsumues” të sigurisë brenda Aleancës, duke gërryer efektivitetin e saj ushtarak. Rregullorja e konsensusit nuk ishte shkaku i pamjaftueshmërisë ushtarake të disa Aleatëve. Megjithatë ajo i ndërlikonte përpjekjet për të ushtruar trysni mbi anëtarët me performancë të dobët, të cilët u rezistuan përpjekjeve të SHBA-ve, Sekretarit të Përgjithshëm dhe disa Aleatëve të tjerë, për të botuar më shumë të dhëna mbi aftësitë mbrojtëse të anëtarëve individualë.

Në muajt që pasuan 11 Shtatorin 2001, shqetësime të ngjashme politike dhe ushtarake në lidhje me zgjerimin ranë,

sepse aspirantët dëshmuuan mbështetje për fushatën kundër terrorizmit të udhëhequr nga SHBA dhe në shumicën e rasteve vullnet për të adresuar reformën e mbrojtjes dhe çështje të tjera. Gjatë shqyrtimit të zgjerimit në vitet 2002-2003, komitetet e Senatit dhe të Dhomës së Përfaqësuesve iu kthyen çështjeve të tjera. Shtimi i anëtarëve të tjerë a do të ngadalësonte shndërrimin e nevojitur urgjentisht për t'i dhënë NATO-s aftësitë dhe strukturat për të përballuar kërcënimet e shek. XXI, si terrorizmi, shtetet mbështetëse të tij dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë? Apo, a do ta vështirësonte zgjerimi arritjen e një konsensusi mbi kërcënimet për Aleancën, strategjinë dhe aftësitë e nevojshme për t'i përballuar këto kërcënime dhe - mbi të gjitha - një vendim të menjëhershëm për të ndërmarrë veprime ushtarake, ndoshta parandaluese, për të mbrojtur interesat e përbashkëta të sigurisë?

4.2 Rregullorja nën zjarr

Në qoftë se ankthet e zgjerimit së pari përqendruan vëmendjen e Kongresit në vendimmarrjen e NATO-s, debati brenda Aleancës në lidhje me Irakun në 2003, me sa duket i bindi disa senatorë që rregullorja e konsensusit duhet të ndryshojë. Debati ishte një zgjatim i ndryshimeve të kohës brenda OKB-së. Mbretëria e Bashkuar, me mbështetjen amerikane, favorizoi një Rezolutë të re të Këshillit të Sigurimit të OKB-së që autorizonte hapur përdorimin e forcës kundër Irakut, ndërsa Franca dhe Gjermania e kundërshtuan këtë hap, duke autorizuar përdorimin e forcës kundër Irakut, ndërsa Franca dhe Gjermania kundërshtuan këtë hap. Kur Perm Rep amerikan sugjeroi në fund të janarit që NMA të fillojnë planifikimin për mbrojtjen e Turqisë, duke patur parasysh kërcënimin potencial nga Iraku, Belgjika, Franca, Gjermania dhe, fillimisht, Luksemburgu nxorën pengesa. Një planifikim i tillë, argumentuan ata, në rastin me të mirë ishte i nxituar; në rastin më të keq ai do të dërgonte një sinjal të dëmshëm politik që NATO pranonte atë që zyrtarët Francës e cilësuan “logjika e luftës” me Irakun, duke paragjykuar në këtë mënyrë pozicionet e tyre në OKB.

Debati mori zjarr me kërkesën zyrtare të Turqisë, në 10 shkurt, për konsultime në NAC.¹¹ Si pjesë e atyre konsultimeve Kryetari i Komitetit Ushtarak e informoi NAC në lidhje me kërcënimet e mundshme nga Iraku dhe shpjegoi dhe afatet e nevojshme për përgatitjen e planeve për të rforcuar mbrojtjet turke. Kur Perm Rep i Turqisë kërkoi që NAC të drejtonte NMA-të në përgatitjen e këtyre planeve për konsideratë të NAC, tre Perm Rep Aleatë – shpejt u zbulua që ishin të Belgjikës, Francës dhe Gjermanisë – përsëri kundërshtuan. Pastaj Sekretari i Përgjithshëm Lordi Robertson shpejt qarkulloi vendimin pas së cilës këta tri aleatë formalisht thyen heshtjen. Argumenti, i cili tashmë ishte bërë publik, zgjati për disa ditë më shumë përpara se Belgjika dhe Gjermania të binin dakord, për një sërë arsyesh, drejt një kompromisi shpëtimi: kërkesa e Turqisë u zhvendos nga NAC drejt DPC, ku Franca nuk ishte e përfaqësuar. DPC shpejt arriti konsensus, më 16 shkurt, me udhëzim NMA-ve për përgatitjen e planeve për mbrojtjen e Turqisë, për shembull, me anë të vendosjes së AWACS së NATO-s dhe kapacitetet e mbrojtjes kundër armëve kimike dhe biologjike. NMA-të përfunduan planifikimin në ditët në vazhdim dhe më 19 shkurt, DPC i dha të drejtën NMA-ve për zbatimin e implementimin e ndihmës së rënë dakord për Turqinë.

Pavarësisht se zyrtarë të NATO-s në mënyrë të kuptueshme u përpoqën të bënin paraqitjen sa më të mirë të mundshme ndaj incidentit - Sekretari i Përgjithshëm Robertson e përshkroi atë si “dëm sipër, jo poshtë, vijës së ujit” ndikimi i incidentit, veçanërisht në Uashington, ishte shumë serioz.¹²

¹¹ Neni 4 i Traktatit thotë: “Anëtarët do të konsultohen së bashku sa herë që, sipas opinionit të njërit prej tyre, integriteti territorial, pavarësia politike ose siguria e njërit prej anëtarëve janë të kërcënuara”. Një situatë e ngjashme u shfaq përpara Luftës së Gjirit. Në atë rast, NATO vendosi AWACS në Turqinë Lindore menjëherë pas pushtimit të Kuvajtit, por iu përgjigj me ngadalë një kërkesë pasuese të Turqisë për të përdorur asetet e goditjes ajrore të NATO-s për t’u mbrojtur nga ndonjë sulm i mundshëm iraken. Kjo çështje e fundit u zgjidh pa një kërkesë të Turqisë ndaj Neni 4.

¹² Sekretari i Përgjithshëm Lord George Robertson, fjalim në Institutin Evropian, Uashington, 20 shkurt 2003. Mund të lexohet në <http://www.nato.int/docu/speech/2003/s030220b.htm>

Të paktën për disa, rregullorja e konsensusit e ka humbur dobinë e saj. Siç u tha, Senatori Jack Reed kolegëve të tij në 8 maj “Së pari, unë bie dakord që duhet ta eliminojmë ‘rregulloren e konsensusit’, që është një kërkesë prapanike në statutin e NATO-s që pothuaj e pengoi NATO-n të mbrojë një prej anëtarëve, Turqinë, përpara fillimit të *Operacionit Liria e Irakut...* Së dyti, unë mbështes nevojën për një rregullore të re në NATO që autorizon anëtarët e Aleancës të pezullojnë anëtarësinë e çdo vendi në NATO, i cili nuk mbështet më idealet e Aleancës. Refuzimi i fundit për mbështetje nga ana e disa prej anëtarëve të NATO-s gjatë përgatitjes për ekzekutimin e *Operacionit Liria e Irakut* ka shtruar kërkesën për një ndryshim të tillë.¹³

Vërejtjet e Senatorit Reeds u bënë gjatë debatit të Senatit për ratifikimin e protokollit të Marrëveshjes për zgjerimin e NATO-s. Rezoluta për ratifikim, e cila kaloi 96-0, përfshiu një amendim “Mendje e Senatit”, i cili, megjithëse nuk përkrahte mendimet e ashpra të Senatorit Reeds, qartësisht reflektoi një ndjenjë padurimi për procedurat e zakonshme të vendimmarrjes në NATO. Amendamenti rekomandoi që presidenti të përcaktonte qartë dy çështje në agjendën e NAC gjatë vitit 2004: rregullorja e konsensusit të NATO-s; dhe “vlerën e ndërtimit të një procesi për pezullimin e anëtarësisë në NATO i çdo anëtar që nuk pajtohet më me parimet e NATO-s për demokracinë, liritë individuale dhe sundimin e ligjit. Amendamenti linte hapësirë për një raport presidencial në diskutime të tilla në komitete të Kongresit. Raporti do të përfshinte edhe “metodat për të ofruar më shumë fleksibilitet Komandantit Suprem të Aleancës në Evropë (SACEUR) për planifikimin e operacioneve të mundshme përpara aprovimit formal nga NAC të planifikimeve të tilla” dhe “metodat për ristrukturimin e procesit me anë të të cilit NATO merr vendimet në lidhje me zhvillimin e operacioneve ushtarake”.

Veprime shtesë legislative lidhur me rregulloren e konsensusit u ndërmorën gjatë verës. Veçanërisht viti ekonomik 2004 Fatura e Autorizimit të Mbrojtjes mbeti pezull përpara se Kongresi t’i kërkonte Sekretarit të Mbrojtjes të

¹³ Kongresi i SHBA, Congressional Record-Senate, May 8, 2003, S5882.

raportonte në komitetin e përshtatshëm mbi rekomandimet e tij për “riorganizimin e vendimmarrjes së mbrojtjes, ushtrisë, dhe sigurisë brenda NATO-s”. Të paktën disa mbështetës të amendamentit duket se favorizonin besim më të madh, ndoshta ekskluziv, mbi DPC (përkundër NAC) për çdo vendim që ndikon tek aftësitë mbrojtëse dhe strukturat e forcës së Aleancës, për të përfshirë Forcën Kundërpërgjigjëse të NATO-s (NATO Response Force - NRF). Sekretari i shtetit Collin Powell shfaqti rezervime për sa i përket veprimeve të Kongresit, duke thënë që “Ne besojmë që procedurat e tanishme të marrjes së vendimeve funksionojnë mirë dhe i shërbejnë interesave të Shteteve të Bashkuara... NATO është një Aleancë dhe asnjë anëtar i NATO-s, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara, nuk do të bien dakord të lejojnë që vendimet e Aleancës të merren pa miratimin e tij.”¹⁴

5. Zhvillimet pasuese dhe perspektiva

Sekretari Powell la administratën e Bushit në janar 2005, por pozicioni i tij për rregulloren e konsensusit në përgjithësi triumfoi - ndihmuar nga tendenca në të dyja anët e Atlantikut, e bërë e dukshme nga fundi i vitit 2004, për të qetësuar brenda Aleancës tensionet e krijuara nga lufta në Irak. Për sa i përket SHBA-ve, ata nuk kanë ndjekur ndonjë ndryshim kryesor të rregullores së konsensusit. As kanë ndjekur propozimet e Senatit për ngritjen e mundësive të përjashtimit të aleatëve nga Aleanca.¹⁵

¹⁴ Colin Powell, letër Senatorit Richard Lugar, Kryetar i Komitetit mbi Marrëdhëniet e Jashtme, 5 maj, 2003.

¹⁵ Vetë Traktati nuk përban klauzola mbi çështjen e pezullimit apo të përjashtimit, megjithëse Neni 13 i jep mundësinë një Aleati për t'u tërhequr me vullnetin e tij 1 vit pasi i ka paraqitur një “notë denoncimi SHBA”. Megjithëkëtë, Aleanca ka patur të bëjë me anëtarë, qeveritë e të cilëve jo gjithmonë kanë mbështetur vlera demokratike. Kur situata të tilla u shfaqën – për shembull me regjimet ushtarake greke dhe turke në fundin e viteve 1960 dhe fillimin e viteve 1970 – aleatët e tjerë i veçuan apo i përjashtuan në mënyrë efektive prej diskutimeve të ndjeshme. Në këto raste, përjashtimi i njërit apo të dy shteteve do të kishte me vete rrezikun e shpërthimit të një reagimi nacionalist kundër Aleatëve – ose edhe mundësinë e një lufte midis dy kundërshtarëve të vjetër. Më gjerësisht,

Në zyrat qendrore të NATO-s, debati i muajit shkurt 2003 rreth planifikimit emergjent për Turqinë nxiti disa interesa për ndryshimin. Duke ndjekur analizën e sugjeruar nga Sekretari i Përgjithshëm Robertson, NAC miratoi më shumë autoritet për NMA-të për inicimin e planit të emergjencës, ndërsa NAC mbajti autoritetin për miratimin e të gjitha planeve operacionale si përgjigje të një krizë aktuale ose që pritet të ndodhë së shpejti. Për këto ose vendime të tjera të rëndësishme, si p.sh. angazhimi në misionet e NRF-së ose zgjerimi i misionit NATO-ISAF, miratimi i NAC-it me konsensus mbetet një kërkesë politike. Edhe sugjerimi për ndryshime modeste në rregulloren e konsensusit për të trajtuar çështje më pak kritike - si menaxhimi i personelit të NATO-s dhe reformat buxhetore - bënë të bien kampionat e alarmit në kryeqytetet e anëtarëve dhe në zyrat qendrore të NATO-s; në 2005 propozimet përgjatë këtyre linjave nga një grup ekspertësh të NATO-s u lanë në sirtarë.

Me këtë nuk sugjerojmë që rregullorja e konsensusit duhet ose do të qëndrojë e pandryshueshme. Duke qenë se operacionet e tanishme apo ato të propozuara të NATO-s po bëhen shumë të ndryshme, gjithëpërfshirëse dhe me shumë kërkesa, arritja e konsensusit për kur dhe si të angazhohet Aleanca si një të tërë nuk ka qenë e lehtë. Veç kësaj, numri në rritje i operacioneve të NATO-s e bëjnë më të vështirë për aleatët individualë, veçanërisht shtetet e vogla, për të vendosur ku dhe si t'i shpërndajnë aftësitë e tyre të kufizuara. Ndonëse

politikëbërësit amerikanë në mënyrë të ngjashme dolën në përfundimin se asnjë Aleat, apo vend aspirant do të ishte i gatshëm të miratonte konceptin

– sado i fshehur që të ishte ai – se një mosmarrëveshje mbi politikën me Uashingtonin do të përbente bazën për të pezulluar apo përjashtuar një anëtar prej Aleancës. Për kontrast, Traktati i Bashkimit Evropian përban një proces të detajuar me tri etapa të pezullimit: së pari, një përcaktim se ka një “rrezik të qartë të shkeljes serioze” të parimeve bazë të BE-së, përfshirë “respektimin e dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektit për të drejtat njerëzore”; së dyti, një përcaktim se një shkelje e rëndë ka ndodhur; dhe në fund, një vendim (me procedurën e shumicës së cilësuar) për të pezulluar disa të drejta, përfshirë të drejtën e votës, të anëtarit në fjalë të BE-së. BE kurrë nuk e ka përdorur procesin e pezullimit, megjithëse anëtarët e tij ranë dakord për sanksione të kufizuara politike ndaj Austrisë më 2004.

nuk i ngjajnë për nga intensiteti episodit të shkurtit 2003, disa Aleatë kanë ndeshur brirët, për shembull, lidhur me propozimin për dhënien e ndihmës trajnuese për forcat e sigurisë në Irak në vitin 2004; lidhur me angazhimin e NRF-së për të mbështetur operacionet ndihmese pas tërmetit të vitit 2005 në Pakistan; dhe lidhur me mënyrën se si duhet përmirësuar bashkëpunimi i NATO-s me vendet joanëtare (si Australia dhe Japonia) në vitin 2006.

Për fat të keq, tensioni në marrjen e vendimeve në NATO ka gjasa të vazhdojë, në mos zmadhohet, në vitet në vijim. Për shembull, nëse NATO është për arritjen e qëllimit të saj të shpallur për NRF - d.m.th. që NRF të jetë e aftë për t'u angazhuar kudo në botë brenda 5 ditëve të vendimit të NAC dhe të mbështetet në forcat e veta për deri në 1 muaj në një diapazon operacionesh - aleatë të ndryshëm duhet të përshtatin me këtë ligjet kombëtare ose praktikatat që kërkojnë miratim parlamentar përpara se qeveritë e tyre të dërgojnë forca në territorin e tij kombëtar. Në të kundërt, nëse një Aleat që jep një kontribut kritik drejt NRF-së në operacionet 6-mujore të tij do ta vononte apo pengonte kontributin e tij, NATO do të ishte e detyruar të gjente një zëvendësues potencial ose do ta ndryshonte në mënyrë domethënëse nocionin e operacioneve. Veç kësaj, duke patur parasysh perspektivën e paqëndrueshmërisë së vazhdueshme në Azinë Qendrore, më gjerë në Lindjen e Mesme, kërcënimet nga rrjetet terroriste ndërkombëtare, si edhe të ardhmen ende të paqartë për pjesë të Ballkanit, ka pak shanse që kërkesa për shërbimet e NATO-s do të bjerë së shpejti.

Ekzistojnë opsione që mund ta lehtësojnë vendimmarrjen për planifikimin dhe zhvillimin dhe të tilla që nuk do ta ndryshonin në mënyrë thelbësore rolin e konsensusit. Mund të ketë kuptim, për shembull, të konsiderojmë një zgjatim të prerogativave të SACEUR, për ta lejuar që, në konsultime me Sekretarin e Përgjithshëm, të marrë përsipër në krizat urgjente përgatitje të avancuara dhe/ose para-pozicionimin e njëjësive kyçe ndihmese të NRF-së në zonat potenciale të operacioneve. Në këtë mënyrë, NRF do të jetë më në gjendje për ekzekutimin shpejt të një operacioni sapo të marrë miratimin e NAC-it.

Një opsion më ambicioz do të ishte të konsiderohet fuqizimi i “koalicioneve brenda NATO-s”. Sipas kësaj rruge, konsensusi i NAC do të vazhdojë të kërkohet për autorizimin e operacioneve të NATO-s. Duke ju shmangur praktikës aktuale, sidoqoftë, NAC mund të urdhërojë një Komitet Kontribuesish të NATO-s (NATO Committee of Contributors - NCC), kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm, të kryejë operacionet në emër të Aleancës. Ky komitet duhet të përfshijë të gjithë ata Aleatë të përgatitur për të kontribuar me forca ose potenciale në operacione, dhe të gëzojnë akses të plotë në potencialet dhe asetet e përbashkëta të NATO-s (për shembull, NATO **AËACS** dhe sistemet e komunikimit) dhe strukturat komanduese të NATO-s. Këta aleatë duhet të miratojnë thelbin e operacioneve, rregullat e angazhimit, urdhrat e aktivizimit ushtarak të dhëna SACEUR-it, dhe shumë hapa të tjerë të nevojshëm për zbatimin e operacionit.

Sekretari i Përgjithshëm duhet në mënyrë periodike të informojë aleatët që nuk janë anëtarë të NCC për zhvillimet domethënëse që ndikojnë operacionet, por këta Aleatë nuk do të marrin pjesë në vendimet e menaxhimit të përditshëm të operacioneve. Së fundi, këta Aleatë që janë zgjedhur për të mos marrë pjesë në NCC nuk mund nga ana e tyre të rihapin autorizimin në NAC; për të arritur këtë gjë, ata do të kenë nevojë për një prag (për shembull, të paktën 1/3) të anëtarësisë së NCC.

Ky opsion do ta ruante rregulloren e konsensusit për miratimin e operacioneve të NATO-s. Ai do të ndiqte praktikën e shkuara, përmes së cilave një Aleat me rezerva rreth një operacioni të veçantë, megjithatë nuk do ta thyejë heshtjen nëse ka një mendim mbizotërues në NAC për të ecur përpara. Ai duhet të marrë në konsideratë vështirësitë më të mëdha potencialisht të arritjes së vlerësimit të kërcënimit të përbashkët, duke përfshirë krizat jashtë rajonit evropian-atlantik. NCC do ta bënte më të lehtë për ata Aleatë që nuk ndajnë një vlerësim të përbashkët të kërcënimeve për marrë pjesë në asetet e NATO-s dhe të procedojnë me bekimin e Aleancës për të zbatuar misione në përgjigje të krizave jo të Nenit 5. Duke hequr aftësinë e atyre që nuk janë të angazhuar në operacione

që të ndikojnë drejtimin e përditshëm, kjo qasje mund të përshpejtojë vendimmarrjen dhe të shmangë imazhin e luftës nga komitetet që i është atribuar *Operacionit Forca Aleate*. NCC do të jetë më shumë përfshirëse sesa përjashtuese: asnjë Aleat nuk mund të bllokojë pjesëmarrjen e tjetrit dhe Aleatët, të cilët nuk janë në gjendje të kontribuojnë në fillim, do të ruajnë opsionin për t'iu bashkuar NCC-së në një etapë të mëvonshme. Së fundmi, NCC do të ishte veçanërisht tërheqëse për Aleatët që janë, gjithashtu, anëtarë të Bashkimit Evropian, meqë marrëveshje të ngjashme të “komiteteve të kontribuesve” ekzistojnë në Politikën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë Evropiane të BE-së, për përshtatjen e kontributit potencial të joanëtarëve të BE-së në operacione të udhëhequra nga BE.

6. Konkluzione

Duke perifrastuar thënien e famshme të Uinston Çerçillit për demokracinë, rregullorja e konsensusit është ndoshta rruga më e mirë ndër të këqijat për menaxhimin e Aleancës. Megjithatë, rregulli, ashtu siç është praktikuar deri tani, nuk e ka paralizuar Aleancën në Ballkan apo Afganistan. Me disa rregullime relativisht të hapura, rregullorja, si vetë NATO-ja, mund të vazhdojë t'i përshtatet mjedisit të sigurisë të shek. XXI. Asnjë Aleat, sidoqoftë, nuk do të jetë dakord për ndryshimin e procedurave aktuale të vendimmarrjes në një mënyrë që ai e mendon në kundërshtim me interesat e veta. Kështu që ka një paradoks: konsensusi do të nevojitet për të ndryshuar rregulloren e konsensusit.

Leo Michel është bashkëpunëtor i vjetër kërkimor në Institutin për Studime Strategjike Kombëtare (Institute for National Strategic Studies) në Universitetin e Mbrojtjes Kombëtare në Fort Lesley J. McNair në Uashington.

Gary King Christopher J. L Murray

RIKONSIDERIMI I SIGURISË NJERËZORE (II)

(Vijon nga numri i kaluar)

Siguria njerëzore e individit

Bazuar mbi konceptin e varfërisë së përgjithësuar dhe orientimin nga e ardhmja të konceptimit tonë të sigurisë, ne i përkufizojmë Vitet e Sigurisë Njerëzore Individuale (Years of Individual Human Security - YIHS) si numrin e pritshëm të viteve të jetës që kalohen jashtë gjendjes së varfërisë së përgjithshme.¹ Ky koncept pasqyron edhe perspektivën e individit që të jetë gjallë në secilën sekuencë kohore edhe shanset e tij për të qenë mbi pragun e përgjithshëm të varfërisë, nëse është i gjallë. Për shembull, nëse një grua 40-vjeçare ka një pritshmëri për të jetuar dhe 35 vite të tjera, por vetëm 50% shans të të qenurit mbi pragun e varfërisë së përgjithshme në çdo vit në të ardhmen, siguria e saj individuale do të jetë 17.5 vite. Pra, njësia e matjes e sigurisë njerëzore të individit është vite jetë.² Ky term është i njohur dhe i lehtë për t'u interpretuar. YIHS është gjithmonë më pak, ose e barabartë me pritshmërinë e jetës së një individi. Nëse një individ nuk ndeshet me risqe të rënies nën pragun e varfërisë së përgjithësuar, atëherë YIHS është e barabartë me pritshmërinë e jetës; risqet jo zero të varfërisë së përgjithësuar zvogëlojnë më shumë YIHS.

Edhe pse YIHS është më e dobishme për të matur sigurinë njerëzore të popullatës, matje që përshkruhen në pjesën

¹ Artikulli në original: King, G. & Murray, C. J. L. (2001-02) "Rethinking Human Security". *Political Science Quarterly*, 116 (4): 585-610. Pjesa e parë e artikullit gjendet në Çështje të Sigurisë, 2007, nr. 3, f. 33-49 (shën. i red.).

² Christopher Murray, J. A. Salomon, and C. Matthews, "A Critical Examination of Summary Measures of Population Health", *Bulletin of World Health Organization* 78 (No. 8, 2000): 981-994.

vijuese, ne përkufizojmë një matje që mund të jetë më shumë intuitive për ca qëllime në nivelin individual të analizës. Kështu, Siguria Njerëzore Individuale (Individual Human Security - IHS) është raporti i jetëgjatësisë që një person logjikisht mund të aspirojë të jetojë jashtë varfërisë së përgjithësuar. Kjo matje, e cila lëviz nga 0 deri te 1, kontrollon për diferencat sipas moshës. YIHS dhe IHS janë matje objektive dhe mund të ndryshojnë prej perceptimeve të sigurisë njerëzore që mund të ketë një person për veten. Ndërsa rritja e perceptimit të sigurisë njerëzore është një qëllim i rëndësishëm në vetvete, shqetësimet tona përqendrohen te nivelet objektive të sigurisë njerëzore të individit dhe të popullatës.

Ne i kemi zyrtarizuar këto njësi matëse të sigurisë njerëzore duke përfshirë dhe përqindje zbritjeje, në mënyrë që risqet e hyrjes në një gjendje të varfërisë së përgjithësuar në një të ardhme të largët të gjykohen si më pak të rëndësishme sesa risqet në një të ardhme të afërt. Prej kohësh debatohet zbritja e mirëqenies së ardhme, apo në rastet e tanishme, rreziqet e varfërimit.³ Ndërsa ne kemi pikëpamjen e përgjithshme se risqet e së ardhmes duhen konsideruar po kaq të rëndësishëm, apo thuajse po aq të rëndësishme sa risqet e përfaqëta të varfërisë, formulimi lejon për një përqindje zbritjeje të pranueshme. Praktika e tanishme në një numër fushash, si analiza e kostos dhe efektivitetit të kostos të ndërhyrjeve shëndetësore, ka marrë gradualisht drejtimin për nga përdorimi i përqindjeje të ulëta pozitive të zbritjeve në masën 3 përqind apo më pak për vit.⁴ Me sa duket, sapo të kryhet puna e vështirë

³ F. P. Ramsey, "A Mathematical Theory of Saving", *Economic Journal* 38 (December 1928): 543-559; R. C. Lind, ed., *Discounting for the Time and Risk in Energy Policy* (Baltimore: Johns Hopkins University Press, 1982); Stephen A. Marglin, "The Social Rate of Discount and the Optimal Rate of Investment", *Quarterly Journal of Economics* 77 (February 1963): 95-111; Derek Parfit, *Reasons and Persons* (Oxford, UK: Oxford University Press, 1984); Amartya K. Sen, "Isolation, Assurance and the Social Rate of Discount", *Quarterly Journal of Economics* 81 (February 1963): 1123-4.

⁴ Për shembull, Marthe R. Gold, Joanna E. Siegel, Louise B. Russell, and Milton C. Weinstein, eds., *Cost-Effectiveness in Health and Medicine* (New York: Oxford University Press, 1996).

për të mbledhur masat e nevojshme, skema alternative të zbritjes mundet të përlllogariten për krahasim.

Siguria njerëzore e popullatës

Për qëllime të informimit të debateve mbi politikën e zhvillimit dhe të sigurisë, ne ofrojmë një përkufizim të viteve të sigurisë njerëzore të popullatës, bazuar në dy mënyra të mbledhjes së YIHS. Masa më e thjeshtë është mesatarja e YIHS për secilin në popullatën në fjalë. Në qoftë se YIHS është 25 për gjysmën e popullatës dhe 35 për gjysmën tjetër, atëherë siguria njerëzore për gjithë popullatën do të jetë 30. Për shumë përdorime, kjo mesatare direkte është njësia matëse më e përshtatshme. Megjithatë, ajo është e ndjeshme për diferencat në shpërndarjen e moshës së popullatës. Nëse një popullatë është më e moshuar se një tjetër, atëherë *ceteris paribus* do të ketë një siguri më të ulët njerëzore. Ky përfundim është i saktë në kuptimin e ngushtë. Popullata më e vjetër e ka më të vogël pritshmërinë e jetesës mbi pragun e varfërisë së përgjithshme. Por për qëllime krahasuese, ne mund të pëlqejmë një njësi matëse që nuk ndikohet nga shpërndarja e moshës së popullatës. Për këtë përdorim krahasues, ne propozojmë të krahasojmë grupe mbi baza të viteve të njerëzve të sigurisë njerëzore në lindje.⁵ Vlera mesatare e YIHS për të sapolindurit sot, njësoj si periudha e pritshmërisë së jetës në lindje, nuk ndikohet nga struktura e moshës së popullatës dhe, deri në një masë të konsiderueshme, pasqyron një gamë të gjerë të risqeve të ardhshme për mbijetesë dhe varfërinë e përgjithësuar në të ardhmen.

⁵ Një opsion tjetër për një përcaktim të sigurisë njerëzore të popullatës dhe të pavaruar prej shpërndarjes së moshës, është përdorimi i një shpërndarjeje standarde të moshës për të llogaritur sigurinë njerëzore të popullatës sipas moshës standarde (shih O. B. Ahmed et al., "Age Standardization of Rates: A New WHO Standard", GPE discussion paper, no. 31 (Geneva: World Health Organization, 2000)). Kjo matje do të pasqyronte gamën e plotë të risqeve të mbijetesës dhe të varfërisë së përgjithësuar në varësi të moshës dhe kohës, por ka disavantazhin që kërkon zgjedhjen e një shpërndarjeje arbitrare të moshës së popullatës për të bërë standardizimin e moshës.

Të dy konceptet, vitet e sigurisë njerëzore të popullatës dhe vitet e sigurisë njerëzore në lindje të popullatës, maten në të njëjtën shkallë intuitive sikurse matjet e mirënjohura të pritshmërisë së jetës dhe pritshmërisë së jetës në lindje. Ato matin numrin mesatar të viteve që anëtarët e një popullate të caktuar pritët të jetojnë (duke filluar ose nga një moshë e caktuar, ose në lindjen e tyre) jashtë gjendjes së varfërisë së përgjithësuar.

Të dy konceptet përjashtojnë brezat e ardhshëm në llogaritjet e tyre dhe kështu shmangin paradokset standarde që do të kishin rezultuar. Për shembull, pa bërë zbritje, të përfshish lindjet e ardhshme do të thotë që siguria e njerëzve të jetë e njëjtë për të gjithë popullsinë në një kohë të largët në të ardhmen. Megjithëse mund të gjenden shembuj sfidues (të tilla si sëmundje epidemike të parashikuara në sëmundjet e foshnjërisë), ne besojmë që në përkufizimin e sigurisë njerëzore si një funksion të individëve që jetojnë prezent është një mënyrë e arsyeshme dhe praktike. Duke marrë parasysh gjendjen e metodave të vlerësimit të riskut, matjet e pëlqyeshme të sigurisë së njerëzve në lindje, do të kërkonin nevojën për të pasqyruar risqe të njohura për shekullin pasues. Kjo është tashmë një dritare e gjerë për vlerësim dhe zgjatimi i saj në të ardhmen ka mundësi të jetë jopraktik nga aspekti empirik.

Ne përjashtojmë nga masa jonë e popullatës gjithçka që ndikon sigurinë e institucioneve, qeverive, apo organizatave të tjera, po të mos ndikojnë individët. Ky konceptim i sigurisë njerëzore të popullatës është kështu një evolucion i natyrshëm i literaturës që kur Richard Ullman shkroi për përqendrimin e sigurisë mbi individët në vend të shteteve.⁶

Matja e Sigurisë Njerëzore

Të matësh sigurinë njerëzore në praktikë, duhen të përzgjidhen një radhë fushash të mirëqenies. Për çdo fushë duhet të konstruktoret një tregues praktik, si edhe një vlerë pragu nën të cilin një individ do të përcaktohet se është në

⁶ Ullman, "Redefining Security"

gjendjen e varfërisë së përgjithësuar. Dy qasje standarde që ekzistojnë për matjen e mirëqenies - njësia metrike në para (Money-metrik utility) dhe indeksi i zhvillimit njerëzor - janë shembuj instruktivë për këtë qëllim.

Disa analistë janë në favor të përdorimit të të ardhurave për frymë si një njësi matëse e përgjithshme, siç ilustronet me bollëk nga përqendrimi ndërkombëtar në debatet mbi politikën e të ardhurave për frymë. Kjo qasje është themeluar mbi nocionin që secili individ mund të përdorë më së miri burimet që zotëron për të maksimalizuar mirëqenien e vet dhe se krahasime ndërvetjake mund të bëhen në mënyrë legjitime mbi bazën e të të ardhurave totale. Problemet me këtë model janë të mirënjohura⁷ dhe kur matja është vizibël, shumica e analistëve përpiqen të përfshijnë edhe fusha të tjera. Për shembull, tre fusha u përfshinë në Indeksin e Zhvillimit Njerëzor:⁸ të ardhurat për frymë, shëndeti dhe shkollimi. Të ardhurat për frymë nuk u përdorën si një fushë e qenësishme e mirëqenies por si një instrument për arritjet në fusha të tjera. Shëndeti dhe arsimit u zgjodhën sepse u konsideruan si fusha të domosdoshme të mirëqenies dhe praktikisht mund të mateshin.

Ne e fillojmë me Indeksin e Zhvillimit Njerëzor dhe në të njëjtën kohë përdorim të ardhurat për frymë meqë janë instrumentalisht të lidhura me disa fusha të tjera të mirëqenies dhe përfshijnë shëndetin dhe arsimin. Nivelet prag të mirëqenies ekonomike dhe shëndetit janë qartazi aq të rëndësishme sa mund të provokojnë dhunë. Shkollimi në vetvete nuk ka qenë kaq i rëndësishëm, kështu që mund të argumentohet heqja e tij; por njerëzit shpesh kanë luftuar për vlerat kulturore të pasqyruara në shkollim. Për më tepër, ne duam që të mbërthejmë elementë përbërëse për varfërinë e përgjithësuar të lidhura me liritë e tjera themelore. UNDP e ka njohur rëndësinë e lirisë politike dhe demokracisë, por nuk ka mundur të gjejë masë apo peshë të pranueshme gjerësisht për to dhe kështu që nuk mund të përfshinte atë në fushat e tjera të matura tashmë. Për sa kohë që kërkojmë prag dhe jo

⁷ World Bank, World Development Report, 2004 (New York: Oxford University Press, 2000)

⁸ UNDP, 1990

njësi matëse, do të ishte diçka më e lehtë për ne për të përfshirë ndryshore të tjera si këto. Kështu, sugjerimi ynë për një set dorështrënguar fushash për matjen e sigurisë njerëzore do të ishin: të ardhurat, shëndeti, shkollimi, liria politike dhe demokracia. Shumë fusha të tjera të mirëqenies kalojnë nëpërmjet tyre. Për më tepër, çdo aspekt i mirëqenies që ndikon drejtpërdrejt në mesataren e jetesës, si ambienti dhe biodiversiteti, deri në njëfarë mase do të përfshiheshin automatikisht në matjen tonë të sigurisë njerëzore, pa qenë nevoja të ndërtonim një fushë apo një prag të veçantë.

Për çdo fushë të përfshirë në mënyrë eksplicite, ne duhet të zgjedhim një tregues apo numër treguesish që pasqyrojnë gjendjen e tashme të informacionit, si edhe pragun nën të cilin një individ do të jetë në gjendjen e varfërisë së përgjithësuar. Ne tani sugjerojmë njësi matëse për secilën nga këto fusha, por e theksojmë se korniza jonë mund të sistemojë lehtë fushat e tjera që mund të shtohen.

Njësitë matëse specifike sipas fushave

Edhe pse Sistemi i Raportimeve Kombëtare (System of National Accounts - NSA) u zhvillua në vitet 1950 dhe është ratifikuar pothuaj në mënyrë universale, mund të përdoren shumë variante të të ardhurave për frymë.⁹ Meqenëse ne

⁹ Ka dy zgjedhje kryesore. E para, të ardhurat për frymë mund të përlllogariten duke u bazuar te të produktet dhe shërbimet që prodhon një vend (Gross Domestic Product), ose mund të korrektohet edhe nga të ardhurat që vijnë nga lidhjet me jashtë (Gross National Product). Dallimi mes tyre është i rëndësishëm për vende, të cilat fitimet ose të ardhurat që vijnë nga investimet e në vend të huaja janë substanciale. Një zgjidhje tjetër kyçe është metoda e konvertimit të të ardhurave për frymë në njësi të monedhës vendase në një shkallë metrike të përbashkët me qëllim krahasimin ndërmjet shteteve. Meqenëse kurset zyrtare të këmbimit nuk pasqyrojnë barazinë në fuqinë blerëse për mallrat dhe shërbimet e patregtueshme, siç janë p.sh. edukimi fillor, është zhvilluar një metodë alternative e bazuar në matjen e çmimeve dhe përlllogaritjen e diferencave për fuqinë blerëse. Shih Robert Summers dhe Alan Heston, "The Penn World Table (Mark 5): An Expanded Set of International Comparisons, 1950-1988", *The Quarterly Journal of Economics* 106 (2): 327-68. Krahasime të tilla të bazuara janë shprehur në "dollarë ndërkombëtarë", që është dollari amerikan në termat e fuqisë blerëse.

theksojmë krahasimin e fuqisë blerëse të individëve nëpër botë, ne kemi besimin se një matje e mirë është GNP (General National Production) për frymë, e konvertuar në dollarë internacional duke përdorur fuqinë blerëse ekuivalente.¹⁰ Banka Botërore ka propozuar se përkufizimi global i varfërisë ekonomike absolute është më pak se 365 dollarë për frymë për vit me dollarët ndërkombëtarë të vitit 1985,¹¹ dhe ky përkufizim është pranuar gjerësisht në bashkësinë ndërkombëtare (për shembull Banka Botërore, DFID). Në bazë të këtij përkufizimi, 1.3 miliardë individë tani jetojnë në varfëri.¹² Si çdo lloj prag, edhe ky është arbitrar, por është vendosur në një vlerë kaq të ulët sa askush nuk mund të japë argument të besueshëm se individët me më pak se 365\$ për frymë nuk janë në një varfëri të përgjithësuar. Ndërsa një argumentim i goditur mund të bëhet për të rritur pragon e varfërisë, qëllimi ynë është të kodifikojmë konsensusin ekzistues ndërkombëtar dhe kjo është shifra më afër konsensusit që kemi për çastin.

Faktorët shëndetësorë janë të përfshirë në përkufizimin e sigurisë njerëzore në dy mënyra. E para, mbijetesa është një komponent kritik i sigurisë njerëzore. Rritja e përqindjeve të vdekjes ulin jetëgjatësinë dhe, *ceteris paribus*, YIHS. Fatmirësisht, parashikimi i vdekjeve është një fushë shumë aktive e kërkimit shkencor dhe e të këshillimit të politikave.¹³ E dyta, individët e gjallë mund të bien nën pragon shëndetësor, gjë që i vendos ata në një gjendje të varfërisë së përgjithësuar (për shembull të paralizuar nga qafa e poshtë). Një progres i madh është bërë në zhvillimin e matjeve krahasuese të dimensioneve jofatale të shëndetit të popullatës.¹⁴ Një shumëllojshmëri e instrumenteve vëzhgues janë zhvilluar, si SF-36,¹⁵

¹⁰ Vlerësuesit kryesorë të fuqisë blerëse, bazuar në GDP dhe GNP për frymë, janë respektivisht Penn World Tables (Summers and Heston 1991) dhe Banka Botërore (World Development Indicators 1999). Fatkeqësisht, korrelacioni mes këtyre dy masave matëse nuk është mjaftueshëm i madh për ta shpërfillur zgjedhjen mes të dyjave.

¹¹ World Bank, 1990.

¹² World Bank, 1999

¹³ World Health Report, 1999 and 2000.

¹⁴ Murray, Salomon, and Mathers, "A Critical Examination."

¹⁵ J. Ware, SF-36 Health Survey, Manual and Interpretation Guide - The Health Institute, New England Medical Center, Boston, Massachusetts.

Euroqol,¹⁶ dhe WHODAS¹⁷, të cilat mund të përdoren për të matur aspekte të ndryshme të shëndetit të individëve. Paralel me këtë, puna se si individët e vlerësojnë kohën e harxhuar në gjendje të ndryshme shëndetësore përbën bazën për një vlerësim të përgjithshëm të gjendjes së rëndë shëndetësore.¹⁸ Gjendjet shëndetësore vlerësohen me shkallën nga 0 (vdekja) deri në 1 (shëndet i plotë). Gjendje të rënda si kuadriplegja¹⁹ vlerësohen rreth 0.2 dhe depresioni i rëndë 0.6.²⁰ Ne do të sugjeronim që çdo individ në gjendje shëndetësore me pak se 0.25 është në një gjendje të varfërisë së përgjithësuar.

Shumica e literaturës së pasur akademike që mat lirinë demokratike dhe politike e shqyrton secilën në mënyrë të veçantë.²¹ Një nga matjet më të përdorura ofrohet nga Freedom House, një organizatë jofitimprurëse, jopartiake. Freedom House e gjykon demokracinë duke paraqitur numerikisht të drejtat politike dhe lirinë politike dhe të liritë shoqërore, të cilat “përfshijnë liritë për të zhvilluar, institucionet dhe pavarësinë personale veçmas shtetit”.²² Mbi 800 njësi matëse të tjera të liritë politike dhe demokratike janë ndërtuar,²³ por

¹⁶ EuroQuol Group, “A New Facility for the Measurement of Health-Related Quality of Life”, Health Policy 16 (1990): 199-208. England Medical Center, Boston, Massachusetts.

¹⁷ WHO-DAS, “Disability Assessment Schedule Version 3.1a” (WHODAS-II), Geneva, World Health Organization, 1999.

¹⁸ P. F. M. Krabbe, M. Essink-Bot, G. J. Bonsel, “The Comparability and Reliability of Five Health-State Valuation Methods”, Social Science and Medicine 45 (December 1997): 1641-52; J. Brazier, T. Usherwood, R. Harper, and K. Thomas, “Deriving a Preference-Based Single Index from the UK SF36 Health Survey”, Journal of Clinical Epidemiology 51 (November 1998): 1115-28; E. Nord, “Methods for Quality Adjustment of Life Years”, Social Science and Medicine 34 (No. 6, 1992): 559-69.

¹⁹ Paralizë e krahëve dhe e këmbëve (shën. i red.).

²⁰ Christopher Murray and Alan Lopez, eds., The Global Burden of Disease, Global Burden of Disease and Injury Series: vol. 1. (Cambridge, MA: Harvard University Press, 1993).

²¹ Shih Kenneth A. Bollen and Pamela Paxton, “Subjective Measures of Liberal Democracy”, Comparative Political Studies 33 (February 2000): 58-86.

²² Metodati e Freedom House gjenden në <http://www.freedomhouse.org/survey99/method/>.

²³ Kenneth A. Bollen and Pamela Paxton, “102532: Cross-National Indicators of Liberal Democracy, 1950-1990” Data set at the Inter-University Consortium for Political and Social Research, Ann Arbor, Michigan (<http://urwww.icpsr.umich.edu>., 1999).

pothuajse të gjitha janë të fokusuara në vlerësimin e qeverive më tepër se sa sigurinë politike të qytetarëve të tyre. Kjo do të thotë që për të matur saktë komponentët politikë të varfërisë së përgjithësuar, na duhet punë shtesë. Një prag i arsyeshëm për nivelin e varfërisë së përgjithësuar për demokracinë mund të jetë e drejta e një individit për të votuar të paktën në një raund zgjedhësh të lira dhe të drejta (nuk është e domosdoshme të jenë në nivelin kombëtar) që japin ndikim në disa aspekte të jetës së njeriut. Ky është një nivel minimal i demokracisë që bashkësia ndërkombëtare me siguri do të donte të përmirësonte, por pa këtë të drejtë një person duhet konsideruar si i privuar rëndë. Njësia matëse analoge në nivel kombëtar do të ishte një grup të rriturish që mund të marrin pjesë në zgjedhje të tilla. Në mënyrë interesante, një matje e tillë mund të jetë më e madhe se 0 përqind dhe më e vogël se 100 përqind, pothuajse në të gjitha vendet, duke përjashtuar një numër të vogël të tyre.

Dy opsionet kryesore për matjen e gjendjes së arsimit përfshijnë alfabetizimin dhe vitet mesatare të shkollimit. Avantazhi i alfabetizimit është se ai ndërthur një prag të qartë cilësor të arritjeve të shkollimit. Shumica bien dakord që të qenurit analfabet e vendos individin në gjendjen e varfërisë së përgjithësuar. Në aspektin praktik, problemi me alfabetizimin është se ai është i vështirë për t'u krahasuar midis vendeve, sepse alfabetizimi i vetëraportuar ndryshon në mënyrë substanciale në vende të ndryshme. Nga ana tjetër, vitet mesatare të shkollimit janë një njësi matëse më e qëndrueshme e arritjeve të arsimit.²⁴ Një prag i përafërt për vitet mesatare të shkollimit mund të jetë pesë ose gjashtë vite, të cilat pasqyrojnë edukimin fillor. Nëse krijohet ndonjë njësi krahasimore e alfabetizimit, ne do të propozonim që të përdorej edhe ajo.

²⁴ Vitet mesatare të shkollimit për popullatën mbi 15 ose 25 vjeç quhet "kapitali njerëzor". Shih Jong Wha Lee & Robert Barro, "International Comparisons of Educational Attainment", *Journal of Monetary Economics* 32 (December 1993).

Nevojat për të dhëna

Matja e sigurisë njerëzore e popullatës kërkon si pikënisje të dhëna të mira mbi nivelet e shkuara dhe të tanishme të të ardhurave, shëndetit, shkollimit, demokracisë dhe lirive politike për individët, në popullata të ndryshme të botës. Për të matur varfërinë e përgjithësuar, na duhet informacion mbi individët brenda popullatave në të njëjtën kohë për këta ndryshore kyç. Meqenëse përkufizimi i varfërisë së përgjithësuar bazohet në rënien nën pragun kritik në një nga këto fusha, ne kërkojmë informacion për nivelet e çdo ndryshori për çdo individ. Me fjalë të tjera, të dhënat mbi shëndetin që nuk mund të kenë lidhje në nivelin individual me të dhënat e të ardhurave ose të lirive politike, nuk mund të përdoren veçmas për të vlerësuar varfërinë e përgjithësuar për një popullatë.

Praktikisht ne mund të përdorim të dhëna të vlefshme të detajuara të tilla si raportimet kombëtare apo regjistrimet vitale për të bërë matje të ndryshoreve veç e veç dhe një studim më të vogël për të matur shpërndarjen e tyre të përbashkët. Si një pikë referimi e fundit, metodat e ndërhyrjes ekologjike mund të përdoren për të nxjerrë përfundimet mbi shpërndarjen e përbashkët.²⁵ Studiuesit kanë arritur përparim thelbësor duke u zhvendosur nga të dhëna të përbashkëta kombëtare të të ardhurave deri te të dhënat mbi shpërndarjen e të ardhurave.²⁶ Ne besojmë se hapi i ardhshëm i natyrshëm, në pajtim me tendencat e mbledhjes së të dhënave dhe me lëvizjen drejt sigurisë njerëzore, është të zgjerojë skemën e mbledhjes së të dhënave mbi matjet në fusha të kryqëzuara në nivel individual. Në disa raste, shtimi i të dhënave mbi shkollimin dhe pasurinë, apo për të ardhurat me të dhënat e mbledhura rutinë për shëndetin, mund të ndodhë të jetë relativisht pa shumë kosto. Kjo do të veçanërisht e vlefshme, përderisa informacioni për

²⁵ Për shembull, Gary King, *A Solution to the Ecological Inference Problem: Reconstructing Individual Behavior from Aggregate Data*. (Princeton: Princeton University Press, 1997).

²⁶ Shih bankën e të dhënave Wider mbi pabarazinë e të ardhurave-
<http://www.wider.unu.edu/wiid/wiid.htm>.

shëndetin mblidhet në trajta relativisht standarde në pothuajse të gjitha vendet.

Nëse kjo agjendë nuk do të qëndrojë për zhvillimet e ardhshme për sistemet e informacionit të varfërisë së përgjithshme, metoda të reja nevojitet të zhvillohen dhe të përdoren për të vlerësuar shpërndarjen e përbashkët të shëndetit, shkollimit, të ardhurave, dhe lirive politike. Fatmirësisht shumë mund të bëhet për këtë problem. Për shembull Organizata Botërore e Shëndetësisë ka si projekt përdorimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kombëtare, së bashku me hartat satelitore të popullsisë botërore dhe me faktorë të ndryshëm gjeografikë, për të pozicionuar vendndodhjen e të varfërve të botës. Kjo vendosje në hartë e të varfërve ilustron gjerësisht ndryshimin e madh ndërmjet atyre që janë në varfëri absolute dhe individëve të pasur apo të varfër që jetojnë në vendet më të varfra. Për shembull, në Kinë, me të ardhura 3070 dollarë ndërkombëtarë (të vitit 1997) për frymë, mbi 200 milion persona vlerësohen të jetojnë në varfëri.²⁷ Pjesë të tjera të botës me densitet të lartë të të varfërve përfshijnë Bangladeshin, Malësitë e Etiopisë, Lugina e Gangut dhe Rajonet e Liqeneve të Mëdha të Afrikës dhe Nigerisë. Puna ka nisur për të përdorur burime të tjera, si studime demografike dhe anketa të shëndetit, për të vlerësuar shpërndarjen e individëve në gjendje të ndryshme shëndetësore.²⁸

Siguria njerëzore është një koncept me vështrim përpara: për të matur atë sot na duhet të projektojmë varfërinë e përgjithshme dhe mbijetesën nesër. ProjekSIONET kërkojnë zhvillimin e metodave të vlerësimit të riskut me validitet parashikues. Modele të tilla mund të zhvillohen më së miri nëse janë të disponueshme bankat e të dhënave, relativisht me histori të gjatë, në mënyrë që të eksplorohe marrëdhënia ndërmjet varfërisë së përgjithësuar për secilën fushë me faktorët kyç social, ekonomik, kulturor dhe politik. Vlerësimi

²⁷ World Bank, 1999.

²⁸ Emrnanuela Gakidor, Christopher Murray, and Julio Frenk, "A Framework for Measuring Health Inequality", World Health Organization: Discussion Paper, 29 July 2000 (<http://www.nt.who.int/whosis/statistics/discussion~papers/papersos.pdf>).

i riskut është një proces me dy faza. Faktorët kryesorë përgjegjës për ndryshime të mëdha në sigurinë njerëzore, si luftërat, ngrohja botërore, tërmetet dhe fatkeqësi të tjera natyrore dhe krizat ekonomike, mund të identifikohen para se të projektohet varfëria e përgjithësuar në vetvete. Në disa raste, fushat e shëndetit, të ardhurave, shkollimi dhe liria politike kërkojnë si modele të hapave të para vlerësimin e riskut për këto ngjarje. Më poshtë ne përdorim sfidën e vlerësimit të riskut të konflikteve ushtarake për të ilustruar drejtimit për përparimin në matjen e sigurisë njerëzore.

Një qëllim i rëndësishëm i matjes së sigurisë njerëzore është të pajiset individi me informacion më të mirë mbi sigurinë e tij njerëzore. Duke bërë kështu, ne do të tentojmë të rrisim perceptimin e çdo individi për sigurinë e tij, sepse njerëzit tentojnë t'i mbivlerësojnë kërcënimet për sigurinë tyre. Megjithatë, matja e sigurisë njerëzore do të jetë një input kritik për debatet e politikave publike se si të rritet siguria njerëzore e popullatës. Modelet e vlerësimit të riskut individual, në mënyrë të natyrshme çojnë në veprime për të parandaluar apo zvogëluar perspektivën e varfërisë së përgjithësuar. Matja e sigurisë njerëzore do të fokusojë debatin ndërkombëtar të politikës te kontribuesit kryesorë të pasigurisë njerëzore dhe kështu do të përmirësojë politikat publike. Për të lehtësuar këto qëllime, ne propozojmë që të zhvillohen banka të nevojshme të të dhënave dhe metoda që bëjnë të mundur llogaritjen vjetore të indeksit të sigurisë njerëzore. Sikurse me të gjitha përpjekjet për vlerësim krahasues, raportimi periodik apo vjetor i sigurisë njerëzore të popullatës do të ndihmojë të gjitha vendet të kuptojnë situatën e tyre dhe të informohen se ku duhet të bëhen përmirësime.

Zmadhimi i sigurisë njerëzore

Pasiguria njerëzore mund të lindë nga çdo burim që rrit riskun që njerëzit të mbeten apo të hyjnë në gjendjen e varfërisë së përgjithësuar. Meqë varfëria e përgjithësuar është një gjendje prej së cilës dilet me vështirësi, ekzistenca në këtë gjendje është një nga kërcënimet më të mëdha ndaj sigurisë njerëzore – pra mundësia e të qenurit në varfëri të përgjithësuar në të ardhmen.

Kërcënimet e tjera përfshijnë krimin, konfliktin ushtarakë (dhunën në grup), ndryshimet jopaqësore të qeverisjes, sëmundjet ose probleme të tjera të shëndetit publik, katastrofa të rënda mjedisore (përmbytje, thatësira, tërmete, stuhi, rreziqe nga hapësira, kontaminimi), ndryshimet mjedisore afatgjata (ngrohja globale, vrime e ozonit, pakësimi i burimeve të ujit, ndotja) dhe krizat ekonomike.

Disa komponentë të varfërisë së përgjithësuar, si p.sh të ardhurat, shëndeti dhe edukimi, kanë njohur një përparim të konsiderueshëm global në gjysmëshekullin e fundit. Për shembull, sukcesi dramatik i bashkësisë ndërkombëtare në kontributin e dhënë për rritjen e jetëgjatësisë globale nga mosha mesatare 46.5 vjeç që ishte në vitet 1950-1955 në moshën 65.4 vjeç në vitet 1995-2000²⁹ është një shembull shumë i mirë i përparimit që mund të arrihet.

Kategoritë e përpjekjeve për zmadhimin e sigurisë njerëzore

Ne i kemi kategorizuar përpjekjet për të përmirësuar sigurinë njerëzore, duke u nisur nga *ex ante* deri në *ex post*, si përlllogaritja e riskut, parandalimi, mbrojtja dhe kompensimi. Përlllogaritja e rrezikut përfshin përmirësimin e njohurive mbi komunikimin në lidhje me rrezikun që popullata të veçanta do të futen ose do të mbeten në nivelet e një gjendje të varfërisë së përgjithësuar. Parandalimi përfshin përpjekjet për ta reduktuar këtë risk. Mbrojtja përfshin ato veprime që zvogëlojnë mundësinë për t'u dëmtuar nga këto ngjarje nëse ato ndodhin. Kompensimi përfshin përpjekjet për të siguruar mbështetje financiare, ose në natyrë për individët në kushtet e varfërisë së përgjithësuar. Për të arritur tek ato kategori, ne filluam me skemën e zhvilluar si fillim nga Linkoln Chen³⁰ dhe më pas e zgjeruam paksa për të nxjerrë në pah rëndësinë e përlllogaritjes së riskut si diçka e veçantë nga parandalimi.

Ky kategorizim mund të përdoret për të ndërtuar strategji më të detajuara operationale për rritjen e sigurisë njerëzore,

²⁹ United Nations, World Population Prospects, Vol. 1, Comprehensive Tables (New York: United Nations, 1998).

³⁰ Chen, "Human Security"

bazuar në politikat e reja publike dhe kërkimet akademike. Për shembull, përlllogaritja e riskut të një konflikti ushtarak duhet të përfshijë kërkime mbi parashikimin e konfliktit ushtarak, komunikimin e risqeve atyre që ndikohen prej tij dhe zhvillimin e sistemeve të mbikëqyrjes. Parandalimi përfshin vlerësimin e modeleve rastësore të luftës, identifikimin e shkaqeve të modifikueshme, përdorimin e përlllogaritjeve të riskut për të adresuar ndërhyrjet për zvogëlimin e konfliktit, përpjekjet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, dhe përpjekjet parandaluese kombëtare e ndërkombëtare. Mbrojtja prej konfliktit ushtarak përfshin përpjekjet për të ndryshuar armatimet e luftës, si fushata për të ndaluar përdorimin e minave, rivitalizimin dhe zgjerimin e ligjeve ndërkombëtare për mbrojtjen e palëve joluftuese dhe mbrojtja e shërbimeve sociale dhe e shëndetit publik prej luftimeve. Kompensimi përfshin skemat e sigurimit nga luftërat (me një shkallë risku të përlllogaritur bazuar te modelet ekzistuese parashikuese) dhe tipa të ndryshëm të asistencës humanitare.

Avantazhet e përmirësimit të përlllogaritjes së riskut

Edhe një shqyrtim i përciptë i kërcënimeve serioze ndaj sigurisë njerëzore dhe i strategjive për ta përmirësuar atë, e nxjerr në pah përlllogaritjen e riskut si fusha më e rëndësishme dhe që nuk i është kushtuar shumë vëmendje. Përlllogaritja e riskut është me rëndësi kritike madje edhe thjesht për matjen e sigurisë njerëzore të popullatës, por avantazhet e përmirësimit të përlllogaritjes së riskut shkojnë përtej thjesht matjes.

Së pari, përmirësimi i metodave me qëllim ndërmarrjen e përlllogaritjeve kuptimplota të riskut është një përpjekje e rëndësishme kërkimore në vetvete. Ky lloj i njohurisë duhet të konsiderohet një e mirë e përbashkët. Përveç kësaj, përmirësimi i njohurive të risqeve specifike mund të përdoret edhe nga bashkësia ndërkombëtare për t'i bërë politikat publike sa më efektive. Shumë përpjekje për parandalim kërkojnë njohuri mbi risqet; për shembull, kundërpërgjigjja efektive ndaj risqeve që i kanosen sigurisë njerëzore, thellohet me anë

të sistemeve të paralajmërimit të hershëm, pra me anë të një përlllogaritjeje të mirë të riskut.

Ne e dimë që shumë nga kërkimet psikologjike dhe socio-psikologjike kanë provuar se kanë tendencën të mbivlerësojnë risqet e komponentëve të varfërisë së përgjithësuar.³¹

Duke ofruar përlllogaritje të cilësisë së lartë të riskut, dhe duke e shpërndarë këtë informacion në publik, siguria njerëzore e perceptuar prej individëve mund të përmirësohet në shumë mjedise. Në ato mjedise ku individët e nënvlerësojnë pasigurinë e tyre njerëzore, një vlerësim më i mirë i riskut do t'i lejonte të ndërmerrnin masa si në nivel individual, familjar ose qeveritar duke zvogëluar ndikimin e këtyre risqeve nëse ata ndodhin.

Së treti, goftë edhe kur vlerësimet individuale të mirëqenies së tyre së ardhshme janë pa të meta (pra mesatarisht të sakta), kërkimet psikologjike tregojnë që njerëzit tentojnë të vlerësojnë në mënyrë të gabuar anët e panjohura të parashikimeve. Prandaj, vlerësimi më i mirë i riskut dhe shpërndarja e gjerë e këtij vlerësimi mund të rrisë në mënyrë direkte sigurinë e perceptuar njerëzore të individit, duke reduktuar luhatjet në parashikime. Ndoshta aspekti më i qartë është se përlllogaritjet më të mira të riskut i bëjnë ndërhyrjet e reja të mundshme. Psh. parashikimet e sakta të cikloneve eliminojnë shumë shumicën e risqeve ndaj shëndetit publik që vijnë edhe nga ngjarje të tilla të ashpra të motit.

Qasja jonë për përdorimin e vlerësimit të rrezikut në përkufizimin e sigurisë njerëzore ka avantazhin e përfshirjes së problemeve të tjera të rëndësishme që nuk ndikojnë mirëqenien aktuale të njerëzve. Psh. biodiversiteti, i cili është parë nga komuniteti shkencor si një nga problemet më të rëndësishme globale, ka pak ose aspak efekt në mirëqenien aktuale. Qasjet që ofron agjenda për bashkësinë ndërkombëtare dhe që nuk janë largpamëse ose e shpërfillin biodiversitetin, ose e shtojnë në agjenda në një trajtë logjikisht jokohërente. Sipas qasjes sonë, megjithëse biodiversiteti nuk ka ndonjë efekt të rëndësishëm në mirëqenien aktuale, ai është thelbësor për

³¹ Amos Tversky and Daniel Kahneman, *Judgment under Uncertainty: Heuristics and Biases* (New York: Cambridge University Press, 1982).

ruajtjen e mirëqenies në të ardhmen dhe prandaj luan një rol qendror në përmirësimin e sigurisë njerëzore.

Përlllogaritja e riskut është e rëndësishme për politikat e bazuara mbi konceptin e drejtuar nga e ardhmja të sigurisë njerëzore, i cili mund të jetë shumë më efektiv sesa bazimi i politikave mbi mirëqenien aktuale ose varfërinë e përgjithësuar. Duke qenë se objekti i bashkësisë njerëzore nuk është të luftojë betejën e fundit, ne kemi nevojë të përgatisim përgjigje ndaj asaj që ka gjasa të ndodhë dhe jo thjesht sepse parandalimi është më pak i kushtueshëm se përgjigja pas ngjarjes. Ne shpresojmë që duke nxjerrë më në pah rolin qendror që zë në sigurinë njerëzore përlllogaritja e riskut, ne jemi në gjendje të tregojmë ato zona ku bashkësia akademike mund të ndihmojë. Përlllogaritja e riskut është i pazhvilluar në disa fusha dhe i nënvlerësuar në të tjera. Shumica e shkencave sociale, p.sh. kanë një fokusim të kuptueshëm në vlerësimin e efekteve shkakësore. Ajo që studiuesit kanë nevojë të kuptojnë është që ky fokus nuk ka pse të vijë në kurriz të modeleve që bëjnë një parashikim të mirë. Parashikimet janë shpesh implikime të vëzhgueshme të disa modeleve të përdorura për të vlerësuar shkaqet e ngjarjeve dhe mundet që të përdoren për të validuar këto modele. E thënë ndryshe, shumë modele shkakësore të përdorura tashmë mund të renditen për të përmirësuar parashikimet tona, pra matjen tonë të sigurisë humane.

Shënime përmbyllëse

Ne dizenuam variantin tonë të sigurisë njerëzore për të qenë logjikisht rigorozë dhe për të kënaqur atë që duket se është të jetë një skicë e një konsensusi normativ në formim e sipër në bashkësinë ndërkombëtare. Në kohën që ky artikull po hyn në procesin e botimit, raportohet një përfshirje e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për të zhvilluar dhe zbatuar mjete të reja vëzhgimi për të matur shëndetin dhe fushat e lidhura me sigurinë njerëzore që ndjekin sugjerimet që paraqitëm këtu. Përveç kësaj shënojmë se në një fjalë të mbajtur kohët e fundit, presidenti meksikan Vincente Fox ka adoptuar nocionin e sigurisë njerëzore të ofruar këtu.

Vendimet normative

Koncepti ynë është bazuar mbi sigurinë e qenies njerëzore në vend të mbrojtjes së kufijve shtetërorë dhe secili individ që kontribuon në mënyrë të barabartë në sigurinë njerëzore të popullatës. Përkufizimi është i drejtuar për nga e ardhmja: siguria aktuale e individit është një funksion i perspektivave të tij në të ardhmen. Në mënyrë më specifike, siguria njerëzore është një funksion i riskut të të qenit poshtë një pragu të mirëqenies, të asaj që ne quajmë një gjendje të varfërisë së përgjithësuar dhe nuk është një funksion i niveleve mesatare të mirëqenies.

Përdorimi i termit varfëri e përgjithësuar nënkupton që një politikë e bazuar mbi sigurinë njerëzore përqendron përpjekjet në radhë të parë te qenia njerëzore në rrethanat më të skajshme ku mund të gjendet. Kjo është një shtrirje logjike e asaj që ishte efektivisht perspektiva e bashkësisë ndërkombëtare në fushën e shëndetit kur gjatë 40 viteve të fundit ajo prodhoi rritje të paparashikuar në hapësira të ndryshme të jetës njerëzore me anë të adresimit parësor që u bëri çështjeve të fokusuar te sëmundjet e rënda dhe te sëmundjet e fëmijërisë. Vështrimi alternativ duhet të jetë fokusuar në nivelet mesatare të mirëqenies njerëzore (ndryshe e njohur si zhvillim njerëzor). Ndërsa ne nuk mendojmë që siguria njerëzore ka ndonjë prioritet të domosdoshëm, absolut ose leksikografik si një qëllim i politikës sociale në krahasim me zhvillimin human, shumica e bashkësisë ndërkombëtare duket se besojë që duhet të jetë parësore, përveç në rrethana disi të pazakonshme.

Debati akademik i kohëve të fundit ka çuar në disa dallime të lidhura me këtë. P.sh., pamja prioritariste thotë që ne duhet të jemi të interesuar në përmirësimin e mirëqenies së kujtdo dhe me një interes të veçantë për mirëqenien e më të mjerëve.³² Kjo pikëpamje mund të dallohet prej perspektivës klasike egalitariane që është e interesuar për të gjithë shpërndarjen e mirëqenies tek individët. Kështu një egalitarian mund të jetë dakord me një politikë publike që sakrifikon një shkallë të

³² Larry S. Temkin, *Inequality* (New York: Oxford Ethics Series, Oxford University Press, 1993).

mirëqenies midis më të kamurve, me qëllim që të reduktohet pabarazia, por në disa raste një prioritarian do ta kundërshtonte këtë gjë.

Çdo prioritet i sigurisë njerëzore mbi zhvillimin njerëzor nuk duhet konsideruar absolut dhe ne nuk do të argumentonim kundër politikave publike që përmirësojnë zhvillimin njerëzor thjesht sepse siguria njerëzore nuk ka qenë maksimalizuar në fillim. Por ne besojmë që zhvillimi ndërkombëtar dhe bashkësia e sigurisë janë në mënyrë parësore të fokusuar mbi zmadhimin e asaj që ne quajmë siguri njerëzore. Një mënyrë e të menduarit rreth këtyre preferencave normative është t'i nxjerrësh ato prej qëllimit më të thellë të maksimalizimit të dobisë globale njerëzore. Nga kjo perspektivë, çështja është si të bëjmë krahasime të dobisë ndërpersonale. Sipas interpretimit tonë të konsensusit në formim e sipër të bashkësisë ndërkombëtare, një rritje e vogël e mirëqenies në të gjithë pragun e varfërisë së përgjithësuar, prodhon një ndryshim të konsiderueshëm në dobi krahasuar me të gjitha ndryshimet më ekstreme të mirëqenies humane në të gjitha nivelet. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë prioriteti i sigurisë njerëzore mbi zhvillimin njerëzor human është një konsekuencë automatike.

Agjenda për politikën e jashtme dhe përparimin shkencor

Përkufizimi dhe matja e sigurisë njerëzore e ofruar në këtë artikull kanë synuar të formatizojnë konsensusin që po shfaqet në bashkësinë ndërkombëtare mbi disa nga qëllimet më të rëndësishme të tij. Përderisa ideja e sigurisë njerëzore është për të përmirësuar jetën e njerëzve dhe jo për të përmirësuar sigurinë e kufijve shtetërorë, apo çështje kyç mes kufijve, atëherë aksione të koordinuara nga bashkësia ndërkombëtare duket se janë thelbësore. Lidhjet dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm midis qeverive, organizatave ndërkombëtare, organizatave joqeveritare dhe pjesë të tjera të shoqërisë civile do të jenë të rëndësishme.

Nëse ky është një deklaram i arsyeshëm i shfaqjes së konsensusit, drejtimet e ardhshme të politikave të zhvillimit

dhe sigurisë do të ndikohen në një masë të madhe. Tani ne marrim në konsideratë shembuj të strategjive të politikave dhe kërkimeve që do të ndikohen brenda katër strategjive për të përmirësuar sigurinë njerëzore – përlllogaritja e riskut, parandalimi, mbrojtja dhe kompensimi.

Një nga zonat me përfitime më të mëdha potenciale është përmirësimi i përlllogaritjes së riskut për shkaqet kryesore të varfërisë së përgjithësuar. Ndërtimi i kapaciteteve në banka të dhënash dhe metoda për të ndërmarrë përlllogaritje më të mira të risqeve duhet të jetë një komponent qendror i një politike të jashtme të fokusuar te siguria njerëzore. Potenciali për përmirësimin e përlllogaritjes së riskut duket substancial në zhvillimin e sistemeve për sëmundjet e reja, për shembull. Në mënyrë të ngjashme, përparimi i sotëm në metodat e përlllogaritjes së riskut në shkencat politike nënkupton që për herë të parë disa konflikte ushtarake mund të parashikohen me saktësi, çka mund të kuptojë që vlerësimi i rrezikut për disa çështje të tjera kyçe të sigurisë humane mund të përmirësohen me shpejtësi. Përpyekje të tilla mund të përmirësohen së tepërmi me anë të lidhjeve të reja ndërdisiplinore. P.sh. shkencëtarët janë fokusuar pothuajse tërësisht në vendimet e elitës politike për të shkuar në luftë dhe jo në pasojat e luftës mbi shëndetin publik të kësaj lufte dhe prandaj vetëm në një aspekt të përlllogaritjes së riskut dhe parandalimit. Profesionistët e shëndetit publik nuk i kanë shfrytëzuar avantazhet e këtyre zhvillimeve, por megjithatë ata kanë shumë për të kontribuar në sferën e mbrojtjes dhe kompensimit ku shkencat politike nuk janë përfshirë ende.³³

Strategji më të mira parandaluese mund të ndërtohen mbi përlllogaritjen e përmirësuar të riskut. Për shembull, në fushën e konflikteve ushtarake, një model shkakësor më i mirë dhe një përlllogaritje më e mirë e riskut mund të sigurojë mundësi për ndërhyrje më të fokusuara të politikës së jashtme për të reduktuar riskun e konfliktit. Informacioni që i jepet publikut në vendet ose bashkësitë me shkallë të lartë të riskut mund ta zvogëlojë shkallën e riskun e konfliktit. Strategji të tjera për

³³ B. Levy and Victor W. Sidel, *War and Public Health* (New York: Oxford University Press, 1996).

parandalim që janë propozuar dhe që duken shumë produktive, përfshijnë përmirësimin e institucioneve monetare kombëtare ose ndërkombëtare dhe reduktimin e riskut të krizave ekonomike, marrëveshjet për tregtinë e karbonit për të reduktuar gazrat e efektit serë, riskun e ndryshimeve klimaterike globale dhe skuadra të përmirësuar të kundërpërgjigjes së menjëhershme për të të minimizuar transmetimin e sëmundjeve, si përgjigje ndaj raportimeve të sistemeve të mbikëqyrjes.

Ndërkohë që ne besojmë, si edhe të tjerë, se përllogaritja e riskut dhe parandalimi mund të jenë ndër drejtimet më të shpërblyera për përpjekjet e ndërkombëtarëve për të rritur sigurinë njerëzore, ka ende disa mundësi substanciale edhe në fushën e mbrojtjes. Sukseset e fundit të fushatës kundër minave i ka hapur rrugë perspektivës së marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare për ta bërë përdorimin e armëve të luftës më të fokusuar tek ushtarakët dhe për të mbrojtur në këtë mënyrë civilët nga përdorimi dhe për të ulur paksa pasigurinë e tyre. Përpjekjet e ndërkombëtarëve për të zhvilluar marrëveshje mbi “cluster bombs” kanë të njëjtin synim. Strategji të tjera për mbrojtjen përfshijnë përpjekjet për të përmirësuar cilësinë e ndërtesave të ngritura në zonat që janë të prekura nga tërmetet, po ashtu siç mund të jetë ngritja e mekanizmave sociale për të ndihmuar dhe mbrojtur grupet e cënueshme gjatë krizave ekonomike. Kundërpërgjigja në rastet e tragjedive natyrore njerëzore është, gjithashtu, një formë mbrojtjeje.

Së fundmi, bashkësia ndërkombëtare mund të shtojë përpjekjet për kompensim të duke krijuar organizata, të cilat do të sigurojnë dëmshpërblime për dëme financiare të lidhura me risqet më të mëdha që i kanosen sigurisë njerëzore. Shumë shtete e kanë siguruar vendin e tyre në mënyrë efektive në lidhje me kostot financiare për rastet e katastrofave të mëdha. Si rezultat përfundimtar del fakti që shumë vende e gjejnë veten duke u përballur me ndikimet afatgjata të krizave si luftëra civile ose uragani Mitch. Konceptet tradicionale të siguracioneve mund të zhvillohen në mënyrë të tillë që t’i sigurojnë shtetet me njëfarë mbrojtjeje financiare ndaj rrezikut.

Ne besojmë që implikime të tjera më të detajuara për bërjen e politikave do të vijnë pas një aplikimi të strukturuar të këtij kuadri në lidhje me sfidat e sigurisë njerëzore. Në këtë pikë, ndërtimi i bazës së evidencave për sigurinë njerëzore duhet të jetë prioritet nëse fokusi i veprimtimit ndërkombëtar do të lëvizë nga kundërpërgjigjja ndaj krizës më të fundit humanitare, drejt një përpjekjeje efektive për të ngritur sigurinë njerëzore përmes përllogaritjes së riskut, parandalimit, mbrojtjes dhe kompensimit.³⁴

GARY KING është profesori i qeverisjes dhe drejtor i Qendrës së të Dhënave Harvard-MIT pranë Universitetit të Harvardit, dhe këshilltar i vjetër shkencor pranë Organizatës Botërore të Shëndetësisë. CHRISTOPHER J. L. MURRAY është drejtor ekzekutiv i Njësisë për Evidencat dhe Informacionin për Politikën e Përbashkëta, pranë Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Puna e tij është e përqendruar në matjen e shëndetit dhe performancën e sistemit shëndetësor në të gjitha vendet e botës.

³⁴ Për komente dhe diskutime të vlefshme, ne falënderojmë Jim Alt, Lara Birk, Barry Bloom, Bear Braumoeller, Lincoln Chen, Kristian Gleditsch, Devesh Kapur, Bob Keohane, Lisa Martin, Bruce Russett, Kenji Shibuya, Celeste Wallander dhe Langche Zeng.

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTIMIT DHE KONTROLLIT DEMOKRATIK TË SEKTORIT TË SIGURISË

*Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)
Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave
të Armatosura (DCAF)*

Hyrje

Më së shumti këto rekomandime kanë për qëllim të orientojnë parlamentarët, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin ndërkombëtar.¹ Të gjitha së bashku, ato synojnë të mbështesin vendet që kërkojnë krijimin dhe ruajtjen e elementëve të qëndrueshëm të drejtimit dhe kontrollit demokratik të sektorit të sigurisë. Rekomandimet janë të mbështetura në parimet e krijuara mbi praktikën e mira të reformave në sektorin e sigurisë dhe të qeverisjes. Për më tepër, ato vlerësojnë parimin se normat e qeverisjes së mirë mund të mbahen në një shoqëri dhe në politikën e saj kur ka një “pronësi lokale” të çështjeve që lidhen me kontrollin e sektorit të sigurisë.

Të krijosh kuptimin dhe mekanizmat për transparencë dhe përgjegjësi përgjatë këtij sektori mbetet një çështje kritike në shumë nga vendet post-autoritariste. Për të ndihmuar në kontrollin parlamentar të këtij sektori dhe drejtimin e tij brenda kuadrit të qeverisjes demokratike si dhe për të forcuar efektivitetin e sektorit të sigurisë, rekomandohet që të ndërmerren masat konkrete të mëposhtme, për të përmirësuar

¹ Marrë nga: *Democratising Security in Transition States. Findings, Recommendations and Resources from the UNDP/DCAF Roundtable for CIS Parliamentarians*, Prague, October 2005. UNDP, 2006

qoftë kuptimin ashtu edhe kapacitetet e aktorëve të përfshirë në sigurimin e një kontrolli demokratik të sektorit të sigurisë.

Rekomandimet për parlamentarët

Krijimi i Kuadrit Ligjor

1. Të ndërtojnë një kuadër ligjor gjithëpërfshirës që do të krijonte një mjedis të përshtatshëm për kontrollin demokratik civil të sektorit të sigurisë, i cili pasqyron normat ndërkombëtare dhe përshtat kushtetutën ndaj këtyre normave.

Shtetet kanë nevojë të përcaktojnë në mënyrë të drejtë konceptin e drejtimit dhe kontrollit demokratik në dokumentet e tyre bazë kushtetues. Parimi i supremacisë civile mbi shërbimet e sigurisë, të monitoruara në mënyrë të pavarur dhe të vëna në zbatim nga parlamentarët e zgjedhur në mënyrë demokratike, duhet të pasqyrohet jo vetëm në dokumentarët bazë ligjorë të shtetit, por gjithashtu në vetëdijen e tij. Këto parime më pas është e nevojshme të zbatohen në praktikë. Një metodë është përmes miratimit të një Ligji mbi kontrollin civil të sektorit të sigurisë (shih http://www.dcaf.ch/_doc/bm_fluri-nikitin_cis_model.pdf).

Një mënyrë tjetër është përfshirja e neneve që garantojnë kontrollin civil në secilin prej ligjeve që rregullojnë sektorin e sigurisë, p.sh. ligji i policisë, ligji për mbrojtjen e dokumenteve zyrtare që janë sekret shtetëror, ligji për gjendjen e jashtëzakonshme, ligji për mbrojtjen kombëtare, ligji për përgjegjësinë financiare, ligji për shërbimin e detyrueshëm dhe atë alternativ në ushtri, ligji për *conscientious objectors*, ligji për prokurimet në fushën e mbrojtjes, ligji për lirinë e informimit.

2. Të hartojnë legjislacion të veçantë për çdo përbërës të sektorit të sigurisë dhe agjenci të zbatimit të ligjit në përputhje me precedentët ndërkombëtarë.

Duke marrë parasysh mandatet dhe kompetencat e tyre të ndryshme, është e rëndësishme që legjislacioni të bëjë dallimin

ndërmjet shërbimeve të mbrojtjes dhe të shërbimeve sekrete nga njëra anë dhe agjencive të zbatimit të ligjit siç janë policia apo shërbimet e ruajtjes së kufirit nga ana tjetër.

3. Të hartojnë legjislacion që garanton pavarësinë, funksionin dhe vlefshmërinë e instrumenteve të përshtatshëm për institucionet demokratike që të mbikëqyrin sektorin e sigurisë.

Parlamentarët në mënyrë të vazhdueshme duhet të hartojnë dhe përfshijnë në legjislacionin vendas mjetet e nevojshme për institucionet demokratike që ato të ndikojnë me anë të këtij kontrolli. Brenda parlamentit, anëtarët e tij kanë nevojë, si një minimum, për të drejta të parashikuara nga ligji për të mbajtur seanca dëgjimore të rregullta apo dhe me karakter hetimor; të miratojnë buxhetet, vendimet e prokurimit dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e sektorit të sigurisë si dhe për t'i kryer këto aktivitete në mjedis publik. Përveç kësaj, kuadri legjislativ duhet të sigurojë që dialogu ndërmjet institucioneve demokratike dhe aktorëve mbi çështjet e sigurisë të jetë i mbështetur në ligje që përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrat e veçanta për secilin nga këto aktorë ashtu sikurse duhet të garantojë se nuk ka asnjë imunitet të kuptuar apo nënkuptuar për secilin prej tyre që vepron në këtë fushë.

Parlamentarët duhet të sigurohen që institucioni mbikëqyrës ka të drejta të plota ligjore për të vëzhguar, hetuar dhe raportuar mbi aktivitetet e aktorëve të sektorit të sigurisë; se gjyqësori mund të kalojë në gjykatë raste kundër aktorëve të sigurisë; që prokurorët në këto gjyqe ashtu si dhe hetuesit që hetojnë mbi krime apo akuza të ndryshme mund të kenë akses në dokumentet, punonjës apo aspekte të tjera të aktorëve në sektorin e sigurisë për të përmbushur detyrat e tyre; ashtu sikurse shteti duhet të parashikojë fonde të mjaftueshme për të gjithë aktorët që janë të lidhur me to, jo vetëm për aktivitete procedurale, por edhe në rast të ngjarjeve të pazakonta.

Mbi të gjitha, meqenëse ndonjëherë ndodhin edhe mbivendosje të rastësishme, ndarja e punës mbështetet në shkëmbimin e lirë të informacionit ndërmjet këtyre institucioneve, sikurse ai përshpejtohet edhe nga aktivitetet e shoqërisë civile dhe medias.

4. Të integrojnë normat e të drejtave të njeriut në ligje të caktuara të sektorit të sigurisë.

Për shkak se sektori i sigurisë është më i prirur të abuzojë me të drejtat e njeriut, është shumë e domosdoshme të hartohet një legjislacion mbi të drejtat qytetare dhe njerëzore, duke përfshirë instrumentet për ruajtjen e të drejtave të tilla si (p.sh. institucionet e mbikëqyrjes dhe e drejta për akses në informacion). Po kaq e rëndësishme është që legjislacioni i sektorit të sigurisë të ketë të garantuar përfshirjen e të njëjtave parime në brendësi të tij.

5. Të hartojnë dokumente strategjike duke përcaktuar rolet e veçanta, detyrat dhe mjetet e vlefshme për elementët përbërës të sektorit të sigurisë.

Për të realizuar një qasje të koordinuar ndaj kontrollit në sektorin e sigurisë, për të treguar përkushtim ndaj parimeve të tij qeverisëse si dhe për të garantuar një ndërgjegjësim të përbashkët për rolet dhe detyrat që kanë përbërësit e këtij sektori, është thelbësore që shteti të hartojë dokumente politikash të tilla si Politika e Sigurisë Kombëtare, Plani i Menaxhimit të Krizave, Doktrina e Mbrojtjes dhe “Libri i Bardhë” mbi Mbrojtjen ashtu si edhe kodet e sjelljes për zyrtarët dhe oficerët e zbatimit të ligjit, të cilat duhet të ndajnë qartazi mandatin, rolet, pushtetet dhe kufizimin e tyre, kostot e burimeve dhe buxhetet e nevojshme për sektorët e rëndësishëm të sigurisë. Këto dokumente duhet të hartohen mbi bazën e një kuptimi sa më të gjerë të konceptit të sigurisë, i cili shkon përtej sigurisë shtetërore dhe përfshin njëkohësisht edhe çështjet e të drejtave qytetare e njerëzore si dhe përcakton në mënyrë të veçantë instrumentet për ruajtjen e mbrojtjen e këtyre të drejtave.

6. Të kërkojnë kontroll ekzekutiv, demokratik, të përgjegjshëm dhe efektiv dhe mirëfunksionim të mekanizmave të kontrollit të brendshëm në ushtri, polici, policinë kufitare dhe shërbimet informative.

Kontrolli parlamentar mund të ketë sukses vetëm nëse ekzekutivi është realisht përgjegjës për shërbimet e forcave të

armatosura dhe nëse ushtria dhe agjencitë e zbatimit të ligjit janë të disiplinuar dhe profesionale. Megjithatë, përveç kontrollit jozyrtar nga organizatat e shoqërisë civile dhe media, ekzistojnë tri nivele të kontrollit demokratik dhe secili prej tyre është i pavarur nga niveli tjetër p.sh. kontrolli i brendshëm brenda agjencive të sigurisë, kontrolli parlamentar dhe kontrolli ekzekutiv.

7. Të sigurojë që shërbimet e sigurisë u përgjigjen shqetësimeve reale lidhur me sigurinë e njerëzve dhe që taksat e burimet e tjera përdoren për qëllimet e tyre të deklaruara, duke vërejtur se këto shërbime veprojnë në interes të shoqërisë dhe mbikëqyrin të drejtat njerëzore të burrave dhe grave.

Në pikëpamjen e masave legjislative, ky aspekt mund të arrihet më lehtë duke zotëruar shërbime të sigurisë, të cilat:

- janë të drejtuara nga ligje kushtetuese
- veprojnë mbi bazën e rregullave të qarta e procedurave transparente
- kanë stafe oficerësh që janë rekrutuar dhe përzgjedhur nëpërmjet një procesi publik e transparent
- marrin në mbrojtjen ata që kundërshtojnë e denoncojnë abuzimet brenda radhëve të tyre (whistle blower)
- japin llogari përpara gjykatave të pavarura dhe personave që merren me mbikëqyrjen e tyre

Krijimi i mekanizmave për kontroll brenda Parlamentit

8. Të krijojnë komisione të specializuara për t'u marrë me secilin përbërës të sektorit të sigurisë.

Ashtu sikurse secili përbërës i sektorit të sigurisë ka një mandat të ndryshëm, edhe komisionet për mbrojtjen (forcat e armatosura), shërbimin informativ (të brendshëm dhe të jashtëm), dhe agjencitë e zbatimit të ligjit (policia dhe policia kufitare) përballen me çështje të ndryshme. Parlamenti duhet të marrë vetë përgjegjësinë e këtyre komisioneve duke planifikuar agjendat e tyre, planin e aktiviteteve, raportimet

për to në seanca plenare dhe në publik si dhe caktimin e anëtarësisë dhe të drejtimit të këtyre komisioneve.

9. Të krijojnë komisioneve hetimore ad hoc për t'u marrë me çështje dhe ngjarje të paparashikura.

Komisionet *ad hoc* dhe ato hetimore janë ndonjëherë të nevojshme për të marrë në shqyrtim ngjarje apo çështje të veçanta dhe krijojnë hapësirë për opozitat parlamentare që të kryejnë funksionin e tyre demokratik duke i kërkuar llogari qeverisë për politikën e ndjekura prej saj. E drejta e opozitës parlamentare për të kërkuar hetime të tilla u jep atyre një mjet të fuqishëm për të hetuar rreth keqfunksionimit apo aktiviteteve të paligjshme në sektorin e sigurisë.

10. Të hartojnë politika të ekuilibruara dhe terma të qarta për mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të komisioneve të mbrojtjes, shërbimit informativ dhe agjencive të zbatimit të ligjit, të mbështetur mbi parimet e transparencës dhe llogaridhënies.

Aspektet e funksionimit të këtyre komisioneve duhet të përfshijnë përmbajtjen dhe nenet e mëposhtme:

- Të drejta të plota për emërimin e kryetarëve, anëtarëve dhe stafit të tyre si edhe të drejtën për shpeshësinë dhe tematikën e mbledhjeve të komisionit duke përfshirë edhe buxhetet e tyre.
- Të drejtën për të shqyrtuar dhe raportuar mbi çdo iniciativë politike të shpallur nga Ministria e Mbrojtjes, e Brendshme (ose e njëjtë me të) duke përfshirë planifikimin afatgjatë, riorganizimin dhe propozimet për pajisje të rëndësishme.
- Të drejtën për të kryer hetime apo seanca dëgjimore publike për çdo çështje që prek një shqetësim të veçantë.
- Procedura për të dëgjuar peticione apo ankesa nga qytetarë apo punonjës që punojnë në sektorin e sigurisë.
- Të drejtën për të shqyrtuar projektligje apo marrëveshje të rëndësishme ndërkombëtare.

- Të drejtën për të marrë në shqyrtim buxhetin duke bërë vlerësime edhe mbi detaje të tij, kërkesën për shtesë apo kontroll për aspekte të veçanta si të drejtën për të raportuar mbi masat e përdorimit efektiv e racional të këtij buxheti.
- Të drejtën për të patur akses në informacionin e klasifikuar.
- Të drejtën për të thirrur çdo zyrtar të qeverisë në mbledhjet e komisionit dhe për ta pyetur atë nën betim.

11. Të sigurojnë përfaqësim të balancuar në të gjitha komisionet, duke përfshirë anëtarët e opozitës dhe femrat si dhe parlamentarë nga minoritetet, si dhe lehtësuar përfaqësimin e drejtë të interesave të të gjithë popullsisë.

Komisionet që nuk do të kenë një anëtarësi sa më përfaqësuese do të vuajnë nga mungesa e besueshmërisë duke e dobësuar ndikimin e tyre. Parlamentarët e opozitës synojnë të kenë një interes më të madh në aspektet e veprimtarisë jo të dukshme të qeverisë sesa përfaqësuesit e maxhorancës. Në këtë mënyrë, pjesëmarrja e parlamentarëve të opozitës çon në një kontroll më të madh.

Në shumicën e vendeve, gratë janë shumë pak të përfaqësuara në institucionet qeveritare që lidhen me çështje të sigurisë. Është shumë e rëndësishme që ato të përfshihen në këto institucione pasi shpesh ofrojnë një pikëvështrim jo vetëm të rëndësishëm, por edhe tepër të kujdesshëm për sa i përket këtyre çështjeve. Sigurisht, përfaqësimi i parlamentarëve femra në komisionet që lidhen me sigurinë nuk jep garanci se dimensionin gjinor do të merret parasysh në veprimtarinë e komisionit, ashtu si edhe mungesa e tyre nuk është një arsye për të treguar se nuk ka interes ndaj nevojave të sigurisë që shqetësojnë gratë. Përfaqësimi i parlamentarëve femra në këto komisione është një masë me rëndësi për të nxitur vëmendjen ndaj nevojave të tyre në fushën e sigurisë si dhe për të ndihmuar në marrjen e atyre vendimeve të ndjeshme ndaj aspektit gjinor që lidhen me aspektin e mësipërm. Në këtë mënyrë arritja e një përfaqësimi sa më të balancuar gjinor është një qëllim i rëndësishëm në vetvete.

12. Të hartojnë rregulla e procedura efektive për secilin komision.

Rregullat dhe procedurat duhet të forcohen në mënyrë të mjaftueshme ndaj çdo çështjeje që shqyrtohet për të qenë pjesë e një kontrolli të përhershëm nga ana e publikut. Megjithatë, mund të lindë nevoja për procedura të veçanta, të cilat përfshijnë çështje më karakter konfidencial, por në rrethana të përcaktuara në mënyrë të qartë, ashtu si ndërkohë duhet të lejohet aksesit parlamentar në të gjithë informacionin e nevojshëm.

13. Të realizojnë seanca dëgjimore mbi çështje të kontrollit të sektorit të sigurisë.

Nëpërmjet realizimit të seancave dëgjimore të rregullta mbi çështje të sektorit të sigurisë dhe ndërveprimet të vazhdueshëm me komisionet e tjera, secili komision, mund të arrijë të informohet në mënyrë të plotë për çështjet më të rëndësishme, të ndërgjegjësohet mbi zhvillimet e reja dhe të ardhshme dhe të forcojë autoritetin e tij si një instrument bazë i kontrollit demokratik.

14. Të kualifikojnë dhe të përdorin stafe të përhershme ekspertësh civilë brenda komisioneve parlamentare për të punuar së bashku me to për çështje të parlamentit dhe për t'u këshilluar mbi aspektet e kontrollit demokratik në fushën e sigurisë.

Parlamentarët janë zakonisht të zënë me një sërë çështjesh dhe në këtë mënyrë duke krijuar një grup ekspertësh civilë që janë të përgatitur profesionalisht mbi çështjet e sigurisë që shqyrtojnë komisionet, rritet në mënyrë të ndjeshme mundësia e këtyre komisioneve për të marrë vendime sa më të mbështetura në informacion për aspektet e kontrollit ashtu edhe për t'u treguar të kujdesshëm në çështjet e debatueshme.

15. Të këmbëngulin dhe të marrin pjesë në procesin e politikëbërjes dhe rishqyrtimit të aspekteve të caktuara të saj.

Fillimi i vënies në zbatim të politikave të caktuara që ndikojnë edhe mbi sektorin e sigurisë është shpesh pika më e

dobët në procesin e politikëbërjes. Parlamentarët mund ta shmangin këtë problem duke planifikuar ndërhyrjet mbi çështje të sektorit të sigurisë nga jashtë rrethit të politikëbërjes, ndërkohë që duhet të rishikojnë në mënyrë të vazhdueshme procesin teksa ai ecën gjithnjë e më shumë përpara. Një strategji e tillë kontrolli veprues u mundëson parlamentarëve t'u paraprijnë ngjarjeve, në vend që të reagojnë vetëm për ato që kanë ndodhur.

16. Të zgjerojnë procesin e konsultimit mbi hartimin e politikave nëpërmjet organizimit të seancave dëgjimore publike mbi buxhetin dhe çështjet ligjore të të drejtave të njeriut, të mbrojtjes e të zbatimit të ligjit.

Pjesëmarrja e ekspertëve nga publiku dhe grupet e shoqërisë civile, që punojnë për çështjet e kontrollit mbi sektorin e sigurisë, në seancat dëgjimore mbi hartimin e politikave apo të projektligjeve të ndryshme, mund të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme legjitimitetin dhe efektivitetin e instrumenteve politikë të propozuar duke e bërë procesin më transparent e të përgjegjshëm para publikut. Ashtu si me stafet parlamentare, duke ftuar ekspertë të pavarur civilë të sektorit të sigurisë, të drejtave të njeriut e çështjeve ligjore nga organizata kombëtare e ndërkombëtare për të vlerësuar në mënyrë objektive politikën dhe praktikën e ndjekura, parlamentet marrin këshilla objektive mbi çështjet e kontrollit të sektorit të sigurisë.

17. Të inkurajojnë unitetin parlamentar mbi çështje të kontrollit në sektorin e sigurisë.

Mungesa e disiplinës brenda dhe ndërmjet partive të opozitës shpesh identifikohet si një nga pengesat kryesore për ta detyruar qeverinë të jetë e përgjegjshme e të japë llogari për veprimet e saj. Në fakt, dallime të tilla të opinionit shpesh e lejojnë ekzekutivin të shfrytëzojë pozicionin e tij për qëllimet e veta. Për t'i dhënë një zë më të qartë çështjeve të kontrollit demokratik në parlament, është e rëndësishme që partitë e opozitës t'i shqyrtojnë pozicionet e tyre jo vetëm brenda partisë që i përkasin, por edhe me parti të tjera të opozitës, sidomos për çështje me rëndësi.

18. Të ratifikojnë të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që lehtësojnë kontrollin dhe drejtimin demokratik të sektorit të sigurisë duke përfshirë ato që garantojnë të drejtat e njeriut, për t'i bërë ato pjesë të legjislacionit kombëtar e monitoruar zbatimin e tyre efektiv.

Ratifikimi i traktateve ndërkombëtare me karakter detyrues nga parlamentet kombëtare, është një rrugë për t'u siguruar se institucionet shtetërore të ekzekutivit tashmë janë të kushtëzuara prej ligjit ndërkombëtar që të zbatojnë e të ruajnë një minimum standardesh të caktuara të kontrollit demokratik në sektorin e sigurisë.

19. Kur kapacitet ekzistuese janë të pamjaftueshme, të kërkojnë asistencë të pjesshme për të zbatuar detyrimet e vendit ndaj ligjit ndërkombëtar dhe marrëveshjeve të tilla të rëndësishme për kontrollin demokratik të sektorit të sigurisë.

Shumë agjenci zhvillimi e njohin tashmë rëndësinë e veçantë të mënyrës së drejtimit të sektorit të sigurisë dhe mund të ofrojnë asistencë për iniciativat e reformat e ndryshme të ndërmarra në këtë drejtim. (Për informacion të mëtejshëm shikoni në <http://www.dcaf.ch/lpag/index.cfm?navsub1=4&nav1=3>)

Monitorimi i shpenzimeve dhe emërimeve në sektorin e brendshëm të sigurisë

20. Monitorimi sistematik i çështjeve të prokurimit në sektorin e sigurisë.

Mbrojtja, zbatimi i ligjit dhe aspekte të tjera të prokurimit në sektorin e sigurisë meritojnë shqyrtim të kujdesshëm nga komisionet parlamentare të mbrojtjes. Në mënyrë të përmbledhur, mallrat dhe shërbimet që përfshihen këtu përbëjnë një nga zërat më të shtrenjtë në shpenzimet e përvitshme qeveritare. Së dyti, sekreti dhe pengesat e mëdha diplomatike e financiare që janë shpesh të përfshira në tregtinë ndërkombëtare të armëve, nënkuptojnë që vendimmarrësit në ushtri, ekzekutiv dhe parlament mund të jenë subjekt i

aferave korruptive nga aktorë vendas apo të huaj. Në këtë mënyrë, pushteti legjislativ duhet të përfshihet në mbikëqyrjen e prokurimeve të mbrojtjes e të sektorit të sigurisë për të kontrolluar jo vetëm degën e ekzekutivit, por në të njëjtën kohë edhe praktikën dhe politikën e agjencive shtetërore.

Parlamentarët duhet të sigurohen për të mbikëqyrur të gjithë planin e prokurimeve në këtë fushë duke përfshirë vlerësimin e nevojave, mundësitë e buxhetit, përzgjedhjen e pajisjeve, përzgjedhjen e furnizuesve, miratimin e kontratës po ashtu si edhe çdo kontratë të veçantë, të cilat përfshijnë nene për një mall apo shërbim të veçantë si pjesë e marrëveshjes së prokurimit me një firmë të huaj.

Në vendet me një sektor mbrojtjeje të fortë nevojitet vendosmëri e madhe për parandaluar industrinë e armatimit që të mos përfitojë në mënyrë të shpërpjesëtuar pagesa nga buxheti i shtetit ashtu sikurse anëtarët e qeverisë, nëpunësit civilë, agjencitë ose korporatat nuk duhet të lejohen që të kërkojnë përfitime të paligjshme nga eksporti jo i rregullt i armëve. Parlamentarët duhet të miratojnë ligje për procesin e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe eksporti i pajisjeve të reja apo të përdorura në këtë fushë duhet të jetë subjekt i miratimit parlamentar në përputhje me ligjin dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

21. Të sigurojnë që emërimet e zyrtarëve të lartë ushtarakë të jenë transparente nëpërmjet ratifikimit parlamentar.

Emërimi i gjeneralëve dhe komandantëve madhorë në shërbimet e ndryshme të sigurisë dhe ato të shërbimeve informative duhet të jetë subjekt i miratimit nga komisioni përkatës parlamentar. Të tilla komisione duhet të kenë të drejtën për të dhënë lejen për emërimin, nëpërmjet seancave dëgjimore që vërtetojnë kualifikimet e kandidatit. Ose më së paku, parlamenti duhet të konsultohet prej drejtuesve të ekzekutivit mbi emërimet e zyrtarëve të lartë në sektorin e sigurisë.

Legjislacioni që rregullon mënyrën e funksionimit të agjencive të sektorit të sigurisë duhet të përfshijë një kuadër të qartë që përcakton procesin për emërimin e shumicës së

zyrtarëve të lartë. Është shumë e rëndësishme që të vërtetohen në mënyrë të pavarur cilësitë kryesore të drejtuesit si integriteti dhe pavarësia në emërimet e mundshme. Procesi i emërimit duhet të jetë transparent dhe konsultativ, në përputhje me statusin e pozicionit.

Si një minimum, është e nevojshme që emërimet duhet të jenë të hapura për shqyrtim jashtë ekzekutivit dhe agjencisë me të cilën janë të lidhura. Në shumë shtete, emërimet e zyrtarëve të lartë në sektorin e sigurisë janë subjekt i miratimit nga parlamenti. Roli që luan verifikimi i emërimeve në këtë sektor mund të parandalojë propozimin e kandidatëve të papërshtatshëm si dhe mund ta çojë qeverinë drejt diskutimit, dhe për sa i përket disa niveleve, edhe të negocimit me aktorët e tjerë politikë, në mënyrë që të shmangë debatin politik si dhe të sigurojë një mbështetje të dyanshme për këto emërimet.

22. Të tërheqin personelin më të kualifikuar, si dhe të kontrollojnë nëse qeveria/ekzekutivi është një "punëdhënës i mirë" për personelin e sektorit të sigurisë.

Për shembull, të kontrollojë nëse kushtet e punës, të sigurisë e të shëndetit të burrave apo grave që shërbejnë në njësitë e këtij sektori janë të mjaftueshme, apo nëse rrogat dhe pensionet paguhet në kohë.

Krijimi i mjeteve të përshtatshme për kontroll përtej Parlamentit

Për një bashkëpunim konstruktiv, për sa i përket kontrollit në sektorin e sigurisë nga parlamenti, qeveria, institucionet demokratike dhe shoqëria civile, është shumë e rëndësishme që parlamentarët të garantojnë funksionimin e nevojshëm të mekanizmave të tjerë të kontrollit.

23. Të sigurojnë se është krijuar një mekanizëm kontrolli nga ana e ekzekutivit siç është p.sh. Këshilli i Sigurisë Kombëtare.

Si një mekanizëm përmes së cilit ekzekutivi mund të kryejë rolin e tij në kontrollin e sektorit të sigurisë, Këshilli i Sigurisë

Kombëtare është përgjegjës për veprimet e ekzekutivit në politikëbërjen dhe praktikat e këtij sektori.

24. Të garantojnë krijimin e një personi të pavarur në mbrojtje të të drejtave të njeriut (Ombusmani - Avokati i Popullit) dhe në mbrojtje të të drejtave të ushtarakëve (ndonjëherë quhet Inspektor i Përgjithshëm).

Institucionet e pavarura garantojnë mbrojtjen e civilëve nga dhunimi i të drejtave të njeriut dhe mbikëqyrin të drejtat e atyre që punojnë brenda sektorit të sigurisë.

25. Të inkurajojnë krijimin e njësive rregullatore ndërministrorë dhe kontrolluese që përfshijnë përfaqësuesit më të rëndësishëm të ministrive përkatëse në fushën e sigurisë.

Në demokracitë në tranzicion, krijimi i strukturave ndërministrorë rregullatore që kanë për qëllim të përqendrohen mbi çështjet e kontrollit mund të ndihmojnë në nxitjen e përgjegjshmërisë brenda ministrive.

26. Të krijojnë struktura koordinuese formale dhe informale në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duke përfshirë zyrtarët e qeverisë dhe përfaqësuesit e OJF-ve lokale.

Krijimi i këtyre strukturave koordinuese ofron mundësinë për kritikë konstruktive të politikave dhe procedurave të aktorëve të sektorit të sigurisë dhe u mundëson civilëve të fitojnë më shumë përgjegjësi lokale për problemet e sigurisë.

27. Të marrin pjesë në bashkëpunimin dhe dialogun ndërparlamentar me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe mirëkuptimit mbi drejtimin e sektorit të sigurisë.

Brenda një grupi shtetesh në rajon, parlamentet mund të bashkëpunojnë për t'u siguruar se të gjithë kanë në dispozicionin e tyre të njëjtin hapësirë për të marrë informacion, p.sh. duke hartuar raporte vjetore të përbashkëta dhe konferenca të kryetarëve të komisioneve të mbrojtjes. Një

dialog i tillë ndërparlamentar mund të nxisë shkëmbimin e eksperiencës dhe praktikave më të mira dhe të shërbejnë si një hap përpara drejt një standardizimi më të madh të praktikave të kontrollit, duke përfshirë ato mbi të drejtat e njeriut, ndërtimin e institucioneve demokratike dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile. Ato mund të lehtësojnë bashkëpunimin mbi çështjet ndërkufitare të sigurisë të tilla si trafikimi dhe krimi, ose të mbështesin dialogun mbi çështje që lidhen me konflikte të caktuara.

Nëpërmjet dialogut mbi këto çështje, parlamentarët jo vetëm e mbajnë veten të mirinformuar mbi aspektet ligjore me karakter ndërkombëtar, por mund të përmirësojnë shkallën e tyre të kuptimit mbi aspektet dhe instrumentet ligjorë të vlefshëm, të cilët ndihmojnë realizimin e një kontrolli demokratik.

Ndërtimi i institucioneve të mbështetura mbi demokracinë dhe të drejtat e njeriut

28. Të sigurojnë që institucionet e mandatuara ligjërisht ekzistojnë për të koordinuar, vëzhguar dhe realizuar aktivitetet e zbatimit të ligjit në të gjithë vendin, se ato funksionojnë në mënyrë efektive dhe bashkëpunojnë me të gjithë ministrinë përkatëse dhe partnerët e shoqërisë civile.

Përveç faktit që duhet t'i kushtojnë vëmendje nevojave të veçanta të sektorit të sigurisë, është e rëndësishme që parlamentarët të sigurohen se institucionet demokratike që monitorojnë dhe zbatojnë kontrollin e sektorit të sigurisë, funksionojnë në mënyrë të përshtatshme dhe të barasvlershme. Pavarësia e gjyqësorit dhe institucioneve të mbikëqyrjes së respektimit të të drejtave të njeriut (të tilla si Avokati i Popullit), dhe vlefshmëria e mekanizmave të zbatimit, instrumentet ligjorë dhe fondet e nevojshme për këtë qëllim, janë jetësore për të siguruar transparencën, qëndrueshmërinë dhe përgjegjësinë e sektorit të sigurisë.

29. Të ratifikojnë marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat lehtësojnë kontrollin demokratik dhe drejtimin e sektorit të sigurisë, duke përfshirë ato që garantojnë të drejtat e njeriut qoftë për burrat apo gratë.

Sërish, ratifikimi me karakter detyrues nga parlamentet është një mënyrë tepër e rëndësishme për t'u siguruar se ekzekutivi dhe agjencitë shtetërore janë të detyruara nga ligji ndërkombëtar për të zbatuar standarde të caktuara.

30. Të punojnë për të krijuar mirëkuptim dhe besim të dyanshëm ndërmjet civilëve dhe sektorit të sigurisë.

Është shumë e rëndësishme që marrëdhëniet ndërmjet civilëve dhe ushtrisë të shihen si një çështje e përgjegjësive të përbashkëta, të cilët duhet të karakterizohen nga besimi dhe dialogu. Besimi dhe dialogu nuk janë fenomene natyrore, ato duhet të fitohen. P.sh. nëse parlamentarët, në komisionin e mbrojtjes dhe të sigurisë, i japin një informacion të klasifikuar shtypit, ushtria dhe zyrtarët e tjerë të sigurisë do të ngurronin të ndanin një informacion të tillë sërisht me parlamentarët. Nga ana tjetër, nëse ushtria mbulon skandalet, besimi i civilëve tek ushtria do të dëmtohet seriozisht. Në këtë mënyrë një parlament demokratik mund të veprojë si një ndërmjetës konstruktiv ndërmjet aktorëve të ndryshëm.

Ndryshimi i menaxhimit në sektorin e sigurisë

Vetëm një vlerësim në mënyrë të programuar i gjendjes së sektorit të sigurisë në një vend, mund ta lejojë parlamentin të ndërmarrë iniciativa dhe objektiva të matshme për sa i përket këtij sektori, për të lejuar më tej ngritjen, realizimin dhe përhapjen e praktikave më të mira. Donatorët janë të gatshëm të ndihmojnë demokracitë e reja dhe po bëjnë hapa domethënës në reformën e sektorit të sigurisë dhe identifikimi i fushave të asistencës ndërkombëtare e ndihmon një vend për të krijuar përgjegjësinë e tij në këtë fushë. Ndërkohë, komisionet përkatëse të parlamentit mund të ndërmarrin dhe koordinojnë vetë nga ana e tyre vlerësime të tilla.

31. Të identifikojnë nevojat për zbatimin e programit të reformave në sektorin e sigurisë

Ndërmarrja e vlerësimeve të plota, për të përcaktuar ndikimin tërësor të reformës në sektorin e sigurisë, ka nevojë për aktorët qoftë në nivel individësh apo agjencie, duke përfshirë policinë, policinë kufitare, mbrojtjen, stafin e gjeneralëve, etj. dhe për të siguruar një përditësim të përshtatshëm të ecurisë së tyre.

32. Të hartojnë projektplane shumëvjeçare të veprimit me parashikimet e nevojshme të fondeve me qëllim që lehtësojnë kontrollin e planifikimit e të zbatimit si dhe për të garantuar një vlerësim të shpenzimeve të buxhetit.

Hapa të tillë do të lehtësojnë çdo aspekt të ndihmës së komunitetit ndërkombëtar për sa i përket këshillimit për çështjet teknike. Për të siguruar përfshirjen e parlamentit në procesin e reformës të sektorit të sigurisë, është veçanërisht e rëndësishme që të këmbëngulet në faktin që i jep të drejtë këtij institucioni të konsultohet dhe të informohet rregullisht mbi marrëveshjet e asistencës qoftë në Ministrinë e Mbrojtjes apo të Brendshme.

33. Të identifikojnë një listë me nevojat më prioritare.

Për të ndihmuar në zhvillimin e mëtejshëm demokratik të kapaciteteve në sektorin e sigurisë, cili është një ndër prioritetet kryesore, gjatë konsultimeve brenda vendit, por, gjithashtu, edhe me komunitetin ndërkombëtar, duhen identifikuar çështjet më të rëndësishme që ndikojnë mbi këtë sektor.

34. Të kërkojnë asistencën e ekspertëve për të arritur konsensusin mbi përfitimet e transparencës dhe përgjegjësisë në sektorin e sigurisë, duke përfshirë ndërlidhjen e dallimin ndërmjet të drejtave të njeriut, sigurisë njerëzore, nevojave të mbrojtjes, policimit, shërbimit informativ dhe zbatimit të ligjit.

Një nga burimet më të mëdha të kundërshtimit ndaj kontrollit demokratik të sektorit të sigurisë, është keqinterpretimi i idesë se të krijosh institucione transparente dhe të përgjegjshme në këtë fushë dobëson mbrojtjen dhe agjencitë e zbatimit të ligjit. Ndërkohë, vendet në të cilat agjencitë e sigurisë janë të korruptuara, zakonisht janë më pak të zhvilluara për shkak të sekretit të tejskajshëm me të cilat ato ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke mbetur të paefektshme, të cilat, si rezultat, më pas dekurajojnë investimet e huaja për shkak të korruptueshmërisë së tyre.

Rekomandime për shoqërinë civile:

Pjesëmarrja në kontrollin demokratik në sektorin e sigurisë

Organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm në kontrollin demokratik të sektorit të sigurisë duke filluar nga niveli kombëtar e deri në atë lokal. Duke u mbështetur në mandatin i tyre të përcaktuar qartë, organizatat e shoqërisë civile mund të ofrojnë dëshmi, informacione dhe analiza tepër të vlefshme për parlamentin dhe institucionet e tjera demokratike rreth mënyrave në të cilat politikat dhe aktivitetet e sigurisë kombëtare ndikojnë tek anëtarët e tyre dhe mbi shoqërinë si një e tërë. Ata shpesh përfaqësojnë interesat e grupeve të papërkrahura dhe në këtë mënyrë kanë mundësinë dhe fuqinë për të sjellë para opinionit një rreth të gjerë interesash. Në shumë shoqëri post-konfliktuale, organizatat e shoqërisë civile kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në mbështetje të zhvillimit dhe mbrojtjes të sektorit të sigurisë përmes funksioneve të ndryshme, duke filluar që nga ndihmat lehtësuese e deri te krijimi i besimit ndërmjet popullsisë së përgjithshme dhe autoriteteve.

Për më tepër, organizatat e shoqërisë civile kryejnë të njëjtin funksion duke bashkëvepruar me median, të cilat janë shpesh janë të parat që bëjnë publike e nxjerrin në dritë problemet e identifikuar prej shoqërisë civile ose që kërkojnë opinionin e shoqërisë civile rreth çështjeve tepër të debatueshme. Organizatat e shoqërisë civile mund të bashkëveprojnë me institucionet për sa i përket hartimit të zgjidhjeve, për sa i përket

problemeve në sektorin e sigurisë. Në përgjithësi, organizatat që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e lirisë së shprehjes, të drejtat e njeriut, policimin, aksesin në çështjet e drejtësisë e të mbrojtjes, synojnë të jenë në ballë të diskutimeve rreth çështjeve të sektorit të sigurisë, por është e rëndësishme të theksojmë se edhe ato që lidhen me minoritetet, gratë, marrëdhëniet mes gjinive apo fëmijët mund të japin një kontribut të vlefshëm në këtë drejtim.

1. Të zhvillojnë kapacitetet vëzhguese e analitike me të cilat të dokumentojnë e raportojnë mbi mënyrat në të cilat aktorët e sektorit të sigurisë prekin jo vetëm anëtarët e organizatave të shoqërisë civile, por shoqërinë në tërësi.

Organizatave të shoqërisë civile shpesh janë vendi më i përshtatshëm për të kryer këto funksione për shkak të natyrës së tyre si organizata joqeveritare, të cilat nuk shqetësohen për sa i përket ruajtjes apo jo të mandatit të qeverisë. Të dhënat nga organizatat e ndryshme shpesh bëjnë të mundur që tema të përbashkëta, apo edhe çështje të lëna jashtë vëmendjes, të identifikohen më shpejt dhe të hartohen zgjidhje të përshtatshme pa humbur kohë.

2. Të zhvillojnë kapacitetet vëzhguese e analitike me të cilat të dokumentojnë e raportojnë mbi efektivitetin me të cilën institucionet demokratike rregullojnë funksionimin e aktorëve të sektorit të sigurisë.

Vlerësimi i kompetencës së institucioneve demokratike që kanë përgjegjësinë për drejtimin e sektorit të sigurisë duhet të mbulojë ato në vijim: parlamentin, gjyqësorin, institucionet e avokatisë dhe njësitë e policisë lokale.

3. Të sigurojnë që mekanizmat e drejtimit të organizatës së tyre janë transparente dhe të përgjegjshme.

Organizatave të shoqërisë civile duhet të jenë të përgjegjshme po aq sa çdo aktor tjetër i përfshirë në debatet mbi drejtimin e sektorit të sigurisë. Ato duhet të jenë të hapura ndaj akuzës se

nuk janë as të përgjegjshme ndaj ndokujt, as se edhe aftësitë e tyre nuk janë të matshme. Organizatat e shoqërisë civile në këtë mënyrë duhet të kenë si minimum: fusha dhe mënyra të ushtrimit të aktivitetit që janë të qarta e lehtësisht të verifikueshme; një bord drejtues të zgjedhur; kontroll vjetor financiar si dhe raporte vjetore, të cilët bëjnë të njohur aktivitetin e organizatës.

4. Të fuqizojnë kapacitetet e ekspertizës për ta bërë sa më të vlefshëm rezultatin e organizatës dhe përdorimin e saj gjatë diskutimeve apo hetimeve që kryhen mbi politikat e praktikat në sektorin e sigurisë.

Organizatave të shoqërisë civile mund të shtojnë e fuqizojnë aftësitë e tyre dhe njohuritë bazë, duke kualifikuar stafin e tyre, i cili është përgjegjës për çështjet e sigurisë. Ky kualifikim do të përfshinte ndërgjegjësimin mbi normat ndërkombëtare, shembujt dhe praktikat më të mira në çështjet e reformës së sektorit të sigurisë.

5. Të bashkëveprojnë me median lokale e kombëtare në diskutimin e çështjeve të sektorit të sigurisë.

Duke monitoruar dhe raportuar mbi çështjet e sigurisë, organizatave të shoqërisë civile shpesh u kërkohet të komentojnë mbi aspekte të rëndësishme të kësaj fushe, ndërkohë që kanë kapacitetin dhe aftësinë për të nxjerrë në vend të parë çështje të kësaj natyre që lidhen me sektorin e sigurisë.

6. Të zhvillojnë kapacitetet për rritjen e ndërgjegjësimit.

Në nivelin lokal e kombëtar, kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile për rritjen e ndërgjegjësimit janë të varura nga burimet e tyre, aftësitë dhe buxhetet. Ato nuk kanë nevojë vetëm që të jenë në gjendje t'i ndërtojnë këto kapacitete e të nxisin zgjidhjen e problemeve në njërën anë, por në të njëjtën kohë duhet t'i zhvillojnë ato në përputhje me profilin e tyre dhe burimet që zotërojnë.

7. Të zhvillojnë kapacitetet trajnuese.

Në nivel lokal e kombëtar, kapaciteti i organizatave të shoqërisë civile për të trajnuar civilët mbi çështjet më të ndjeshme mbetet një nga funksionet e tyre më kryesore, përgjatë rritjes së ndërgjegjësimit. Aftësia për të informuar dhe kualifikuar civilët mbi çështjet më të rëndësishme u mundëson këtyre organizatave të shoqërisë civile që, së bashku me ndërgjegjësimin, të përhapin njëkohësisht edhe mirëkuptimin.

8. Të zhvillojnë kapacitetin për të realizuar fushata të qëndrueshme mbi çështjet kritike të kontrollit në fushën e sigurisë.

Mbi bazën e monitorimit, analizës, raportimit dhe bashkëveprimit me aktivitetet e medias, kur organizatat e shoqërisë civile identifikojnë problemet, të cilat nuk janë trajtuar apo zgjidhur në mënyrë jo të kënaqshme, ata mund të llobojnë përfaqësuesit lokalë dhe kombëtarë, institucionet dhe mediat që të përqendrohet vëmendja mbi këto çështje. Platformat e këtij veprimi mund të ndërtohen duke angazhuar edhe përfaqësuesit ndërkombëtarë të të njëjtit nivel. Fushatat mund të kenë natyrë informuese, por ato mund të tërheqin vëmendjen drejt një problemi të veçantë dhe të mbrojnë një zgjidhje të caktuar.

9. Të kërkojnë të ndjekin një rol dinamik në çështjet e kontrollit të sektorit të sigurisë në nivelet lokale e kombëtare.

Për shkak të fushës së tyre të specializuar të veprimit, planit të aktiviteteve dhe anëtarësisë, organizatat e shoqërisë civile mund të luajnë një rol jetësor duke kontribuar me rezultatet e tyre të rëndësishme në diskutimet në nivel lokal e kombëtar. Në nivel kombëtar këto organizata mund të bashkëpunojnë me parlamentin, median kombëtare, ministritë dhe institucionet demokratike; në nivel lokal me parlamentarën e tyre, median lokale dhe përfaqësuesit e qeverisjes lokale si dhe njësitë e tjera të qeverisjes vendore.

10. Të ndërtojnë rrjete me organizatat e tjera që punojnë në çështjet e kontrollit të sektorit të sigurisë.

Për shkak të natyrës së aktivitetit, fondeve dhe burimeve njerëzore, organizatat e shoqërisë civile shpesh përqendrohen në një rreth të ngushtë e të përcaktuar çështjesh. Meqë çdo organizatë ka aftësi dhe burime të ndryshme, një bashkëveprim dinamik ndërmjet organizatave mbi çështje të veçanta i ndihmon që të përmirësojnë kapacitetet e tyre për të bërë fushatë rreth tyre. Për më tepër, një bashkëpunim gjithnjë e më i mirë, jo vetëm fuqizon procesin e përkrahjes ndaj një çështje të caktuar, por dhe parandalon mbivendosjen e përpjekjeve prej organizatave me mjete shpesh të kufizuara.

11. Të përdorin rrjetet e ngritura për të krijuar dhe shkëmbyer platformat e fushatës me organizata të tjera të shoqërisë civile që punojnë në çështjet e kontrollit në sektorin e sigurisë.

Shkëmbimi i platformës me organizatat lokale, kombëtare apo ndërkombëtare nuk përmirëson vetëm mundësinë dhe larminë e aftësive për të kryer një detyrë të veçantë: ky veprim krijon një forum të mandatuar, nëpërmjet të cilit konsensusi kolektiv i këtyre organizatave mund t'u paraqitet të tjerëve duke përfshirë autoritetet qeveritare, mediat dhe donatorët. Nëpërmjet procesit të një rrjetëzimi të tillë, organizatat e shoqërisë civile fuqizojnë bazën mbështetëse duke rritur peshën e tyre për të ndikuar në vendimet që do të merren.

12. Të kërkojnë të marrin pjesë aktivisht në procesin këshillues për çështje të legjislacionit dhe formimin e rrjeteve rregullatore.

Në bazë të ekspertizës së tyre, OJF-të kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur, duke kontribuar në debatin mbi reformat ligjore në vendet e tyre, veçanërisht të atyre që mbështesin lirinë e organizimit, krijimin e kuadrit rregullator, lirinë e shprehjes e të medias.

13. Të ndërmarrin një analizë gjinore dhe të sigurohen se interesat e burrave, grave dhe fëmijëve janë pasqyruar në plan-aktivitetet e organizatës.

Është e rëndësishme që të analizohen çështjet e ndryshme të sigurisë që prekin burrat, gratë, fëmijët dhe për t'i përfshirë ato në veprimtarinë e përditshme e planin e aktiviteteve të organizatës. Gratë dhe fëmijët janë shpesh të prekur nga një sërë elementesh - p.sh. të drejtat e njeriut, aksesit në drejtësi, diskriminimi, zbatimi i ligjit, të drejtat e minoriteteve, nevojat e shërbimeve sociale - të cilat, ndërkaq, të mbledhura bashkë formojnë një tërësi nevojash e interesash që janë shpesh shumë të dukshme. Aktivitetet mund të jenë të formave të ndryshme, të mbështetura mbi parandalimin, mbrojtjen dhe fuqizimin, ku organizatat e shoqërisë civile mund të kërkojnë të veprojnë si mbrojtëse të çështjeve të mëposhtme.

Parandalimi i dhunës ndaj grave nëpërmjet:

- Rritjes së shkallës së ndërgjegjësimit mbi të drejtat e grave dhe krimeve që kryhen mbi baza gjinore
- Rritjes së shkallës së ndërgjegjësimit për ndëshkimin e dënimit e trafikantëve
- Kualifikimit efektiv të policisë
- Mbledhjes efektive të të dhënave për diskriminimin gjinor
- Kërkimeve të mëtejshme mbi shkaqet, pasojat dhe zgjidhjet
- Vlerësimit dhe monitorimit efektiv
- Vëmendjes nga strukturat përkatëse të kontrollit për kulturat e dhunës dhe marrëdhëniet gjinore që nxisin dhunën ndaj grave

Mbrojtja e grave ndaj dhunës nëpërmjet:

- Ratifikimit universal të instrumenteve ndërkombëtare mbi të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe çështjet humanitare
- Zbatimit efektiv të reformës ligjore dhe përmirësimit të aksesit në drejtësi
- Sigurimit të ndëshkimit të nevojshëm për trafikantët në ligj dhe praktikë

- Forcimit të mekanizmave institucionalë për mbrojtjen e tyre, duke përfshirë, nëpërmjet trajnimit, nevojat e sigurisë së grave dhe marrëdhëniet gjinore
- Shpërndarjes së buxheteve të nevojshme
- Krijimit të strehëzave për gratë e trafikuar si dhe mekanizmave të tyre mbështetës
- Mbrojtjes së grave në konfliktet e armatosura

Fuqizimi i grave kundër diskriminimit nëpërmjet:

- Arsimit dhe kualifikimit
- Pjesëmarrjes në vendimmarrje

14. Të sigurojnë trajtimin e nevojave ndaj minoriteteve dhe grupeve që janë të rrezikuara.

Në situatën pas konflikteve, ka shpesh grupe minoritetesh të zhvendosur me dhunë, ish-luftëtarë apo ish-të burgosur që janë pjesërisht të rrezikuar kur një sektor sigurie është i dobët. Këto grupe mund të përfitojnë nga zbatimi i planit të aktiviteteve që përmendëm më lart, i cili është i lidhur me këto grupe të pambrojtura.

Rekomandime për donatorët:

Trajtimi i dimensionit të qeverisjes në reformën e sektorit të sigurisë.

Vendet donatore dhe organizatat ndërkombëtare mund të mbështesin reformat në sektorin e sigurisë në periudhën post-totalitare. Rëndësia e reformës në sektorin e sigurisë njerëzore është tashmë gjerësisht e njohur për sa i përket qeverisjes demokratike dhe zhvillimit njerëzor dhe një angazhim rreth kësaj çështjeje është paraqitur p.sh. edhe në procesin e OECD/DAC. Duke qenë se vullneti kombëtar për të realizuar një reformë afatgjatë shpesh identifikohet si një peshë jo e lehtë, asistenca nuk duhet të përqendrohet vetëm mbi funksionimin e mekanizmave të sigurisë, por duhet të përfshijë edhe aktivitetet që lidhen me politika të tilla si informimi, këshillimi dhe ndihma ndaj strukturave të kontrollit.

Asistenca në reformën e sektorit të sigurisë ende synon të përqendrohet mbi ekzekutivin dhe strukturat e sigurisë, ndërkohë që parlamentet e publiku i gjerë përfshihen vetëm pjesërisht. Kjo mënyrë të çon drejt kompetencës në rritje të instrumenteve të sigurisë në vartësi të ekzekutivit, ndërkohë që nuk trajtohet aspekti i qeverisjes si p.sh. llogaridhënia e përgjegjësia e këtyre instrumenteve ndaj parlamentit të zgjedhur.

1. Të dokumentojnë dhe shpjegojnë dallimin ndërmjet koncepteve të mbrojtjes, sigurisë njerëzore, transparencës dhe përgjegjshmërisë.

Shpesh nuk dallohet qartë koncepti nëse transparenca dhe llogaridhënia në sektorin e sigurisë dhe veçanërisht në sektorin e mbrojtjes mund ta përmirësojë kapacitetin mbrojtës të shtetit në vend që ta dobësojë atë. Përkrahës dhe profesionistë të tillë që vuajnë nga shkeljet e përsëritura të të drejtave të njeriut janë më pak efektivë se ata të drejtat e të cilëve janë të mbrojtura. Këto dhunime mund të çojnë në përçimin e një kulture dhune që bie në kundërshtim dhe mohon qëllimet e këtij sektori. Në mënyrë të ngjashme, korrupsioni mund të çojë në humbjen e municionit të armëve të vogla, karburantit apo elementëve të tjera me vlerë të lartë. Parlamentarët duhet të inkurajohen që të ndihmojnë krijimin dhe ruajtjen e mekanizmave të transparencës për të parandaluar humbje të tilla të burimeve në sektorin e sigurisë.

2. Të shpjegojnë rolet e institucioneve të veçanta të sektorit të sigurisë në qeverisjen demokratike dhe nën sundimin e ligjit.

Në këtë rast merr rëndësi të veçantë përcaktimi i roleve të veçanta që duhet të kenë në sektorin e sigurisë, gjyqësori, individët që merren me mbikëqyrjen e zbatimit e mbrojtjes së të drejtave si p.sh. avokati i popullit, inspektori i përgjithshëm dhe shoqëria civile në qeverisjen e sektorit të sigurisë dhe ndërlidhja e secilit prej këtyre institucioneve dhe aktorëve të ndryshëm duke përfshirë kufizimet mbi privilegjet absolute ekzekutive. Për më tepër, është e rëndësishme të përcaktohet

roli i të drejtave të njeriut në kontekstin e sektorit të sigurisë dhe të shpjegohen rrugët në të cilat drejtimi i sektorit të sigurisë është një proces dinamik.

3 Të theksojnë rolin e shoqërisë civile dhe rëndësinë e procesit të konsultimit për të krijuar përgjegjësinë lokale dhe kombëtare për problemet e sigurisë dhe të kërkojnë rrugët për të ndikuar mbi të.

Vetëm duke realizuar një zhvillim të interesave civile dhe ekspertizës në këto çështje mund të kryhet një kontroll me të vërtetë demokratik. Shoqëria civile mund të shërbejë në një rol të dyfishtë, nga njëra anë duke fuqizuar parlamentarët nëpërmjet dhënies së informacionit dhe nga ana tjetër duke mbajtur parlamentin, institucionet dhe ekzekutivin të përgjegjshëm përmes monitorimit e aktiviteteve të medias si dhe duke vënë më në pah interesat e grupeve të papërkrahura të tilla si gratë dhe minoritetet.

4. Të përkrahin nocionin e sigurisë njerëzore si një vizion alternativ në raport me një agjendë të sigurisë ku në qendër është shteti.

Koncepti i sigurisë njerëzore është ende një element, i cili kuptohet shumë pak në shumë vende në zhvillim dhe në tranzicion. Ndërkohë që strategjitë kombëtare të sigurisë dhe debatet parlamentare janë të mbizotëruara nga një vizion për sigurinë me në qendër shtetin e ku kontrolli demokratik do të mbetet i dobët e me një ndikim negativ mbi të drejtat e njeriut dhe zhvillimin njerëzor qoftë për burrat, qoftë për gratë.

5. Të ofrojnë asistencë financiare dhe teknike për komisionet parlamentare përkatëse të sektorit të sigurisë.

Asistenca e rëndësishme për komisionet parlamentare përfshin:

- Këshillimin mbi përbërjen e komisioneve dhe rregullat e procedurës.
- Zhvillimin dhe përmirësimin e elementëve të ndryshëm mbi çështjet e buxhetit, auditimit, kontrollit dhe prokurimit.

- Forcimin e kapaciteteve hetimore.
- Lidhjen e komisioneve dhe anëtarëve të parlamentit me ekspertë të mbrojtjes, shoqërinë civile dhe institute apo qendra studimore joqeveritare.
- Ofrimin e këshillës së ekspertëve mbi çështje teknike dhe legislative dhe lehtësimin e aksesit në kërkime të pavarura mbi çështjet e sigurisë.
- Nxitjen e shkëmbimit të eksperiencës me komisione të tjera, duke përfshirë organizimin e vizitave studimore në vende të ndryshme.
- Rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit për konceptin e sigurisë njerëzore, duke përfshirë në mënyrë të veçantë çështjet që prekin sigurinë e grave (p.sh. përdhunimi, trafikimi, etj.).

6. Të mbështesin kualifikimin e stafëve të parlamentit dhe ekspertëve të shoqërisë civile.

Në shumë vende në tranzicion, ka një mungesë të ekspertizës civile mbi çështjet e sigurisë qoftë brenda, qoftë jashtë parlamentit. Programet e kualifikimit mund të ndihmojnë që të trajtohet kjo mangësi për sa i përket mungesës së kapaciteteve. Ndërkohë, të tilla programe të orientuara janë të rëndësishme dhe më të qëndrueshme, dhe aty ku është e mundur ato mund të ndihmojnë në rishikimin e skemave kombëtare të kualifikimit dhe të integritimit të atyre elementeve që përmbajnë çështje që lidhen me sigurinë.

7. Të përshtatin programe të ndihmës që nxisin kontrollin demokratik në sektorin e sigurisë.

Shumica e agjencive të zhvillimit kanë procese të ndara menaxhimi dhe zbatimi për sa i përket punës së tyre mbi qeverisjen demokratike, sundimit të ligjit, dhe të drejtave të njeriut, nga njëra anë, dhe parandalimit të konfliktit e reformës në sektorin e sigurisë, nga ana tjetër. Elementë shumë të rëndësishëm shpesh ngelen pa u shfrytëzuar. Në këtë mënyrë mund të gjenden pika të reja takimi nëse çështjet që i takojnë konfliktit, sigurisë dhe qeverisjes demokratike trajtohen bashkërisht.

Hapi i parë do të ishte përfshirja elementëve që lidhen me sigurinë në programet e rëndësishme të qeverisjes p.sh. mbi zhvillimin parlamentar, dhe për të përfshirë të drejtat e njeriut dhe përbërësit e tjerë të qeverisjes në programet e konflikt/sigurisë p.sh. mbi policimin. Në të gjitha rastet duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë faktit se në procesin e konsultimit, planifikimit e monitorimit janë përfshirë plotësisht strukturat e zgjedhura demokratike në nivel kombëtar, rajonal e lokal.

8. Në disa vende mund të jetë e vështirë që çështjet e kontrollit të sigurisë të trajtohen nëpërmjet mbështetjes së drejtpërdrejtë të komisioneve të mbrojtjes apo sigurisë së brendshme. Ky mund të jetë rasti kur nuk ka vullnet për reforma sepse ose pushteti i parlamentit, ose kapacitetet e gjyqësorit janë shumë të kufizuara. Në vend që të braktiset objektivi i nxitjes së kontrollit në sektorin e sigurisë, një mundësi mund të jetë përdorimi i një mënyre jo të drejtpërdrejtë kontrolli nëpërmjet:

- Forcimit të pavarësisë parlamentare (statusi i shërbimit civil, kualifikimi profesional, imuniteti parlamentar, rishikimi i rregullave të procedurës së parlamentit).
- Trajtimin të korrupsionit politik (rishikimi i ligjit për partitë politike, legjislacioni për pastrimin e parave).
- Përqendrimin mbi pushtetet dhe kompetencat e komisionit të buxhetit.
- Nxitjes së ndërveprimit parlamentar me shoqërinë civile dhe burime të tjera informacionit jo partizan.
- Rishikimit të kuadrit ligjor për median e lirë, marrjen pa pengesa të informacionit dhe mbrojtja e gazetarëve.
- Zhvillimit të një kuadri ligjor për mbrojtjen e personave që mund të nxjerrin informacione sekrete, por që nëpërmjet tyre mbrojnë interesat e publikut.
- Mbështetjes së një gjyqësori të pavarur ashtu si edhe institucionet e ndryshme të avokatisë.
- Mbështetjes së komisioneve parlamentare të të drejtave të njeriut dhe hetimeve të tyre.

Ky është edhe aspekti më i rëndësishëm për të integruar një perspektivë që lidhet me çështjet e sigurisë në një program qeverisjeje demokratike.

Kol. (Rez.) Dr. Kudret Mita

ZGJERIMI I NJOHURIVE MBI ALEANCËN E ATLANTIKUT TË VERIUT ME ANË TË RIBOTIMIT TË MANUALIT TË NATO-S

Të gjitha qeveritë e vendeve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO - North Atlantic Treaty Organization) e njohin si të drejtë demokratike të qytetarëve të tyre informimin rreth strukturave ndërkombëtare. Ato përbëjnë themelet për sigurinë e tyre kombëtare. Organizata të përmasave të mëdha si Aleanca e Atlantikut të Veriut, në përmbushje të detyrimit për zgjerimin e njohurive të publikut, janë të përgatitura për të vënë në dispozicion të tij një informacion sa më të bollshëm. Kjo përpjekje ndihmon për të rritur vetëdijësimin dhe njohuritë e publikut në vendet anëtare e partnere rreth çështjeve me të cilat merret Aleanca dhe për të nxitur debatin e frytshëm lidhur me politikën dhe objektivat e saj, ndërkohë që edhe vetë Aleanca përfiton prej përvojës së fituar nga pikëpamjet dhe vlerësimet e publikut të gjerë dhe të grupeve të specializuara brenda tij.

Për këtë arsye, në veprimtarinë botuese të NATO-s është kthyer në traditë tashmë, që pas një periudhe kohore pesëvjeçare, të rishikohet dhe të rifreskohet pjesa më e madhe e përmbajtjes së librit të historikut të Aleancës për të pasqyruar zhvillimet më të rëndësishme të kohëve të fundit që kanë ndikuar mbi NATO-n dhe mjedisin e sigurisë dhe për të shqyrtuar ato prirje kryesore që janë në ngjizje e sipër. Nisur nga rëndësia e veçantë që i kushtohet në revistën “Çështje të sigurisë” përmbushjes së njërit prej objektivave kryesorë të saj, lidhur me “informimin e publikut mbi NATO-n në këtë periudhë të rëndësishme transformimi dhe zgjerimi të organizatës”, në vijim do të paraqitet përmbledhtazi përmbajtja

e Manualit të NATO-s (NATO Handbook)¹. Në Manual është bërë një përvijim i hollësishëm i veprimtarisë së gjithanshme të Aleancës, në një material prej mbi 400 faqe. Duke qenë tepër vëllimor, është vështirë të bëhet përzgjedhja dhe të tkurret shtjellimi i përmbajtjes brenda caqeve të kufizuara që lejojnë faqet e një reviste.

Për rrjedhojë, i është dhënë përparësi trajtimit të atyre çështjeve që ndihmojnë më shumë për të kuptuar problemet kyçe të politikave të Aleancës dhe thelbin e veprimtarisë së saj. Në këtë kontekst, theksi është vënë më tepër në Konceptin Strategjik të Aleancës, në institucionet kryesore politike dhe vendimmarrëse të NATO-s, në ecurinë e zhvillimit të partneritetit dhe në bashkëpunimin institucional me organizatat ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, vëmendje e veçantë i është kushtuar trajtesave që paraqesin interes të veçantë në mbështetje të synimeve tona për t'u anëtarësuar në NATO, të cilat lidhen me veprimtari të tilla si, këshillimi politik, marrja e vendimit me konsensus, administrimi i krizave, operacionet paqeruajtëse të NATO-s në Bosnjë e Hercegovinë dhe, në veçanti, në Kosovë, Nisma e Evropës Juglindore, etj.

Kundruar në këto këndvështrime, ky material do të ndikojë për të krijuar një tablo më të qartë të tematikës kryesore të NATO-s. Prandaj, njohja paraprakisht me këtë përmbledhje dhe me vetë Manualin e NATO-s, do t'u vijë në ndihmë parlamentarëve, politikanëve, zyrtarëve, specialistëve të sigurisë, analistëve, gazetarëve, ekspertëve nga shoqëria civile dhe shtresave të tjera të shoqërisë që janë të interesuara për informacionin mbi NATO-n.

Në ribotimin e fundit të Manualit të NATO-s bëhet një analizë e ecurisë së Aleancës deri në vjeshtë të vitit 2005 dhe një informacion më i plotë mund të gjendet në faqen e internetit të NATO-s (www.nato.int), ku ofrohet mundësia për të njohur zhvillimet e mëpastajme që kanë ndikuar mbi Aleancën, si dhe tekstet e deklaratave, komunikatave zyrtare dhe artikujt e fjalimet e komentuesve të kualifikuar që paraqesin vlerësimet dhe analizat e tyre të pavarura.

¹ Varianti i plotë i Manualit të NATO-s në gjuhën angleze gjendet në këtë lidhje interneti: <http://www.nato.int/docu/other/al/handbook.pdf>

Manuali i NATO-s është botuar nga Dega e Diplomacisë Publike e NATO-s, nën autoritetin e Sekretarit të Përgjithshëm, si një libër referimi për Aleancën dhe për politikën e saj. Subjekti kryesor i ribotimit të fundit mund të përmbledhet si i ka përballuar Aleanca sfidat e së kaluarës dhe si i ka filluar përgatitjet për t'u aftësuar që të plotësojë angazhimet po aq sfiduese të së ardhmes. Formulimet e përdorura pasqyrojnë në mënyrën më të afërt të mundshme konsensusin ndërmjet vendeve anëtare. Megjithatë, ky Manual nuk është një dokument i NATO-s i miratuar zyrtarisht dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përfaqësojë mendimet e qëndrimet zyrtare të çdo qeverie më vete, për secilën çështje të diskutuar.

Në Parathënien e Manualit theksohet se gjatë dyzet viteve të para të ekzistencës së saj, Aleanca kaloi nëpër një varg reformash e riorganizimesh, me qëllim që të kapërceheshin pengesat e Luftës së Ftohtë dhe të arrihej siguria e vendeve anëtare mbi themele të shëndosha e të qëndrueshme. Në periudhën përafërsisht të shkurtër, që prej përfundimit të Luftës së Ftohtë, është kaluar nëpër një proces shndërrimi tepër rrënjësor, duke iu përshtatur ndryshimeve në mjedisin e sigurisë.

Në **Pjesën I** të Manualit “**NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR PËR ALEANCËN**” jepen shpjegime për zanafillën dhe detyrat themelore të Aleancës. Në të përfshihet një vlerësim përmbledhës i orientimeve politike të vendeve të NATO-s, lidhur me sigurinë shumëkombëshe, duke u përqendruar në periudhën më të fundit pas Luftës së Ftohtë dhe shqyrtohen çështjet kryesore që janë në rend të ditës së Aleancës në fillimvitet e shekullit XXI.

Fillimisht, theksohet se NATO është një aleancë e 26 vendeve, nga Amerika e Veriut dhe Evropa, të angazhuara për të përmbushur qëllimet e Traktatit të Atlantikut të Veriut, të nënshkruar në Uashington më 4 prill 1949.

Qysh prej krijimit, në qendër të vëmendjes së NATO-s ka qenë mbrojtja e vendeve anëtare të saj. Kjo mbetet detyrë themelore edhe sot, por thelbi i veprimtarisë së saj ka përfutur

ndryshime rrënjësore me qëllim që Aleanca të përballojë kërcënimet e reja dhe t'u përgjigjet sfidave të së ardhmes. Detyrat thelbësore të sigurisë së NATO-s janë përshkruar në Konceptin Strategjik të Aleancës. Ai përbën formulimin më autoritar të objektivave të Aleancës dhe siguron nivelin më të lartë të udhëheqjes lidhur me mjetet politike dhe ushtarake që duhen përdorur për arritjen e tyre. Megjithatë, ndryshimi i natyrës së kërcënimeve dhe i perceptimit të tyre, kanë çuar në një proces të pandërprerë përshtatjeje të kësaj strategjie.

Koncepti 'strategjik', i publikuar fillimisht më 1991, ndryshonte rrënjësisht nga dokumentet paraardhëse si në përmbajtje dhe në formë. Në të vazhdonte të ruhej siguria e anëtarëve të saj, por diçka e tillë ndërthurej me detyrimin e veçantë për të punuar në drejtim të një sigurie më cilësore, por edhe më të zgjeruar për Evropën, nëpërmjet partneritetit dhe bashkëpunimit me kundërshtarët e mëparshëm. Koncepti 'strategjik' u ripunua më 1999, duke i angazhuar aleatët jo vetëm për mbrojtjen e përbashkët, por dhe të paqes e stabilitetit të një zone më të gjerë evro-atlantike. Ai përfshin faktorët e mëposhtëm politikë:

- Një këndvështrim më të gjerë për sigurinë, duke përmbledhur faktorët politikë, ekonomikë, shoqërorë e mjedisorë, si dhe përmasën mbrojtëse të Aleancës.
- Një angazhim të fuqishëm ndaj marrëdhënieve transatlantike.
- Ruajtje të aftësive luftarake të Aleancës për të siguruar frytshmërinë e operacioneve ushtarake.
- Përmirësim të aftësive evropiane brenda Aleancës.
- Ruajtje të strukturave dhe procedurave të mjaftueshme për parandalimin e konflikteve dhe administrimin e krizave.
- Një partneritet të frytshëm me vendet jo anëtare të NATO-s, të mbështetur në bashkëpunimin dhe bashkëbisedimin.
- Zgjerim të Aleancës dhe një politikë të dyerve të hapura kundrejt vendeve të reja që mund të anëtarësohen.
- Përpjekje të vijueshme për marrëveshje me ndikim të gjerë, për çarmatimin, mospërhapjen dhe kontrollin e armëve.

Në **Pjesën II "POLITIKA DHE VENDIMMARRJA"** janë përshkruar organet kryesore vendimmarrëse dhe politikat

e parimet e rëndësishme prej të cilave udhëhiqet Aleanca. Në të trajtohet edhe administrimi i krizave, përmasa e planëzimit të mbrojtjes, burimet e fondeve të përbashkëta, politika bërthamore dhe sfera ekonomike.

Një nga parimet më të rëndësishme të NATO-s është ai i marrjes së vendimit me konsensus. Ky parim zbatohet në të gjitha nivelet e Aleancës. Është pikërisht ky proces vendimmarrës që i jep NATO-s njëherësh qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e vet.

Institucionet kryesore politike dhe vendimmarrëse të Aleancës janë Këshilli i Atlantikut të Veriut, Komiteti i Planëzimit të Mbrojtjes dhe Grupi i Planëzimit Bërthamor. Çdonjëri prej tyre luan një rol vendimtar në proceset këshillimore dhe vendimmarrëse që përbëjnë themelet e bashkëpunimit, planëzimit të përbashkët dhe sigurisë së pandashme të vendeve anëtare që Aleanca përfaqëson. Vendimet e marra prej secilit nga këto organe kanë të njëjtën gjendje juridike dhe përfaqësojnë politikën e miratuar të vendeve anëtare, pavarësisht nga niveli në të cilin merren. Autoriteti më i lartë politik dhe vendimmarrës në NATO është Këshilli i Atlantikut të Veriut, i cili bashkon përfaqësuesit e të gjithë aleatëve në nivelin e ambasadorëve, ministrave ose kryetarëve të shteteve dhe qeverive. Këshilli ka një profil të rëndësishëm publik dhe shpall deklarata dhe komunikata që shpjegojnë politikën dhe vendimet e Aleancës për publikun e gjerë dhe qeveritë e vendeve që nuk janë anëtare të NATO-s.

Këshilli është i vetmi organ i Aleancës, autoriteti i të cilit buron qartësisht nga Traktati i Atlantikut të Veriut. Këshillit vetë i është dhënë përgjegjësia sipas Traktatit për të formuar organe ndihmëse. Çështjet që diskutohen dhe vendimet që merren në mbledhjet e Këshillit mbulojnë të gjitha aspektet e veprimtarive të Organizatës. Nuk ka votim apo marrje vendimi me shumicë. Çdo vend anëtar i përfaqësuar në tryezën e Këshillit, ose në cilindo komitet vartës të tij, ruan sovranitet dhe përgjegjësi të plotë për vendimet e veta.

Këshillimi është një pjesë thelbësore e procesit të vendimmarrjes për vetë faktin se formulimi dhe zbatimi i

politikës, në një Aleancë vendesh sovrane të pavarura, varet nga mirinformimi i të gjitha qeverive anëtare për politikën dhe synimet e përgjithshme të njëra-tjetrës. Kjo shtrun kërkesën për këshillime të rregullta politike, në çdo rast të mundshëm gjatë fazës shqyrtuese të përpunimit të vendimit, para marrjes së vendimeve kombëtare.

Forumi kryesor për këshillime politike mbetet Këshilli. Mbledhjet e tij zhvillohen në cakun më të ulët të zyrtarizimit dhe diskutimi është i hapur dhe i drejtpërdrejtë. Sekretari i Përgjithshëm, në sajë të kryesisë së tij, luan një rol themelor me vlerësimet e tij dhe vepron si përfaqësues dhe zëdhënës kryesor, si në kontaktet me qeveri të veçanta, ashtu edhe në çështje publike.

Këshillimi politik ndërmjet anëtarëve të Aleancës nuk kufizohet vetëm në ngjarjet që ndodhin brenda zonës evropatlantike. Edhe ngjarjet diku gjetkë, që kanë pasoja të mundshme për Aleancën, po zënë vend gjithnjë e më shpesh në rendin e ditës së Këshillit dhe të komiteteve vartëse. Mekanizmat këshillimorë të NATO-s janë përherë të gatshëm dhe përdoren gjerësisht nga anëtarët në rrethana të tilla, me qëllim që të përcaktohen në një fazë të hershme zonat ku, për hir të interesave të sigurisë e të stabilitetit, duhet të ndërmerret veprimi i bashkërenduar. Nevoja për këshillim nuk mund të jetë e kufizuar vetëm për çështje politike. Këshillime me shtrirje të gjerë bëhen në shumë fusha të tjera.

Mënyra se si ka evoluar Aleanca krijon një siguri se ndryshueshmëritë në kërkesat dhe politikën e vendeve anëtare mund të merren parasysh në kuadrin e qëndrimeve të tyre brenda Aleancës. Ky elasticitet shfaqet në disa forma të ndryshme. Në disa raste mospërkimet mund të jenë në përgjithësi të karakterit proceduror dhe zgjidhen pa vështirësi. Islanda, për shembull, nuk ka forca ushtarake dhe, për rrjedhojë, përfaqësohet në forumet ushtarake të NATO-s nëpërmjet një civili kur e gjykon të arsyeshme. Në raste të tjera dallimet mund të jenë të një natyre më të mëvetësishme. Franca, një anëtare themeluese e NATO-s, u tërhoq nga struktura e integruar ushtarake e Aleancës më 1966, ndërkohë që mbeti anëtare me të drejta të plota në strukturat e saj politike.

Dallimet midis vendeve anëtare të NATO-s mund të ekzistojnë edhe si pasojë e rrethanave të tyre gjeografike, politike, ushtarake ose kushtetuese. Pjesëmarrja e Norvegjisë dhe e Danimarkës në rendimet luftarake të NATO-s, për shembull, duhet të kryhet në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, i cili nuk lejon forca të huaja, ose armë bërthamore që të vendosen në territorin e tyre kombëtar në kohë paqeje. Në një rrethanë tjetër, komandat ushtarake brenda strukturës së integruar ushtarake, mund të përfshijnë vetëm forcat e atyre vendeve të interesuara për të marrë pjesë në detyra të posaçme për të cilat ka qenë e krijuar komanda.

Administrimi i krizave ka qenë një pjesë e rëndësishme, gjithnjë në rritje, e rolit të NATO-s në vitet që prej përfundimit të Luftës së Ftohtë. Ai mund të përfshijë njëherësh masat ushtarake dhe jo ushtarake, në përgjigje të një situatë krize që kërcënon sigurinë kombëtare apo atë ndërkombëtare. Një krizë mund të jetë në thelb me natyrë politike, ushtarake apo humanitare dhe mund të shkaktohet nga mosmarrëveshjet politike ose konfliktet e armatosura, nga incidentet teknologjike, ose nga fatkeqësitë natyrore. Administrimi i krizave përmbledh mënyra të ndryshme për trajtimin e larmisë së krizave.

Në praktikë, kundërveprimi kombëtar apo ndërkombëtar ndaj një krize, ose ndaj një situatë që rrezikon të shndërrohet në krizë, kushtëzohet nga natyra, shkalla dhe rëndësia e situatës. Në disa raste mund të parashikohet dhe të parandalohet një krizë me anë të diplomacisë ose masave të tjera. Në raste të tjera mund të jenë të nevojshme masa më të forta, përfshirë veprimet ushtarake. Veç këtyre, në varësi të natyrës së krizës, autoritetet kombëtare mund të shqyrtojnë lloje të ndryshme të operacioneve të administrimit të krizave.

Brenda NATO-s, aktualisht veprojnë dy kategori kryesore dhe pikërisht, operacionet ku kërkohet mbrojtja e përbashkët dhe operacionet e tjera kundërvepruese ndaj krizave në të cilat mund të mos zbatohet mbrojtja e përbashkët. Operacionet e mbrojtjes së përbashkët bazohen në kërkesën ndaj Nenit 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe përmenden si “Operacionet e Nenit 5”. Ato mbartin në vetvete pasojat e vendimit që merret

bashkërisht nga anëtarët e NATO-s, që e vlerësojnë një sulm ose akt agresioni kundër njërit ose më shumë anëtarëve, si një sulm kundër të gjithëve.

Operacionet e tjera kundërvepruese ndaj krizave përfshijnë të gjitha operacionet ushtarake, në të cilat Aleanca mund të vendosë të drejtojë, në një situatë jashtë Nenit 5. Ato mund të jenë të paracaktuara për të mbështetur procesin e paqes në një rajon konflikti dhe, në këto rrethana, përmenden si operacione paqembështetëse. Megjithatë, ato përfshijnë një mori mundësish të tjera, si: parandalimin e konflikteve, paqeruajtjen dhe masat në përforcim të paqes, paqësimin, paqevendosjen, përqendrimit parandalues dhe operacionet humanitare. Përfshirja e NATO-s në Ballkan dhe në Afganistan është shembull i operacioneve të administrimit të krizave të kësaj kategorie.

Në një krizë që merr trajtën e plotë dhe që shtron kërkesën për operacione të mundshme kundërvepruese, procesi i administrimit të krizës kalon nëpër pesë faza të njëpasnjëshme që mund të renditen nga shenjat fillestare paralajmëruese të afrimit të krizës, vlerësimi i situatës dhe i ndërlikimeve reale e të mundshme për sigurinë e Aleancës, shqyrtimi i zgjedhjeve të përgjigjeve të rekomanduara, planëzimi dhe zbatimi i vendimeve të Këshillit.

Përmasa e planëzimit të mbrojtjes është baza për të gjitha operacionet ushtarake dhe administrimin e krizave në kuadrin e NATO-s. Gjatë procesit të planëzimit merren parasysh shumë faktorë, duke përfshirë ndryshueshmërinë e rrethanave politike, vlerësimet e komandantëve ushtarakë strategjikë të NATO-s lidhur me forcat që kërkohen për plotësimin e detyrave të tyre, zhvillimet teknologjike, rëndësinë e një ndarjeje të drejtë të roleve, sfidave dhe përgjegjësive brenda Aleancës dhe aftësitë ekonomike e financiare të çdo vendi anëtar.

Roli i planëzimit të mbrojtjes është sigurimi i një kuadri që lejon harmonizimin në mënyrë sa më të frytshme të përgatitjeve të planëzimit të mbrojtjes kombëtare e shumëkombëshe për t'iu përgjigjur kërkesave të miratuara të Aleancës. Qëllimi është që të sigurohet efektshmëria e forcave

dhe e aftësive kombëtare të kërkuara, për të gjitha llojet e misionëve të Aleancës, nëpërmjet përcaktimit të objektivave dhe vlerësimit të shkallës së plotësimit të tyre.

Vendet anëtare në NATO ndajnë sipas zërave fondet e nevojshme që mundësojnë funksionimin e përditshëm të saj. Pjesa më e madhe e burimeve janë të karakterit kombëtar. Planifikimi i burimeve të NATO-s synon t'i sigurojë Aleancës aftësitë e nevojshme. Kjo nënkupton që anëtarët bashkojnë fondet brenda një kuadri të NATO-s.

Struktura e fondeve të përbashkëta është e shumëllojshme dhe e shpërqendruar. Në disa veprimtari që lidhen me kërkimin shkencor, zhvillimin, prodhimin dhe sigurimin logjistik, nuk përfshihen të gjithë. Madje, në disa raste, mund të marrin pjesë vetëm një numër i vogël vendesh anëtare.

Kriteret për sigurimin e fondeve të përbashkëta mbahen nën një mbikëqyrje të vazhdueshme. Parimi i fondeve të përbashkëta mbi bazën e konsensusit mbetet thelbësor në punët e Aleancës. Në organizmat e fondeve të përbashkëta hyjnë kryesisht Buxhetet Civile dhe Ushtarake të NATO-s, si dhe Programi i Investimit për Sigurinë e NATO-s. Këto janë të vetmet fonde ku autoritetet e NATO-s vlerësojnë kërkesat dhe përcaktojnë përparësitë në përputhje me objektivat gjithëpërfshirëse të Aleancës.

Drejtimi financiar brenda NATO-s është organizuar në mënyrë të tillë që të sigurojë të drejtën e vendeve anëtare për të ushtruar kontrollin përfundimtar mbi shpenzimet e tyre. Një Komision i pavarur i Revizorëve Ndërkombëtarë për NATO-n përgjigjet për kontrollin e llogarive të organizmave të ndryshme të NATO-s. Detyra kryesore e Komisionit është të sigurojë Këshillin e Atlantikut të Veriut dhe qeveritë e vendeve anëtare në lidhje me përdorimin e drejtë të fondeve të përbashkëta për pagesat e shpenzimeve të autorizuara.

Strategjia bërthamore e NATO-s dhe gjendja e forcave janë elemente të pashkëputura në strategjinë e përgjithshme të Aleancës për parandalimin e luftës. Drejtimi politik për politikat që kushtëzojnë pozitën bërthamore të NATO-s kryhet në mënyrë të përbashkët nga vendet anëtare. Grupi i Planëzimit Bërthamor të NATO-s përbën një forum në të

cilin ministrat e Mbrojtjes të vendeve aleate bërthamore dhe jo bërthamore (përveç Francës që nuk përfaqësohet) marrin pjesë në përpunimin e politikës bërthamore të NATO-s dhe në vendimet e saj për gjendjen bërthamore.

Në fushën ekonomike, puna e NATO-s është përqendruar në çështje të veçanta ekonomike që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen. Komiteti Ekonomik i NATO-s është i vetmi forum i Aleancës, që praktikon posaçërisht këshillimet mbi zhvillimet ekonomike me ndikim të drejtpërdrejtë në politikën e sigurisë.

Në **Pjesën III “STRUKTURAT CIVILE DHE USHTARAKE TË NATO-s”**, janë shpjeguar strukturat civile dhe ushtarake, agjencitë e ngritura për të siguruar zbatimin e detyrave dhe tiparet dalluese të komiteteve dhe organeve politike kryesore të NATO-s.

Selia e NATO-s në Bruksel është qendra kryesore politike e Aleancës. Është rezidenca e delegacioneve kombëtare të vendeve anëtare dhe e zyrave ndërlidhëse ose e misioneve diplomatike të vendeve partnere. Puna e këtyre delegacioneve dhe misioneve mbështetet nga Shtabi Ndërkombëtar dhe Shtabi Ushtarak Ndërkombëtar.

Shtabi Ndërkombëtar është një organizëm administrativ e këshillues që mbështet punën e delegacioneve kombëtare në nivele komitetesh të ndryshme. Ai përbëhet nga një personel prej vendeve anëtare, të punësuar drejtpërdrejt nga Aleanca, ose të emëruar nga qeveritë e tyre, me një afat qëndrimi të përcaktuar.

Përbërësit ushtarakë të Organizatës janë: Komiteti Ushtarak, dy Komandantët Strategjikë dhe struktura e komandimit ushtarak. Komiteti Ushtarak është autoriteti më i lartë ushtarak në NATO, nën autoritetin politik të përgjithshëm të Këshillit të Atlantikut të Veriut, Komitetit të Planëzimit të Mbrojtjes ose Grupit të Planëzimit Bërthamor. Komiteti Ushtarak përgjigjet për mbikëqyrjen e zhvillimit të politikës dhe doktrinës ushtarake të NATO-s dhe për sigurimin e udhëzimeve kryesore për Komandantët Strategjikë të NATO-s. Në veprimtaritë e veta, Komiteti Ushtarak mbështetet nga Shtabi Ushtarak Ndërkombëtar.

Për shkak të ndryshimit të mjedisit të sigurisë, udhëheqësit e Aleancës po e rishqyrtojnë vazhdimisht strukturën e organizimit të Shtabit Ndërkombëtar dhe të Komandës Ushtarake të NATO-s, me qëllim që të pasqyrojnë misionet dhe përparësitë e reja të Aleancës. Për këtë arsye, në Manualin e NATO-s jepen më tepër sqarime për funksionet që duhen plotësuar sesa përshkrime të hollësishme për përgjegjësitë e degëve të strukturave të ndryshme dhe zyrave të pavarura, në përbërje të tyre. Tabela organizimi dhe shpjegime më të freskëta mund të gjenden në faqen e internetit të NATO-s (www.nato.int), së bashku me versione të ripërtërira të strukturës së Shtabit Ndërkombëtar, Shtabit Ushtarak Ndërkombëtar dhe të strukturave të komandave ushtarake.

NATO nuk ka forca operative të vetat përveç atyre që caktohen për të nga vendet anëtare, të shoqëruara me strukturat e tyre komanduese e drejtuese, ose atyre që ofrohen për ndihmë nga vendet partnere për kryerjen e misioneve të veçanta. Prandaj, kur Këshilli i Atlantikut të Veriut vendos për fillimin e një operacioni, forcat duhet të sigurohen nga vendet anëtare nëpërmjet një procesi të përtëritjes së forcave. Këtu mund të përfshihen edhe forcat e vendeve jo anëtare të NATO-s. Pasi përfundojnë misionin e tyre, këto forca rikthehen përsëri në strukturat ushtarake të vendeve të tyre.

Ndryshimet në Strukturën e Forcave të NATO-s, të paraqitura gjatë viteve të fundit, kanë synuar për forca më të vogla e më të manovrueshme që mund të përdoren në mënyrë të zhdërvjellët për detyra të shumta ushtarake, në krahasim me forcat masive të armatosura rëndë, të përqendruara në vendndodhjet e tyre të përhershme të pandryshueshme, që karakterizonin strukturën e forcave të Luftës së Ftohtë. Ndërsa këto të fundit ishin të pajisura e të stërvitura për operacione mbrojtëse të mëdha kundër një ushtrie pushtuese, pjesa më e madhe e forcave që përbëjnë strukturën e forcave të sotme të NATO-s janë të paracaktuara për të lëvizur me shpejtësi në rajonin e krizës ose të konfliktit ku mund të kërkohet dhe për të qenë të afta për plotësimin e detyrave larg vendbazimeve të tyre.

Struktura e komandës është parashikuar për të përballuar vështirësitë, rreziqet dhe kërcënimet e mundshme me të cilat

mund të ndeshet Aleanca. Në qendër të saj janë dy komandat strategjike. Komanda e Forcave Aleate për Operacionet, në Mons, Belgjikë, është e përqendruar në planëzimin dhe zbatimin e të gjitha operacioneve që Këshilli i Atlantikut të Veriut miraton për t'u ndërmarrë. Komanda e dytë e nivelit strategjik, e njohur si Komanda e Forcave Aleate për Transformimin, me vendbazim në Shtetet e Bashkuara, merret me transformimin e aftësive ushtarake të NATO-s, në përshtatje të rrethanave të ndryshuara. Në vende të ndryshme, anëtare të NATO-s, janë vendosur edhe disa shtabe ushtarake vartëse dhe përbërës të tjerë të strukturës së komandës.

Struktura e komandimit dhe e drejtimit funksionon në tre nivele: strategjik, operativ dhe taktik. Në nivelin strategjik, Forcat Gjitharmëshe Aleate përdoren brenda kuadrit politiko-ushtarak të hartuar nga Komiteti Ushtarak dhe të miratuar nga Këshilli i Atlantikut të Veriut me qëllim që të plotësojnë objektivat strategjike të Aleancës. Në nivel operativ, planëzimi dhe drejtimi i operacioneve, që bazohet në udhëzimet ushtarake strategjike, është në duart e komandantit të nivelit operativ të caktuar. Ai ushtron përgjegjësitë e tij nëpërmjet një shtabi operativ gjitharmësh, të përhershëm ose të lëvizshëm. Në nivelin e Komandës Taktike, një numër shtabesh të Komandës Taktike, sigurojnë ekspertizë për lloje të veçanta të armëve dhe shërbimeve në nivel operativ për komandantët e Forcave Gjitharmëshe, si dhe këshilla për planëzimin operativ gjitharmësh dhe zbatimin e tij.

Sikurse Shtabi Ndërkombëtar, që është agjencia zbatuese që mbështet Këshillin dhe komitetet e tij, edhe Shtabi Ushtarak Ndërkombëtar, nën autoritetin e Drejtorit të tij, është agjenci zbatuese që mbështet Komitetin Ushtarak. Ai realizon lidhjen thelbësore midis organeve politike vendimmarrëse të Aleancës dhe Komandave Strategjike dhe mban ndërlidhje të ngushtë bashkëpunimi me Shtabin Ndërkombëtar civil.

Krahas punës në mbështetje të Komitetit Ushtarak për përgatitjen dhe ndjekjen e vendimeve të tij, Shtabi Ushtarak Ndërkombëtar është i përfshirë gjerësisht në procesin e bashkëpunimit në kuadrin e Partneritetit për Paqe (PpP). Që prej vitit 1994 ishin hapur një numër zyrash ndërlidhëse të

vendeve partnere dhe, nga viti 1997, misionet diplomatike të përhershme në Shtabin e NATO-s. Lidhjet ushtarake me vendet partnere janë forcuar më tej nëpërmjet disa Elementeve Shtabi të PpP-së, me përbërje të oficerëve prej vendeve të NATO-s dhe vendeve partnere. Ata janë të vendosur brenda Shtabit të NATO-s dhe brenda strukturës së integruar ushtarake të NATO-s. Oficerët e vendeve partnere që caktohen në këto poste punojnë përkrah oficerëve të vendeve të NATO-s në funksione ndërkombëtare.

Përveç zyrave politike dhe strukturave të komandave ushtarake, Aleanca ka edhe një numër agjencish të specializuara, të vendosura në vende të ndryshme anëtare të NATO-s. Agjencitë kanë më tepër përgjegjësi për fushat teknike, duke përplotësuar e duke qenë një pjesë përbërëse e veprimtarisë së përgjithshme të punës së Aleancës. Ato sigurojnë këshillim dhe ndërmarrin punë kërkimore shkencore, mbështesin zbatimin e vendimeve të Aleancës, sigurojnë ndërlidhjen dhe shërbimet e sistemeve të informacionit dhe drejtojnë programet e bashkëpunimit.

Forumet kryesore për këshillimin dhe vendimmarrjen e Aleancës mbështeten nga një strukturë komiteti që i siguron secilit vend anëtar përfaqësimin në çdo nivel për të gjitha fushat e veprimtarisë së NATO-s në të cilat merr pjesë. Disa nga komitetet e kanë zanafillën e krijimit që në fillimet e veprimtarisë së NATO-s. Të tjerë janë formuar më vonë, në kuadrin e përshtatjes së brendshme dhe të jashtme të Aleancës, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Në pjesën më të madhe të komiteteve marrin pjesë rregullisht edhe përfaqësues të vendeve partnere.

Në Pjesën IV “ROLI ALEANCËS NË OPERACIONET PAQUERUAJTËSE DHE PAQEMBËSHTETËSE” shqyrtohen detyrat operative të NATO-s në lidhje me paqeruajtjen dhe paqembështetjen dhe zbatimi i vendimeve të Aleancës lidhur me Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë*, Afganistanin, Misionin Stërvitor të NATO-s në Irak dhe misionin në Darfur të Sudanit.

Që prej përfundimit të Luftës së Ftohtë, Aleanca është përfshirë gjithnjë e më shumë në operacionet paqeruajtëse dhe paqembështetëse, duke dërguar trupat e saj në mbështetje të interesave më të gjera të bashkësisë ndërkombëtare. Tre operacionet e para paqembështetëse të NATO-s, u zhvilluan në Evropë. Baza politike për rolin e Aleancës në operacionet paqeruajtëse u vendos në një mbledhje të ministrave të Jashtëm të NATO-s në Oslo, në qershor 1992. Ndërmjet viteve 1992 dhe 1995, Aleanca mori disa vendime të rëndësishme, që çuan në operacione për vëzhgimin dhe, në vijim, për detyrimin e zbatimit të një embargoje dhe sanksioneve të Kombeve të Bashkuara (KB) në Adriatik dhe të ndërprerjes së kalimeve ajrore mbi Bosnjë dhe Hercegovinë.

Më 30 gusht 1995, aeroplanët e NATO-s kryen një varg goditjesh kundër objektivave të përzgjedhur në pozicionet e mbajtura nga serbët në Bosnjë dhe Hercegovinë. Kjo shënoi fillimin e Operacionit të Forcës së Paramenduar, fushata e parë ajrore e NATO-s, që zgjati deri më 15 shtator. Operacioni përgatiti terrenin për bisedimet për paqe. Sipas kushteve të Marrëveshjes Bazë të Përgjithshme për Paqe, zakonisht e përmendur si Marrëveshja e Paqes së Dejtonit, për të mbikëqyrur zbatimin e aspekteve ushtarake të marrëveshjes, u krijua një Forcë Zbatuese (IFOR – Implementation Force) e drejtuar nga Aleanca, me 60 000 trupa dhe me një afat qëndrimi njëvjeçar. IFOR-i dha një ndihmesë të ndjeshme për krijimin e një mjedisi të sigurt për rindërtimin civil dhe politik. Më 20 dhjetor 1996 nisi veprimtarinë një Forcë Stabilizuese (SFOR – Stabilisation Force) prej 32 000 trupash, që u bë pasardhëse e IFOR-it, detyra kryesore e së cilës ishte të ndihmonte në zhvillimin e një mjedisi të sigurt, mjaft të nevojshëm për përforcimin e paqes.

Më 2 dhjetor 2004, Bashkimi Evropian (BE) rigrupoi një forcë të re në Bosnjë dhe Hercegovinë, EUFOR-in, duke shfrytëzuar ekspertizën e planëzimit të NATO-s dhe duke

SHËNIM: Referimet e dhëna për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë janë paraqitur me një yllth (*) që lidhet me shënimin pasues: “Turqia e njeh Republikën e Maqedonisë me emrin e vet kushtetues”.

hapur rrugën për përdorimin e mjeteve dhe aftësive të përbashkëta të Aleancës nga BE.

Që prej qeshorit 1999, Aleanca ka drejtuar një operacion paqeruajtës në Kosovë, në mbështetje të përpjekjeve të gjithanshme ndërkombëtare për vendosjen e paqes dhe të stabilitetit. Forca e Kosovës (KFOR – Kosovo Force) u përqendrua menjëherë pas fushatës ajrore 78-ditore të nisur nga Aleanca në maj 1999, për të ndaluar dhe për t'i dhënë fund fatkeqësisë njerëzore që ishte zgjeruar në atë kohë. Ajo fushatë, që ishte e dyta për NATO-n, u krye pas një periudhe mbi njëvjeçare luftimesh në krahinë dhe pas dështimit të përpjekjeve ndërkombëtare për zgjidhjen e konfliktit me mjete diplomatike.

Në 13 tetor 1998, Këshilli i Atlantikut të Veriut autorizoi urdhrat për fillimin e veprimeve luftarake, për goditjet ajrore të NATO-s, në mbështetje të përpjekjeve diplomatike për ta detyruar regjimin e Millosheviqit që të tërhiqte trupat nga Kosova, të bashkëpunonte për dhënien fund të dhunës dhe të lehtësonte kthimin e të shpërngulurve në shtëpitë e tyre. Në vijim të nismave të mëtejshme diplomatike, Presidenti Millosheviq pranoi të bindet dhe goditjet ajrore u pezulluan.

Situata në Kosovë u përkeqësua përsëri në fillim të vitit 1999, pas një vargu veprimesh provokuese nga të dyja palët dhe përdorimit të dhunës së tepruar nga ushtria dhe policia serbe. Kjo përfshiu masakrën e 40 civilëve të paarmatosur, në fshatin Raçak, më 15 janar. Përpjekjet e ripërsëritura ndërkombëtare për t'i dhënë një shtysë të re politike gjetjes së një zgjidhjeje paqësore të konfliktit, përfunduan në mbledhje bisedimesh, në Londër dhe në Paris. Por këto bisedime dështuan dhe, në mars 1999, forcat ushtarake dhe policore serbe e rritën fuqinë e operacioneve të tyre, në kundërshtim të hapur me marrëveshjet e arritura. Më 24 mars 1999, pasi ishin përdorur të gjitha rrugët diplomatike, Aleanca filloi fushatën ajrore kundër regjimit të Millosheviqit.

Objektivat politikë të NATO-s ishin ndalimi i verifikueshëm i dhunës, shtypjes dhe i të gjitha veprimeve ushtarake; tërheqja nga Kosova e personelit ushtarak, forcave

policore dhe paramilitariste; vendosja në Kosovë e një pranije ushtarake ndërkombëtare; kthimi i sigurt dhe pa kushte i të gjithë refugjatëve dhe njerëzve të zhvendosur dhe hyrja e papenguar e organizatave të ndihmës humanitare dhe krijimi i një marrëveshjeje politike për Kosovën, në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe Kartën e KB-së.

Pas përpjekjeve diplomatike të Rosisë dhe BE-së të 3 qershorit, u arrit që më 9 qershor të përfundonte një Marrëveshje Teknike Ushtarake midis NATO-s dhe Republikës Federale të Jugosllavisë. Më 10 qershor, nëpërmjet Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së, u mirëprit pranimi nga Republika Federale e Jugosllavisë i parimeve për një zgjidhje politike.

Më 12 qershor 1999 hynë në Kosovë forcat e para të KFOR-it. Më 20 qershor përfundoi tërheqja e plotë e forcave serbe. Detyrat e KFOR-it përfshinin ndihmën për kthimin ose rivendosjen e personave të zhvendosur dhe refugjatëve, rindërtimin dhe çminimin, ndihmën mjekësore, sigurinë dhe rendin publik, mbrojtjen e pakicave etnike, ruajtjen e objekteve fetare, sigurimin e kufirit, ndalimin e kontrabandës së armëve në kufi, zbatimin e një programi të gjerë amnistie për armët, municionet dhe lëndët plasëse për të gjithë Kosovën, shkatërrimin e armëve dhe mbështetjen për ngritjen e institucioneve civile, ligjit dhe rregullit, sistemit gjyqësor dhe atij penal, procesit zgjedhor dhe aspekteve të tjera të jetës politike, ekonomike dhe shoqërore të krahinës.

KFOR-i përbëhej fillimisht nga një personel prej 50000 vetash, nga vendet anëtare të NATO-s, vendet partnere dhe vendet që nuk bëjnë pjesë në NATO, nën një komandë dhe drejtim të njësuar. Nga fillimi i vitit 2002, KFOR-i u zvogëlua në rreth 39000 trupa. Përmirësimet në mjedisin e sigurisë mundësuan NATO-n që të pakësonte nivelet e trupave të KFOR-it në rreth 26000 nga qershori i 2003-it dhe në 17500 nga fundi i atij viti. Në mars të vitit 2004, u vërejt një kthim pas në përparimin drejt një Kosove të qëndrueshme, shumetnike dhe demokratike, kur dhuna e ringjallur shpërtheu midis shqiptarëve dhe serbëve, duke përfunduar me sulmin ndaj forcave të KFOR-it. Kjo solli zbatimin e planeve të

NATO-s për situata të jashtëzakonshme, duke përfunduar fuqinë ekzistuese të KFOR-it me dërgimin e menjëhershëm të rreth 2500 trupave të tjera plotësuese.

Në pritje të zgjidhjes së statusit të Kosovës nuk ka gjasa që Aleanca të ndër marrë shkurtime të mëtejshme të forcave të KFOR-it. Në Takimin e Stambollit, kryetarët e shteteve dhe qeverive të NATO-s dënuan ringjalljen e dhunës etnike që ndodhi në mars 2004 dhe ripohuan zotimin e NATO-s për një Kosovë të sigurt, të qëndrueshme dhe shumetnike, bazuar në zbatimin e plotë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së.

Si pasojë e konfliktit në Kosovë, vendet e rajonit u përballën me probleme të mëdha humanitare, politike dhe ekonomike. Në pikën kulmore të krizës së Kosovës, mbi 230000 refugjatë mbërritën në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë*, mbi 430000 në Shqipëri dhe rreth 64000 në Malin e Zi. Afërsisht 21500 shkuan në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe mbi 61000 u larguan në vende të tjera. Brenda në Kosovë, rreth 580000 njerëz mbetën të pastrehë. Për të ndihmuar në lehtësimin e gjendjes humanitare në vend, forcat e NATO-s dërguan nëpërmjet ajrit me mijëra tonë ushqime dhe pajisje. Deri në fund të majit 1999, në rajon u transportuan mbi 4666 tonë ushqime dhe ujë, 4325 tonë mallra të tjera, 2624 tonë tenda si dhe afërsisht 1600 tonë furnizime mjekësore.

Në Shqipëri, Aleanca dërgoi forca të mjaftueshme për të siguruar forma të ngjashme ndihme dhe mbështeti Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, nëpërmjet bashkërendimit të transportimit ajror të ndihmave humanitare dhe për të mundësuar dërgimin e refugjatëve në vende të tjera të sigurta, duke përfshirë dhe shumë vende të NATO-s.

Prej vitit 1998 deri në dhjetor 2002, një Celulë e PpP-së të NATO-s ka funksionuar në Tiranë për të ndihmuar qeverinë për programet dhe procedurat e PpP-së. Në qershor 2002, Aleanca emëroi një Përfaqësues të Lartë Ushtarak në Shqipëri, me shtabin në Tiranë. Roli i tij është të këshillojë Tiranën mbi aspektet ushtarake të reformës në fushën e sigurisë, duke përfshirë ristrukturimin e forcave të armatosura shqiptare dhe

mbi aspektet ushtarake të Planit të Veprimit për Anëtarësim dhe të Procesit të Planëzimit e Rishikimit të PpP-së, në të cilat Shqipëria është pjesëmarrëse. Shtabi i NATO-s në Tiranë përfshin një Ekip Këshillimor të NATO-s, i cili ndihmon Përfaqësuesin e Lartë Ushtarak në zbatimin e këtyre detyrave. Një detyrë tjetër, që i ishte caktuar Shtabit të NATO-s në Tiranë, ka qenë sigurimi i mbështetjes për operacionet e drejtuara nga Aleanca në rajon. Një ndihmesë e rëndësishme për operacionet e NATO-s, është dhënë nga vetë Shqipëria, nëpërmjet lejimit mbi territorin e saj të fluturimeve me karakter vrojtimi e zbulimi, si dhe në bashkëpunimin midis policisë kufitare shqiptare dhe njërive ushtarake të KFOR-it për çështjet e sigurimit të kufijve.

Me kërkesën e autoriteteve të Shkupit, Aleanca u përfshi në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë* për të ndihmuar në sheshimin e konfliktit që po rritej midis qeverisë dhe kryengritësve etnikë shqiptarë. Kjo bëhej me synimin që të parandalohet ajo gjendje që mund të shndërrohej në luftë të një shkalle të gjerë.

Aleanca ka drejtuar përpjekjet paqeruajtëse ndërkombëtare në Afganistan që nga gushti 2003, duke ndihmuar për krijimin e kushteve në të cilat vendi të mund të gëzonte një qeveri përfaqësuese dhe paqe e siguri të qëndrueshme. Ky operacion i ri në llojin e vet, është i pari për NATO-n përtej zonës evropatlantike. Fillimisht, e kufizuar në ruajtjen e sigurisë në Kabul dhe rrethinat e tij, Aleanca tashmë është duke e zgjeruar misionin për të përfshirë edhe zona të tjera të vendit, nëpërmjet të ashtuquajturave Ekipe të Rindërtimit Krahinor. Në mënyrë të veçantë, ajo synon të përkrahë qeverinë e Afganistanit në ruajtjen e sigurisë brenda zonës së saj të operacioneve, të mbështesë qeverinë në shtrirjen e autoritetit të saj në të gjithë vendin dhe të ndihmojë në sigurimin e një mjedisi të qetë e të sigurt, por edhe të përshtatshëm për zgjedhje të lira e të ndershme, si dhe në vendosjen e rendit ligjor dhe në procesin e rindërtimit.

Që prej përfundimit të fushatës së vitit 2003 të drejtuar nga Shtetet e Bashkuara në Irak dhe rrëzimit të regjimit të Sadam Huseinit, Aleanca është përfshirë në mënyra të

ndryshme në dhënien e ndihmës gjatë tranzicionit në Irak. Ajo po përgatit personelin iraken si brenda dhe jashtë Irakut dhe po mbështet zhvillimin e institucioneve të sigurisë për të ndihmuar në ngritjen e forcave të armatosura, të afta për ruajtjen e sigurisë në vend.

Që në korrik 2005, së bashku me BE-në, Aleanca ka ndihmuar Bashkimin Afrikan në përhapjen e misionit të tij paqeruajtës në Darfur, Sudan, me qëllim që të ndalej vazhdimi i dhunës. Aleanca ka kryer transportimin ajror të paqeruajtësve dhe të policëve civilë të Bashkimit Afrikan për në rajonin e rrënuar nga lufta dhe ka siguruar stërvitje për drejtimin e shtabit ushtarak shumëkombësh dhe atë të zbulimit.

Në Pjesën V “LUFTA KUNDËR KËRCËNIMEVE TË REJA DHE ZHVILLIMI I AFTËSIVE TË REJA” trajtohen masat e ndërmarra prej NATO-s për të luftuar rrezikun nga terrorizmi dhe përhapja e armëve të dëmtimit në masë dhe përshkruhen aftësitë e reja që janë në zhvillim e sipër.

Goditjet terroriste të 11 Shtatorit 2001 mbi Nju-Jork dhe Uashington, shtynë jo vetëm Shtetet e Bashkuara, por të gjithë Aleancën në luftën kundër terrorizmit. Në më pak se 24 orë pas goditjeve, Aleanca iu drejtua Nenit 5, pikës së mbrojtjes së përbashkët të traktatit të saj themelues. Ndërlikimet praktike të këtij vendimi ishin të pashembullta sepse ishte hera e parë që Aleanca përhapte forcat dhe mjetet e tjera në mbështetje të një operacioni sipas Nenit 5. Ajo paraqiti një varg nismash politike dhe masash praktike në disa fusha të ndryshme për të ndihmuar në luftën kundër terrorizmit. Ajo përshtati një Koncept Ushtarak për Mbrojtjen kundër Terrorizmit, fuqizoi bashkëpunimin me vendet partnere nëpërmjet miratimit të Planit të Veprimit të Partneritetit kundër Terrorizmit dhe parashtrroi masat kundër përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

Aleanca po zbaton një sërë masash për përmirësimin e aftësive ushtarake të vendeve anëtare të saj. Me synimin për të siguruar përmbushjen e zotimeve operative të sotme e të ardhme dhe për të luftuar kërcënimet e reja, këto përpjekje

shërbejnë si bazë për të krijuar një kuadër të plotë masash të marra që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë për përshtatjen e Aleancës ndaj sfidave të reja. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, sepse tashmë ajo merr përsipër misione të reja në vende të largëta jashtë zonës së saj, të cilat kërkojnë forca të pajisura dhe të përgatitura mjaft mirë për vetë misionet tepër të vështira që u takojnë për të zbatuar. Me qëllim që të hapej rruga për përmirësimin e aftësive, Aleanca paraqiti tri nisma themelore në fusha të tilla tepër të rëndësishme, si: transportimi strategjik dhe vrojtimi ajër-tokë, përmirësimi i strukturës së komandës ushtarake dhe krijimi i Forcës Kundërvepruese të NATO-s.

Në **Pjesën VI** është trajtuar një aspekt i përcaktuar si mjaft i rëndësishëm në kuadrin e strategjisë së NATO-s pas fundit të Luftës së Ftohtë, siç është **“HAPJA E ALEANCËS NDAJ VENDEVE TË REJA PËR ANËTARËSIM”**. Klauzola për zgjerimin e NATO-s është përfshirë në Nenin 10 të Traktatit të Atlantikut të Veriut. Ndërkohë që katër vende u futën në Aleancë gjatë periudhës 1949 deri në fillimet e viteve 1980 (Turqia dhe Greqia më 1952, Gjermania më 1955, Spanja më 1982), pranimi i vendeve të reja, që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë, ka qenë nga më të bujshmit për sa i përket shifrave dhe ndikimit politik.

Rrënjët e ndryshimit që transformuan hartën politike të Evropës, në fund të viteve 1980, mund të dallohen në një varg zhvillimesh gjatë periudhës së viteve 1960-1970. Tri ngjarje shquhen në veçanti: përshtatja nga Aleanca, në dhjetor 1967, e doktrinës Harmel, bazuar në politikat paralele të sigurimit të një mbrojtjeje të mjaftueshme, ndërkohë që kërkohej të punohej për zgjidhjen e problemeve politike themelore që ndanin Evropën; paraqitja më 1969, nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, e *Ostpolitikës* së Vilibrandit, që synonte një frymë më të mirë në marrëdhëniet me vendet e Evropës Lindore dhe me Bashkimin Sovjetik brenda kufizimeve shtrënguese të politikave të qeverive të tyre dhe përshtatja e Aktit Final të Helsinkit në gusht 1975, i cili hodhi themelet e standardeve dhe kodeve të reja të drejtimit në lidhje me çështjet

e të drejtave të njeriut dhe që parashtroi masat për rritjen e besimit të ndërsjellë midis Lindjes dhe Perëndimit.

Një varg ngjarjesh me rëndësi të përafërt përcaktuan ecurinë e marrëdhënieve Lindje-Perëndim në vitet '80. Këto përfshinin bazimin e forcave bërthamore me rreze veprimi të ndërmjetme të NATO-s në Evropë; Traktatin e Uashingtonit, i nënshkruar në dhjetor 1987, i cili solli mënjanimin në shkallë botërore të raketave tokësore amerikane dhe sovjetike me rreze veprimi të ndërmjetme; shenjat e hershme të ndryshimit në Evropën Lindore, të shoqëruara me shfaqjen e lëvizjes sindikaliste të pavarur "Solidariteti" në Poloni; tërheqja e forcave sovjetike nga Afganistani dhe, së fundi, emërimi në mars 1985 i Mihail Gorbaçovit si Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste Sovjetike dhe lëvizjet e tij të guximshme drejt *perestrojkës* (reformimit) dhe *glasnostit* (hapjes).

Premtimi i shpallur mbi 40 vite më parë, për t'i dhënë fund ndarjes së Evropës dhe, bashkë me të, ndarjes së Gjermanisë, njohu një kuptim të vërtetë me rënien e Murit të Berlinit në nëntor 1989. Veç simbolikës së vet të jashtëzakonshme, ai hapi rrugën për një përparim të beftë dhe të shpejtë të pjesës më të madhe të vendeve të Evropës Lindore. Brenda më pak se një viti, më 3 tetor 1990, ndodhi bashkimi i dy shteteve gjermane. Brenda vetëm pak vitesh, një numër vendesh të Evropës Lindore dhe Qendrore kishin përcaktuar anëtarësimin në NATO si një prej synimeve kryesore të politikës së tyre të jashtme.

Në Takimin e Londrës të qershorit 1990, Aleanca i zgjati dorën e miqësisë kundërshtarëve të saj të mëparshëm dhe filloi me ta një proces dialogu dhe bashkëpunimi. Në Takimin e Brukselit të janarit 1994, udhëheqësit e NATO-s deklaruan se Aleanca ishte e hapur për anëtarësimin e shteteve të tjera evropiane që do të ishin në gjendje të ndihmonin në sigurinë e zonës së Atlantikut të Veriut.

Në përshtatje me rrethanat, më 1995, Aleanca ndërmori një Studim mbi Zgjerimin e NATO-s për të shqyrtuar "pse-të dhe si-të" e pranimeve të ardhshme në Aleancë. Studimi përmbylej me idenë se, me përfundimin e Luftës së Ftohtë, kishte lindur njëherësh edhe nevoja, edhe rasti i veçantë për

të ndërtuar një sistem sigurie të përmirësuar në të gjithë zonën evro-atlantike, pa krijuar vija të reja ndarëse.

Për të shqyrtuar edhe më thellë çështjet që ishin ngritur në Studimin mbi Zgjerimin e NATO-s, Aleanca vendosi të drejtonte “Dialogët intensivë” me secilin nga vendet që kishte deklaruar interesin e vet për të hyrë në Aleancë. Dialogët intensivë nisën që në fillim të vitit 1997 me Republikën e Çekisë, Hungarinë dhe Poloninë dhe vazhduan gjatë një periudhe përgatitore deri më 1999, kur u krye zgjerimi i parë i NATO-s, pas Luftës së Ftohtë.

Në Takimin e Uashingtonit, në prill 1999, Aleanca paraqiti Planin e Veprimit për Anëtarësim (PVA) për të ndihmuar përgatitjet e atyre vendeve që dëshironin të hynin në Aleancë. Në fillim të çdo cikli të PVA-së, vendet mëtuese paraqesin një program kombëtar njëvjeçar mbi përgatitjet për anëtarësimin e ardhshëm. Në të përfshihen çështjet politike, ekonomike, të mbrojtjes, të karakterit ushtarak, të burimeve, të sigurisë dhe të aspektit ligjor. Ata fiksojnë qëllimet, objektivat dhe afatet e punëve të tyre dhe i ripërtërijnë ato çdo vit. Në fund të ciklit, Aleanca harton raportet e përparimit veçmas për secilin vend që merr pjesë në PVA. Këto përgatisin truallin për zhvillimin e diskutimit midis Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe vendit të interesuar rreth përparimit të shënuar.

Fillimisht, në PVA aderuan nëntë vende dhe pikërisht, Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*, Rumania, Sllovakia, Sllovenia dhe Shqipëria. Kroacia hyri më 2001. Shtatë prej këtyre vendeve - Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia - u ftuan më pas në Takimin e Pragës, në nëntor 2002, për të filluar bisedimet e hyrjes dhe zyrtarisht u futën në NATO në mars 2004. Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë* dhe Shqipëria, vazhdojnë të punojnë pranë e pranë me Aleancën në kuadrin e PVA-së me pikësynimin për të plotësuar kriteret që do të mundësonin marrjen e ftesave të anëtarësimit për të filluar bisedimet për hyrje.

Zgjerimi NATO-s është një proces në vazhdim dhe i është përgjigjur njëherazi edhe nevojave të sigurisë së vendeve që synojnë të hyjnë në Aleancë, por edhe ka ndihmuar për rritjen e stabilitetit në të gjithë Evropën.

Një vështrim mbi zhvillimin e marrëdhënieve dhe partneritetit dypalësh e shumëpalësh me vendet jo anëtare, është dhënë në **Pjesën VII “PARTNERITETI DHE BASHKËPUNIMI”**, në të cilën shtjellohet evolucioni i Partneritetit Evro-Atlantik, mbështetur në shtyllat plotësuese të Këshillit të Partneritetit Evro-Atlantik dhe të Programit të Partneritetit për Paqe, si dhe marrëdhëniet dhe trajtat e ndryshueshme të bashkëpunimit, të zhvilluara nga Aleanca me Rusinë, Ukrainën, vendet e Dialogut Mesdhetar, të Evropës Juglindore dhe, së fundi, me vendet e Lindjes së Mesme.

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë politika e Aleancës për zhvillimin e partneritetit me një numër të madh vendesh jo anëtare, ka luajtur një rol të rëndësishëm në ndryshimin e mjedisit strategjik në zonën evro-atlantike. Nëpërmjet nxitjes së dialogut politik dhe bashkëpunimit në një varg fushash, janë zhvilluar forma të ndryshme partneriteti, që po ndihmojnë krijimin e një kulture të sigurisë evro-atlantike. Sfidat e sotme të sigurisë përmbledhin kërcënime që vijnë nga brenda e nga jashtë dhe ato të një natyre tejkombëtare. Në këtë mjedis, stabiliteti dhe siguria ndërkombëtare varen së tepërmi nga reformat e brendshme dhe nga bashkëpunimi i gjerë ndërkombëtar. Për këto arsye i takon partneritetit që të luajë një rol kryesor në të dy drejtimet.

Brenda një periudhe të shkurtër kohore, që pas rënies së murit të Berlinit, hapat e ndryshimit që u shënuan në Evropën Qendrore e Lindore, i ofruan NATO-s një tablo të re dhe krejt të ndryshme të sfidave të sigurisë nga ato që e kishin karakterizuar atë më parë. Ndryshimet politike krijuan mundësi të mëdha për forcimin e sigurisë në Evropë, por, pashmangshmërisht, sollën pasiguri të reja dhe rrezikun e cenimit të stabilitetit.

Udhëheqësit e vendeve aleate u angazhuan për këtë në mbledhjen e takimit të tyre në Londër, në qershor 1990. Ata premtuan një formë të re marrëdhënieje bashkëpunimi me të gjitha vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore. Ngjarjet u rrokullisën me shpejtësi të madhe dhe, në dhjetor 1991, për t'i dhënë një shtysë marrëdhënieve të reja, Aleanca kishte

organizuar strukturën e parë zyrtare institucionale - Këshillin e Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (KBAV) - një forum që do të bashkonte NATO-n dhe vendet e reja partnere për të diskutuar çështje me interes të përbashkët. Brenda tre viteve, përparimi i arritur u forcua më tej me ngritjen e Këshillit të Partneritetit Evro-Atlantik (KPEA), që zëvendësoi KBAV-në dhe, duke u mbështetur në arritjet e tij, u hap rruga për zhvillimin e një partneriteti më të fuqishëm e më operativ.

KPEA-ja siguron kuadrin e përgjithshëm politik për marrëdhëniet me vendet partnere. KPEA-ja bashkon gjithsej 46 vende - 26 vende anëtare dhe 20 partnere - në një forum shumëpalësh që siguron këshillime dhe bashkëbisedime të rregullta ndërmjet tyre për çështje që lidhen me politikën dhe sigurinë. Në të njëjtën kohë ai shërben si një strukturë politike për marrëdhëniet dypalëshe individuale që zhvillohen ndërmjet NATO-s dhe vendeve pjesëmarrëse në programin e PpP-së.

Nisma e Partneritetit për Paqe (PpP), e ndërmarrë nga Aleanca më 1994, përfaqëson një program madhor të bashkëpunimit praktik midis NATO-s dhe vendeve partnere. Thelbi i programit të PpP-së është partneriteti i formuar individualisht midis çdo vendi partner dhe NATO-s. Ky partneritet i është përshtatur nevojave individuale dhe zbatohet bashkërisht në përputhje me nivelin dhe hapat e përzgjedhur prej secilës qeveri pjesëmarrëse. Bazuar në bashkëpunimin praktik dhe në zotimin ndaj parimeve demokratike mbi të cilat mbështetet vetë Aleanca, PpP-ja synon nxitjen e reformës, forcimin e stabilitetit, mënjanimin e kërcënimeve ndaj paqes dhe ndërtimin e marrëdhënieve të përforuara të sigurisë, ndërmjet vendeve të veçanta partnere edhe NATO-s, si dhe ndërmjet vetë vendeve partnere.

Baza zyrtare e PpP-së është Dokumenti Themelor, i botuar nga Aleanca më 1994. Dokumenti Themelor përmban në vetvete edhe zotimin e vendeve anëtare të Aleancës për t'u këshilluar me çdo vend partner që parashih një kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj tërësisë së vet territoriale, pavarësisë politike ose sigurisë. Çdo vend partner formulon detyrat e veçanta dhe zotimet politike për mbrojtjen e shoqërive demokratike, për

ruajtjen e parimeve të ligjeve ndërkombëtare, për përmbushjen e detyrimeve të Kartës së KB-së, Deklaratës së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut, Aktit Final të Helsinkit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të kontrollit të armëve e çarmatimit, për vetëpërmbytjen në kërcënimin ose përdorimin e forcës kundër shteteve të tjera, për respektimin e kufijve ekzistues dhe për zgjidhjen e konflikteve në mënyrë paqësore. Zotime të veçanta ndërmerren edhe për rritjen e transparencës në planëzimin dhe buxhetin e mbrojtjes kombëtare, në vendosjen e kontrollit demokratik mbi forcat e armatosura dhe në zhvillimin e aftësive për veprime të përbashkëta me NATO-n në operacionet paqeruajtëse dhe në ato me karakter humanitar.

Zgjedhja e veprimtarive individuale brenda kuadrit të PpP-së varet nga dëshirat dhe aftësitë e secilit vend partner. Fushat e përzgjedhura i paraqiten Aleancës në Dokumentin e Prezantimit. Ai shërben si bazë për Programin Individual të Partneritetit, i përpunuar dhe i miratuar bashkërisht midis NATO-s dhe çdo vendi partner. Këto programe dyvjeçare zgjidhen nga një listë e madhe e veprimtarive që pasqyrojnë objektivat dhe përparësitë e Partneritetit. Bashkëveprimi përqendrohet sidomos në ndërveprimin ushtarak, në reformën ushtarake dhe në trajtimin e pasojave të kësaj reforme. Ai prek çdo fushë të veprimtarisë së NATO-s, përfshirë politikën dhe planëzimin e mbrojtjes, marrëdhëniet civilo-ushtarake, edukimin dhe stërvitjen, mbrojtjen ajrore, ndërlidhjen dhe sistemet e informacionit, çështjet e shndërrimit të mbrojtjes, administrimin e krizave dhe planëzimin e çështjeve civile në situata të jashtëzakonshme, programet e informacionit e të ndërlidhjes dhe bashkëpunimin shkencor.

Një nga mbështetjet më të rëndësishme që ka dhënë PpP-ja ka qenë përmes programeve të zhvilluara me vende të veçanta partnere për shkëmbimin e ekspertizës dhe për sigurimin e përkrahjes në trajtimin e problemeve të shumta konceptuale e praktike që shoqërojnë procesin e reformës së mbrojtjes. Për ta çuar përpara reformën e mbrojtjes, në Takimin e Stambollit, në qershor 2004, u ndërmor një Plan i ri Veprimi i Partneritetit për Ngritjen e Institucionit të Mbrojtjes.

Objektivat më të rëndësishme të Planit të Veprimit synojnë zhvillimin e parapërgatitjeve të efektshme për kontrollin demokratik të veprimtarive të mbrojtjes, pjesëmarrjen e civilëve në përpunimin e politikës së mbrojtjes e të sigurisë, mbikëqyrjen e frytshme dhe të hapur me karakter ligjvënës e gjyqësor të sektorit të mbrojtjes dhe parashikimin e proceseve me anë të të cilave mund të vlerësohen si duhet rreziqet ndaj sigurisë dhe kërkesat e mbrojtjes kombëtare.

Aleanca e ka vlerësuar si përparësi zhvillimin e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit të frytshëm me Rusinë. Gjatë këtyre viteve është shënuar një përparim i ndjeshëm në shkëputjen nga antagonizmat e vjetër, të bazuar në ballafaqimin ideologjik, politik dhe ushtarak drejt një partneriteti të vazhdueshëm. Aktualisht, shtetet anëtare të NATO-s dhe Rusia mbledhen rregullisht si të barabartë në Këshillin NATO-Rusi për t'u këshilluar mbi problemet aktuale të sigurisë dhe për të zhvilluar një bashkëpunim praktik në një gamë të gjerë çështjesh me interes të përbashkët.

Marrëdhëniet e NATO-s me Ukrainën u zhvilluan në mënyrë progresive qysh se vendi fitoi pavarësinë më 1991. Duke pasur parasysh pozitën e saj strategjike, si një urë midis Evropës Lindore dhe Perëndimore, marrëdhëniet NATO-Ukrainë janë të një rëndësie të veçantë për ruajtjen e paqes dhe të stabilitetit brenda zonës evro-atlantike. **Aleanca dhe Ukraina janë përfshirë gjallërisht në operacionet paqeruajtëse ndërkombëtare dhe në përballimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë. Gjatë viteve është përvijuar dukshëm modeli i një dialogu dhe bashkëpunimi praktik në një gamë të gjerë fushash të tjera.** Një aspekt kryesor i partneritetit është mbështetja e dhënë nga Aleanca dhe vendet e tjera të veçanta anëtare për përpjekjet reformuese të Ukrainës, të cilat mbeten me rëndësi të veçantë për aspiratat e përafrimit të Ukrainës në integrimin evro-atlantik.

Aleanca po zhvillon partneritete sigurie më të ngushta me vendet në rajonin e Mesdheut dhe në Lindjen e Mesme e më gjerë. Ky është një tejkalim i përparësive të Aleancës drejt një përfshirjeje më të madhe të këtyre rajoneve të rëndësishme

strategjike të botës. Siguria dhe stabiliteti i tyre janë të lidhura ngushtë me sigurinë evro-atlantike.

Më 1994, nga Këshilli i Atlantikut të Veriut, u ndërmor nisma e Dialogut Mesdhetar të NATO-s, me qëllim që të ndihmohej në arritjen e një mirëkuptimi të ndërsjellë dhe në qartësimin e këndvështrimeve të errëta në lidhje me politikat dhe objektivat e NATO-s ndaj vendeve të Dialogut. Gjatë viteve, është rritur numri i vendeve pjesëmarrëse: Egjipti, Izraeli, Mauritania, Maroku dhe Tunizia, që hyri më 1994, e ndjekur nga Jordania më 1995 dhe Algjeria më 2000.

Në Takimin e Stambollit të qershorit 2004, Aleanca hodhi idenë e Nismës së Bashkëpunimit të Stambollit dhe ftoi vendet e interesuara në rajonin e Lindjes së Mesme e më gjerë që të merrnin pjesë në të, duke filluar me vendet anëtare të Këshillit të Bashkëpunimit të Gjirit (Bahreini, Kuvaiti, Katari, Omani, Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe). Objektivi është që të nxitet krijimi i marrëdhënieve dypalëshe me përfitim të ndërsjellë, si një mjet që do të fuqizonte sigurinë dhe stabilitetin rajonal. Përparësitë kryesore janë lufta kundër terrorizmit dhe kundërveprimi ndaj përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

Konflikti dhe mungesa e stabilitetit në Ballkan në vitet 1990, mbartte në vetvete sfida të drejtpërdrejta ndaj interesave të sigurisë së vendeve anëtare të NATO-s dhe më gjerë. Më 1999, kriza e Kosovës ishte shtysa që bashkësia ndërkombëtare të rivlerësonte zotimin e saj në rajon dhe të përshtaste një qëndrim më gjithëpërmbledhës në mbështetje të sigurisë e të stabilitetit. Kjo u shfaq në Nismën e Evropës Juglindore të NATO-s, si dhe në Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore.

Nisma e Evropës Juglindore u ndërmor në Takimin e Uashingtonit, në prill 1999. Nisma u mbështet në katër shtylla: një Forum Këshillimor për Çështjet e Sigurisë në Evropën Juglindore, një Grup i Posaçëm Pune pa afat të caktuar për Bashkëpunimin Rajonal në Evropën Juglindore nën mbikëqyrjen e KPEA-së, mjete të punës së PpP-së dhe programe të planëzuara me kujdes për bashkëpunimin në fushën e sigurisë të vendeve në rajon.

Forumi Këshillimor u mblodh fillimisht gjatë kohës që zhvillohej Takimi i Uashingtonit i NATO-s dhe ka vijuar të mblidhet në nivel ambasadorësh në Shtabin e NATO-s. Në përgjithësi, aty bashkohen vendet e NATO-s, katër vende partnere (Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*, Moldavia dhe Shqipëria), Bosnja e Hercegovina dhe Serbia e Mali i Zi, që nuk janë ende në përbërje të KPEA-së ose të PpP-së.

Për bashkërendimin e projekteve rajonale u krijua Grupi Drejtues i Bashkëpunimit për Sigurinë e Evropës Juglindore, i cili mblidhet rregullisht në Shtabin e NATO-s në Bruksel dhe është përqendruar, gjithnjë e më shumë, në fuqizimin e rolit të vendeve pjesëmarrëse në projektet rajonale dhe për zbatimin e një Plani Veprimi të përvitshëm. Projektet përfshijnë një studim krahasues të strategjive mbrojtëse kombëtare të vendeve të rajonit, shkëmbimin e informacionit në lidhje me çështje politiko-ushtarake e të tjera, të paralajmërimit të hershëm, të parandalimit të konflikteve dhe të administrimit të krizave, punën për zvogëlimin e përhapjes dhe përmirësimin e kontrollit të armëve të vogla dhe armatimeve të lehta, drejtimin dhe sigurimin e kufijve, mbështetjen e reformave të mbrojtjes, përmirësimin e bashkëveprimit për rritjen e aftësive kundër terrorizmit, veprimtaritë në planëzimin e çështjeve civile në situata të jashtëzakonshme dhe nxitjen e krijimit të një forumi bashkërendues për formulimin e platformës së shkëmbimit të informacionit që lidhet me sigurinë.

Aleanca jep këshilla dhe ekspertizë për rikualifikimin e ushtarakëve të nxjerrë në lirim, në suazën e reformimit të strukturës së forcave në vendet partnere të rajonit. Kjo asistencë ka marrë formën e një projekti të NATO-s, të zbatuar në kuadrin e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore, në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe dhurues të tjerë. Fillimisht u vu në zbatim në Bullgari dhe në Rumani në kohën e përgatitjes së tyre për të hyrë në NATO. Nga mesi i vitit 2002, mbi 5000 oficerë kishin përfituar nga programet e rikualifikimit. Më pas, procesi u zgjerua për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, si në drejtim të Kroacisë, ish-Republikës

Jugosllave të Maqedonisë*, Serbisë e Malit të Zi dhe Shqipërisë. Kjo u ka krijuar mundësinë vendeve të reja anëtare të NATO-s, të cilët patën përfituar nga ky projekt, që të kthehen në dhënës të përvojës ndaj vendeve të tjera partnere. Ndërkohë, pat filluar edhe puna për mbylljen e vendbazimeve ushtarake në Evropën Juglindore dhe shndërrimin e tyre në dobi të nevojave civile.

Në **Pjesën VIII “MARRËDHËNIET NATO-BE”** trajtohet roli i madh që ka luajtur në rritjen e sigurisë rajonale bashkëpunimi institucional ndërmjet NATO-s dhe BE-së. Që me krijimin e tyre, të dy organizatat, kanë ndihmuar në ruajtjen dhe forcimin e sigurisë dhe të stabilitetit në Evropën Perëndimore. Aleanca e ka vazhduar këtë qëllim edhe nëpërmjet zgjerimit të anëtarësimit në të, si dhe të zhvillimit të partneriteteve të tjera. BE-ja ka bërë të mundur rritjen e stabilitetit me anë të mbështetjes dhe integritetit të vazhdueshëm ekonomik dhe politik, fillimisht ndërmjet vendeve evropianoperëndimore dhe më pas, duke mirëpritur në gjirin e vet edhe vende të reja anëtare. Si rrjedhojë e proceseve të zgjerimit të organizatave përkatëse, një numër i madh vendesh evropiane janë bërë pjesë e rrjedhës qendrore të zhvillimit politik dhe ekonomik evropian. Shumë prej tyre janë tashmë anëtarë të të dyja organizatave.

Deri në vitin 2000 nuk ekzistonin marrëdhënie zyrtare midis NATO-s dhe BE-së. Më përpara, gjatë viteve '90, Bashkimi Evropian Perëndimor (BEP) shërbente si një hallkë ndërlidhëse për bashkëpunimin midis NATO-s dhe atyre vendeve evropiane që kërkonin të krijonin një identitet më të fortë të sigurisë dhe mbrojtjes evropiane brenda NATO-s. Situata ndryshoi rrënjësisht më 1999 kur, përkundër sfondit të konflikteve në Ballkan, drejtuesit e BE-së vendosën të zhvillojnë, brenda vetë BE-së, një Politikë të Sigurisë dhe Mbrojtjes Evropiane në bashkërendim me NATO-n dhe të marrin përsipër përgjegjësinë për shumicën e funksioneve që ishin ushtruar nga BEP-i. Në vitin pasues, të dy organizatat filluan të punojnë së bashku për krijimin e një strukture për bashkëpunim dhe këshillim. Kjo çoi në zhvillimin e një

partneriteti strategjik (Deklarata mbi Politikën e Sigurisë dhe Mbrojtjes Evropiane NATO-BE midis dy organizatave dhe në miratimin e marrëveshjeve Berlin Plus, të cilat sigurojnë mundësinë e shfrytëzimit të mjeteve dhe aftësive të përbashkëta të NATO-s për operacionet ushtarake të drejtuara nga BE-ja. Këto zhvillime krijuan bazën për bashkëpunimin NATO-BE në sferën e administrimit të krizave në Ballkanin Perëndimor, si dhe për zhvillimin e bashkëpunimit në çështje të tjera.

Nëpërmjet shkëmbimeve të informacionit për veprimtaritë e tyre përkatëse, këshillimeve dhe lidhjeve në nivel ekspertësh e shtabesh dhe mbledhjeve të përbashkëta, të dy organizatat po punojnë bashkërisht për çështje të tilla, si: lufta kundër terrorizmit, përhapja e armëve të dëmtimit në masë (ADM), situata në Moldavi, problemet e Mesdheut dhe bashkëpunimi në Afganistan. Fusha të tjera shkëmbimi informacioni dhe bashkëpunimi përfshijnë mbrojtjen e popullsisë civile nga goditjet kimike, biologjike, radiologjike e bërthamore dhe planëzime të tjera të çështjeve civile në situata të jashtëzakonshme dhe të atyre që kanë lidhje me ADM-të. Herë-herë bashkëpunimi mund të përfshijë pjesëmarrjen e dyanshme në stërvitje.

Në Pjesën IX “KUADËR MË I GJERË INSTITUCIONAL PËR SIGURINË” është përshkruar bashkëpunimi institucional ndërmjet NATO-s dhe Kombeve të Bashkuara, Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Kombet e Bashkuara (KB) përbëjnë thelbin e kuadrit të gjerë institucional brenda të cilit vepron Aleanca. Ky parim mishërohet në traktatin themelues të NATO-s. Vitet e fundit, marrëdhëniet midis midis NATO-s dhe KB-së janë rritur në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha nivelet, si nga ana konceptuale dhe politike, ashtu dhe nga ajo institucionale.

Ndonëse lidhja zyrtare midis KB-së dhe NATO-s ruan një bazë të fortë për sa i përket dokumentacioneve themelore që prej krijimit të Aleancës më 1949, marrëdhëniet e punës mes institucioneve të tyre mbetën të kufizuara për pjesën më të

madhe të asaj kohe. Situata ndryshoi më 1992, në pragun e përhapjes së konfliktit në Ballkanin Perëndimor, ku rolet e tyre përkatëse, në administrimin e krizës, çuan në një rritje të bashkëpunimit praktik midis dy organizatave.

Që prej fillimit të konfliktit në Kosovë më 1998 dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së krizës, u mbajtën lidhje të ngushta ndërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së dhe Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s. Aleanca ndërmoi veprime në mbështetje të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të KB-së, si gjatë dhe pas konfliktit. Më 2000 dhe 2001, bashkëpunimi i frytshëm midis NATO-s dhe KB-së çoi në kufizimin e mosmarrëveshjeve të mprehta etnike në Serbinë Jugore dhe në shmangien e shpërthimit të një lufte të hapur civile në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë* dhe, kohët e fundit, ky bashkëpunim ka luajtur një rol të rëndësishëm në Afganistan dhe në Irak.

Për forcimin e paqes dhe të stabilitetit në zonën evropatlantike janë përcaktuar role dhe funksione përplotësuese midis NATO-s dhe Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE). Të dy organizatat, që prej viteve '90, shkëmbejnë rregullisht ide dhe kërkojnë të përplotësojnë veprimtaritë e njëra-tjetrës në çështjet me interes të përbashkët, si administrimi i krizave, sigurimi i kufirit, çarmatimi, terrorizmi dhe nismat ndaj rajoneve të veçanta. Ato synojnë të bashkërendojnë përpjekjet e tyre në fusha të tjera. Nismat e marra nga Aleanca në fusha të tilla si, kontrolli i armëve, spastrimi i minave, asgjësimi i rezervave të municioneve dhe përpjekjet për kontrollin e përhapjes së armëve të vogla dhe armatimeve të lehta, përputhen me përpjekjet e OSBE-së për parandalimin e konfliktit dhe për rivendosjen e stabilitetit pas tij.

Aleanca dëshiron të thellojë marrëdhëniet e saj me organizatat e tjera ndërkombëtare në mënyrë që të shkëmbejë informacion dhe të nxisë veprime të përshtatshme dhe të frytshme në fushat me interes të përbashkët. Ajo kryen këshillime dhe është e përfshirë në forma të ndryshme të bashkëpunimit me një varg organizatash dhe institucionesh të tjera të rëndësishme ndërkombëtare, si Këshilli i Evropës,

Organizata Ndërkombëtare për Emigracionin, Asambleja e BEP-it, Organizata mbi Ndalimin e Armëve Kimike, etj.

Aleanca bashkëpunon me organizata jo qeveritare dhe parlamentare. Një veprim i tillë ndikon në mirëkuptimin dhe mbështetjen më të gjerë të politikës dhe objektivave të NATO-s. Një nga organizatat më të rëndësishme me të cilat bashkëpunon Aleanca është Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq.

Për të ushqyer mirëkuptimin e ndërsjellë ndërmjet parlamentarëve të Aleancës mbi sfidat kryesore të sigurisë me të cilat përballlet partneriteti transatlantik, është krijuar Asambleja Parlamentare e NATO-s. Diskutimet e saj nxisin zhvillimin e konsensusit mes vendeve anëtare, gjë që ndihmon në procesin vendimmarrës të Aleancës. Asambleja e ka zgjeruar në mënyrë të ndjeshme anëtarësinë e saj me pranimin e shtatëmbëdhjetë vendeve partnere me statusin e delegacionit shoqëruar, ndër të cilët është edhe Shqipëria.

Për mbështetjen e veprimtarive të NATO-s dhe të objektivave të Traktatit të Atlantikut të Veriut ndihmon Shoqata e Atlantikut të Veriut. Synimi kryesor i saj është të informojë publikun për rolin e pazëvendësueshëm që luan Aleanca për ruajtjen e paqes dhe të stabilitetit në Evropë dhe të qartësojë kuptimin e sfidave të kohës së sotme. Shqipëria është pranuar edhe në këtë Shoqatë si anëtare me status shoqëruar.

Pjesa X “PROGRAMET, VEPRIMTARITË, ORGANIZATAT DHE AGJENCITË” adresohet në programet dhe veprimtaritë, që janë edhe mbështetësit kryesorë të frytshmërisë së Aleancës në shumë fusha të ndryshme të planëzimit dhe bashkëpunimit. Ato, së bashku, përbëjnë rendin e ditës së sigurisë të kohës së sotme. Informacion është dhënë për veprimet e mbrojtjes ajrore dhe drejtimin e trafikut ajror e të hapësirës ajrore, armatimin, ndërlikdhjen, edukimin dhe stërvitjen, luftën elektronike, logjistikën, meteorologjinë, oqeanografinë ushtarake dhe standardizimin, të cilat mundësojnë forcat e vendeve anëtare të NATO-s dhe të vendeve partnere që të veprojnë bashkërisht. Informacion është dhënë edhe për veprimtaritë në fushën e

planëzimit të masave për popullsinë civile në rast gjendjeje të jashtëzakonshme dhe zhdukjes së pasojave, për diplomacinë publike dhe programet e informacionit e të ndërlidhjes, si dhe për bashkëpunimin shkencor dhe bashkëpunime në sferat shoqërore e mjedisore, të cilat janë ritheksuar në interes të trajtimit të drejtpërdrejtë të sfidave të reja të sigurisë. Për vetë karakterin e ngushtë dhe të mirëfilltë ushtarak e tekniko-profesional, nuk është ndalur në trajtimin e kësaj pjese, duke gjykuar se nuk do të paraqiste interes të veçantë për rrethin e gjerë të lexuesve që u paraqitet ky përshkrim i përmbledhur i Manualit të NATO-s.

Në **Shtojcën 1** jepet një informacion plotësues për shkurtesat në përdorim të përgjithshëm. Prirja për të shfrytëzuar njësitë leksikore të shkurtuara është një dukuri tipike në shumicën e gjuhëve bashkëkohore, si një nga mënyrat e ngjeshjes e të dendësimit të informacionit për dhënien e një sasive maksimale në njësinë e kohës. Shkurtesat janë pjesë e pandarë e çdo terminologjie, veçanërisht e terminologjisë zyrtare, e sidomos ushtarake.

Në **Shtojcën 2** paraqitet teksti i plotë i Traktatit të themelimit të NATO-s. Traktati, një model i thukëtisë dhe i qartësisë, përgatiti truallin për përshtatjen e Aleancës ndaj gjendjes në ndryshim të vazhdueshëm të sigurisë ndërkombëtare. Në pjesët përbërëse të tij parashikohet mundësia e veprimit dhe elasticiteti në trajtimin e problemeve të reja dhe zbatimin e atyre zgjidhjeve që pasqyrojnë mjedisin në ndryshim. Kjo tej pamësi i ka krijuar mundësitë Aleancës të zhvillohet dhe të vetëpërshtatet ndaj rrethanave të reja gjatë gjithë historisë së saj.

Sipas Traktatit, roli themelor i NATO-s, është mbrojtja e lirisë dhe e sigurisë së vendeve të veta anëtare me anë të mjeteve politike dhe ushtarake. Marrëdhëniet ndërmjet vendeve aleate të Amerikës së Veriut dhe të Evropës janë themeli i NATO-s. Këto vende respektojnë të njëjtat interesa dhe vlera jetësore dhe angazhohen për ruajtjen e parimeve demokratike, duke e bërë të pandashme sigurinë e Evropës dhe të Amerikës së

Veriut. Të gjitha vendet anëtare të NATO-s janë barazisht të përkushtuar ndaj kushteve të Traktatit të Atlantikut të Veriut.

Kombet e Bashkuara përbëjnë thelbin e kuadrit të gjerë institucional brenda të cilit vepron Aleanca. Në parathënien e Traktatit, nënshkruesit kanë bërë të qartë se Karta e KB-së përbën mburojën brenda së cilës funksionon Aleanca dhe ripohojnë besimin e tyre në qëllimet dhe parimet e Kartës. Në Nenin 1, ata marrin përsipër të zgjidhin mosmarrëveshjet ndërkombëtare me mjete paqësore dhe t'i shmangen kërcënimit, apo përdorimit të forcës të çfarëdo mënyre, në mospërputhje me qëllimet e Kartës.

Neni 5 i Traktatit i referohet në mënyrë të qartë Nenit 51 të Kartës, që mbron të drejtën e anëtarëve për të ndërmarrë, në mënyrë vetjake apo të përbashkët, veprime që i gjykojnë të nevojshme për vetëmbrojtjen e tyre. Kjo përfshin edhe përdorimin e forcave të armatosura. Për më tepër, ai i ngarkon vendet anëtare që të ndalojnë çdo lloj sulmi të armatosur dhe të gjitha veprimet e ndërmarra si rrjedhojë, nëse vetë Këshilli i Sigurimit të KB-së ka marrë masat e duhura për të rivendosur dhe për të ruajtur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Një pikë tjetër referimi ndaj Kartës mund të haset në Nenin 7 të Traktatit. Në të theksohet se Traktati nuk ndikon dhe nuk duhet të interpretohet në asnjë mënyrë sikur ndikon në të drejtat dhe detyrimet e aleatëve ndaj Kartës dhe ripohon përgjegjësinë kryesore të Këshillit të Sigurimit për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare.

Baza për bashkëpunimin ekonomik brenda Aleancës është Neni 2 i Traktatit të Atlantikut të Veriut. Në të theksohet se vendet anëtare “do të synojnë të mënjanojnë konfliktin në politikat e tyre ekonomike ndërkombëtare dhe do të nxisin bashkëpunimin ekonomik midis cilësdos prej tyre ose të gjithave së bashku “.

Klauzola për zgjerimin e NATO-s është përfshirë në Nenin 10 të Traktatit. Ky nen përbën bazën e politikës së dymëve të hapura, të përshtatur nga Aleanca në lidhje me pranimin e vendeve të reja anëtare. Vendimet mbi ofrimin e ftesave për të filluar bisedimet për hyrje në Alancë, merren bashkërisht nga të gjithë anëtarët ekzistues.

Dhe së fundi, një klauzolë në Nenin 12 të Traktatit, parashikon rishikimin e tij pas dhjetë vitesh ose në çdo kohë paskëtaj, nëse ndonjëra nga palët e kërkon një gjë të tillë. Në të përcaktohet se rishikimi do të kryhet në dritën e zhvillimeve të reja që ndikojnë në paqen dhe sigurinë e zonës së Atlantikut të Veriut, duke përfshirë edhe zhvillimin e marrëveshjeve botërore dhe rajonale në kuadrin e Kartës së KB-së.

Traktati i Atlantikut të Veriut hyri në fuqi më 24 gusht 1949 dhe është me një kohëzgjatje të pakufizuar. Asnjë nga palët në të nuk ka kërkuar rishikimin e Traktatit sipas Nenit 12. Kjo edhe për faktin se në çdo fazë të zhvillimit të vet, Aleanca e ka shqyrtuar në vijimësi zbatimin e Traktatit për të siguruar realizimin e objektivave të tij.

Në përmbyllje mund të arrihet në përfundimin se si një organizatë ndërqeveritare, me vlera të përbashkëta, me vendosmëri të njësuar për mbrojtjen e secilit anëtar dhe me ndërmarrjen e atyre masave që thellojnë aftësitë e domosdoshme dhe shfrytëzimin e tyre kurdo dhe kudo që të jetë e nevojshme, Aleanca është në gjendje të përqendrohet në sfidat e sotme të sigurisë. Operacionet që ajo po drejton në Ballkan dhe Afganistan dhe për të tjera ku po jep ndihmesë, si në Irak dhe në Darfur, të ndërthurura me fuqinë në rritje të partneriteteve të veta dypalëshe e shumëpalëshe, me vendet jashtë NATO-s dhe me organizata të tjera, tregojnë efektshmërinë e saj të vazhdueshme.

Roland Tashi

SIGURIA, E NEVOJSHME KUDO, E DOMOSDOSHME PËR TË GJITHË

Në terminologjinë e përditshme, me termin ‘siguri’, apo sigurim siç jemi mësuar tradicionalisht ta dëgjojmë këtë term, kuptojmë qëndrueshmëri, një proces të sigurt që operon normalisht sipas një destinacioni të caktuar, qetësi si dhe garancinë e të qenurit i mbrojtur. Shërbimi i sigurimit, jashtë konceptit tradicional dhe tashmë të fiksuar të këtij termi, ka të bëjë pikërisht me organizimin, ruajtjen, vështrimin e parashikimin me qëllim parandalimin e një situatë jo normale për të cilën është i interesuar një individ apo subjekt i caktuar. Për këtë natyrë shërbimi janë të interesuara jo vetëm strukturat shtetërore, ku dallojnë ato me rëndësi të veçantë ekonomike, por edhe bizneset, të cilat tashmë janë kthyer në subjekte vitale për zhvillimin ekonomik të vendit.

Në rast se kthehemi shumë përpara në histori, deri në epokën e gurit, në piramidën e hierarkisë së nevojave të njeriut, nevoja për të qenë i mbrojtur dhe i sigurt ndodhet në vendin e dytë të piramidës grafike vertikale, pas domosdoshmërisë për t’u ushqyer e veshur. Pra, siguria ka patur një pozicion të lartë në këtë vendosje.

Nevoja për siguri në mbijetesë, për siguri në mbrojtjen e produkteve që në fillimet e hershme të veprimtarisë së njeriut e deri në ditët tona, ku tashmë natyrshëm përdoret shprehja, mbrojtja dhe siguria e bizneseve, ka qenë gjithmonë një kërkesë konstante, e cila është zhvilluar, përsosur e përshtatur në koherencë me zhvillimet shoqërore dhe ekonomike.

Masat e marra nga sipërmarrjet e mëdha private, kryesisht ato me veprimtari ekonomiko-financiare ku më evidente janë sipërmarrjet bankare, për mbrojtjen e aktivitetit të tyre u bënë shumë të nevojshme e gati të domosdoshme, sidomos pas

Luftës së Dytë Botërore, kjo pasi në këtë periudhë strukturat shtetërore që duhet të garantonin siguri e normalitet në jetën e përditshme dhe zhvillimin e bizneseve ishin inefficente dhe gati nuk funksiononin. Paaftësia e organeve shtetërore, të cilat duhet të impenjoheshin me problemin e sigurimit të qytetarëve dhe bizneseve të tyre, e shpuri Evropën në zhvillime të ngjashme si në Amerikë, ku ndryshimet sociale të shoqëruara edhe me rritjen e kriminalitetit, kondicionuan dhe favorizuan krijimin e strukturave të sigurimit të pavarura nga shteti. Strukturat e sigurimit e mbrojtjes që vepronin brenda institucioneve me rëndësi të veçantë ekonomike si dhe në biznese të fuqishme private, organizoheshin me parimin se “parandalimi ka kosto më të favorshme se pasoja”.

Koncepti i sigurimit të vendeve evropiane si pasojë edhe e bizneseve të tyre, ndryshoi së bashku me zhvillimet gjeopolitike të viteve '90, periudhë e cila shënoi fundin e Luftës së Ftohtë, bashkimin gjerman, shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, etj. Në kuadër të vendimeve të Traktatit të Maastrichtit më 1992, politika e sigurimit të përbashkët, përbënte kolonën e dytë mbështetëse të Bashkimit Evropian. Tashmë që një pjesë e madhe e Evropës vepron me rregulla të përbashkëta ku edhe bizneset kanë një ndërthurje të aktivitetit të tyre, siguria nuk është e mjaftueshme të jetë efikase vetëm në zonën ku ato kanë veprimtarinë kryesore, por më gjerë, në të gjitha ato vende ku është shtrirë dhe zhvillohet ky biznes.

Pas viteve '90-të, me riaktivizimin e pronës private dhe zhvillimin gradual të ekonomisë së tregut, koncepti i sigurimit të pronës dhe biznesit në tërësi filloi të bëhej prezent dhe i nevojshëm edhe në Shqipëri. Instituti Shqiptar i Marrëdhënieve Publike, në një studim të tij, vëren se klima e sigurisë së biznesit në Shqipëri deri tani nuk është e favorshme. Studimi zbulon se në përgjithësi biznesmenët shqiptarë ndihen fatalistë për rrethanat e sigurisë ku zhvillojnë aktivitetin. Për këtë arsye, për të rritur apo ruajtur shkallën shoqërore të lidhjeve të tyre biznesmenët harxhojnë për ruajtjen e sigurisë ndoshta më shumë në mënyrë të tërthortë, sesa kur blejnë drejtpërdrejt shërbimet e sigurisë nga shoqëritë e specializuara.

Biznesi vendas mendon se pasja e një rrethi të fortë fisnor e shoqëror është një parapritë për rreziqet abuzive e kriminale. Gjatë 14-15 viteve të fundit në vendin tonë përgjithësisht kanë qenë më të suksesshëm biznesmenët që kanë një sistem lidhjesh të fuqishme fisnore, shoqërore e miqësore dhe jo më të aftët profesionalisht apo ata me iniciativë. Biznesmenët që kanë mbijetuar gjatë viteve të trazuara të tranzicionit shqiptar, shpeshherë kanë hequr dorë nga shumë të drejta të ligjshme, ata u janë shmangur marrëdhënieve që mund të provokonin konflikte në dëm të interesave të tyre ekonomike, kanë ulur çmimet për klientët problematikë për të zbutur fuqinë e tyre kriminale, etj. Edhe shpenzime të tilla të tërthorta mund të përlogariten si pjesë e kostos së sigurisë.

Siguria po bëhet fjalë kyç për biznesin, ndoshta më shumë sesa korrupsioni apo presioni politik, siguria e ulët nënkupton një rrezik të drejtpërdrejtë dhe me peshë vitale në çdo vendimmarrje biznesi, e madhe apo e vogël qoftë ajo. Baza për të konceptuar një sistem sigurimi apo mbrojtje, është pasojë e analizës së detajuar të elementëve dhe funksioneve të rrezikuara nga specialistë të përgatitur të kësaj fushe, të cilët servirin studimet dhe produktet e tyre. Konceptimi adekuat i sigurimit dhe mbrojtjeve të pjesshme, sjell organizimin e përgjithshëm të mbrojtjes. Sa më e gjerë të jetë baza e analizës së faktorëve, ngjarjeve eksperiencave të mëparshme apo atyre bashkëkohore, aq më cilësor bëhet organizimi dhe funksionimi i strukturave që do të impenjohen me problemet e sigurimit. Koncepti i shërbimit të sigurimit në të vërtetë është përpjekje për të arritur atë gjendje, të cilën do ta quanim apo konceptonim të parrezikshme. Rrezikun apo pasigurinë, mund ta kualifikojmë në dy grupe, në *rrezik aktiv*, i cili kushtëzohet nga veprime të qëllimshme, si sabotazh, thyerje, grabitje, eksplozion dhe *rrezik pasiv*, që ka për shkak gabimet njerëzore si zjarr, aksidente në punë, gabime elektrike, etj. Sigurimi, si efekt përfundimtar ka patur dhe do të ketë njeriun, mbrojtjen e tij nëpërmjet përcaktimit të rreziqeve dhe eliminimin e tyre nëpërmjet një organizimi të përshtatshëm shoqëruar me masa efektive.

Shërbimi i sigurisë është tepër specifik dhe shumë i nevojshëm në fushën e biznesit bankar, apo bankat e nivelit të

dytë dhe ai është i domosdoshëm të organizohet me struktura të plota në bankat qendrore. Strukturat e sigurisë janë të nevojshme të veprojnë në banka, pasi në këto biznese paraja përbën mjetin dhe qëllimin kryesor të veprimtarisë. Në këto kushte, bankat fillojnë të bëhen objekt studimi nga krimi me qëllim kryerjen e veprimeve abuzive, veprime të cilat shoqërohen jo vetëm me tendenca për grabitje, por edhe me kërcënime të jetës së personelit.

Strukturat e sigurimit në bankat qendrore bashkëpunojnë shumë ngushtë me organet e specializuara të shtetit për të gjitha ato probleme që paraqesin rrezik për ekonominë dhe popullsinë e vendit, probleme të cilat në rast se nuk identifikohen, ndiqen dhe zbatohen në kohë, mund të krijojnë premisa për shqetësime të mëdha sociale. Shumë të rëndësishme midis këtyre problemeve janë tentativat për falsifikimin e parave dhe hedhjen e tyre në qarkullim nëpërmjet sistemit bankar, dëmtimi i venddepozitimeve të vlerave monetare, dëmtimi apo shkatërrimi i të dhënave informatike në dhomat e serverëve kompjuterikë, etj.

Si kuptohet termi “sigurimi bankar”, çfarë mëdyshjesh ka rreth këtij shërbimi dhe strukturave që punojnë për të?

Në kohën që jetojmë, termi “shërbimi i sigurimit”, pavarësisht nga objekti specifik i veprimtarisë së tij, nuk jep të njëjtin perceptim mbi këtë shërbim në vende dhe shoqëri me eksperiencën dhe të kaluara të ndryshme historike. Ndjesi jo normale shkakton përmendja e këtij shërbimi, sidomos kur ai përdoret në vende me përvoja të tejzgjatura diktatoriale ku “shërbimet e sigurimit” përbënin një nga mjetet dhe mënyrat represive të qeverisjes.

Kushdo që flet për “sigurinë”, kupton një raport të brendshëm ose të jashtëm, kjo në vartësi të nivelit intelektual, nivelit shoqëror dhe nivelit ekonomik të individit si dhe stabilitetit politik të vendit ku jeton. Në këtë këndvështrim, ata që përdorin këtë term jo gjithmonë marrin të njëjtin

përfytyrim apo krijojnë të njëjtën ide. Qytetari zviceran apo suedez, në kontaktin e parë me fjalën “sigurim” kuptojnë kryesisht përdorimin dhe shfrytëzimin e pashqetësuar të mirëqenies së krijuar apo asaj të trashëguar, ndërkohë që qytetarë italianë, spanjollë e portugezë kuptojnë sigurinë sociale, ndërsa anglezët, të ndjeshëm nga zhvillimet e politikës botërore, kuptojnë problemet dhe shqetësimet që mund t’u shkaktohen nga politikat e sigurisë.

Siç dihet, termi “shërbimi i sigurimit” shkakton shpesh jehona të pakëndshme në banka, kur ky shërbim këtu plekset dhe gati njësohet me shërbimet informative të shtetit në tërësi duke krijuar hamendje edhe për lidhje midis këtyre dy shërbimeve. Në të vërtetë, kujtimet e hidhura mbi shërbimet e sigurimit të ngacmojnë kujtesën dhe të çojnë në shërbimet më drithëruese të njerëzimit, në shërbimet informative të Luftës së Dytë Botërore, në shërbimet sekrete të Evropës Lindore apo vendeve të tjera diktatoriale, shërbime të cilat kanë lënë kujtime e ngjarje për njerëzimin, të cilat ende nuk janë harruar.

Në rast se koncepti i shërbimeve të sigurimit, apo shërbimeve sekrete siç njihen ndryshe, vendoset e vëzhgohet në raport me ngjarjet historike apo regjimet politike, sot koncepti dhe objekti i punës se tij ndryshon. Sot ekzistojnë të gjitha mundësitë për ta njohur këtë shërbim, për të zbardhur zonat “gri” të tij që ndokush mendon se ekzistojnë ende, për ta ndihmuar atë nëpërmjet zbatimit korrekt të procedurave dhe rregullave të vendosura.

Në banka, mund të mendohet dhe aludohet për përgjime, për vëzhgime e regjistrime, apo për hamendje të tjera negative pasi këtu ka të instaluar sisteme vëzhgimi dhe regjistrimi elektronik, të cilat janë vendosur për një qëllim krejt tjetër. Për të qenë të “kujdesshëm”, një kategori e caktuar nuk preferon që me specialistë të këtij shërbimi të vendosë marrëdhënie, duke mbajtur të fshehur brenda vetes një ndjenjë mosbesimi e pasigurie. Përgjithësisht, nuk ndihen mirë nga prezenca e punonjësve të sigurisë në banka dhe objekte të tjera ku veprojnë këto struktura, punonjës e klientë, të cilët i mundon një ndjenjë e brendshme, kanë predispozita për të

mos qenë korrekt me institucionin ku punojnë, nuk e meritojnë plotësisht pozicionin që mbajnë, kanë tendenca abuzive gjatë ushtrimit të detyrës jo vetëm në raport me parandë, por edhe me praktika të tjera administrative dhe etike të institucionit. Pikërisht kjo gjendje i shqetëson madje i shoqëron ideja se problematikat e tyre, parregullsitë dhe tendencat e fshehura janë objekt i punës apo vëzhgimit të punonjësve të sigurimit, të cilët mund ta përdorin këtë “informacion”, në një kohë dhe vend të disfavorshëm për ta. Ka, gjithashtu, elemente ende të paorientuar dhe pa përgatitjen e duhur intelektuale, të cilët edhe pas 16 vjetësh që jetojmë në regjimin demokratik, iu kanë mbetur në kokë njolla “gri” dhe strukturat që shërbejnë për sigurinë dhe mbrojtjen e objektit i shikojnë vetëm me këtë ngjyrë.

Strukturat e sigurimit në banka duhet të veprojnë vetëm mbi akte normative, rregullore e udhëzime tepër transparente të miratuara nga bordet drejtuese. Këto struktura si dhe sistemet elektronike që ato disponojnë, nuk duhet të përdoren për të kryer detyra jashtë atyre të parashikuara në aktet e mësipërme. Strukturat e sigurimit nuk mund të bëhen “palë” me individë, ato kryejnë detyrat e tyre duke mbajtur marrëdhënie me drejtuesin e institucionit, si dhe duke raportuar periodikisht në bordet dhe këshillat drejtuese.

Shërbimi i sigurimit të mbrojtjes, organizohet në bankat qendrore si dhe në bankat tregtare, apo bankat e nivelit të dytë, siç emërtohen ndryshe, me një qëllim kryesor: organizimin, drejtimin dhe realizimin e REmbrojtjes së bankës, duke garantuar krijimin e kushteve të punës për personelin si dhe klientët që hyjnë në ambientet e saj në mënyrë që banka të funksionojë normalisht dhe të realizojë objektivat e caktuara.

Shërbimi i sigurimit e mbrojtjes në bankat qendrore dhe ato të nivelit të dytë, nuk ka të bëjë aspak me “shërbimet e sigurimit”, me “zonat e errëta” ku vepronin këto shërbime apo me mjegullën e “sekretit të jashtëzakonshëm” që i mbulonte dhe shoqëronte ato. Veprimtaria e shërbimit të sigurimit në banka është transparente, e mbështetur vetëm në rregullore e vendime të bordeve drejtuese me të cilat mund të njihet kushdo që është i interesuar, madje edhe nëpërmjet

botimeve apo shfrytëzimit të faqeve elektronike të këtyre bankave. Shërbimi i sigurimit përmbush një detyrë të përcaktuar si të gjitha strukturat e tjera të bankës qendrore apo bankave të nivelit të dytë, para së gjithash ai vendos rregulla dhe organizon veprimtarinë e tij në mënyrë që drejtuesit e institucionit si dhe kolegët të jenë të sigurt dhe të parrezikuar gjatë punës së tyre, punonjësit e bankës që veprojnë në sportele si dhe klientët që veprojnë me vlera të mëdha monetare të ndihen të mbrojtur brenda ambienteve të bankës. Shërbimi i sigurimit kujdeset para së gjithash që vlerat monetare të jenë të mbrojtura e të sigurta në vend-depozitimet e tyre si dhe gjatë lëvizjes e qarkullimit në objekte të tjera bankare.

Sigurimi në bankat e nivelit të dytë nevojitet që shërbimet dhe produktet e bankës t'i afrohen klientit apo subjekteve të interesuara në mënyrë të vazhdueshme e pa shqetësime si dhe njëkohësisht banka dhe bashkëpunëtorët e saj të zhvillojnë bizneset e tyre në kushte të favorshme. Niveli i sofistikimit të sistemeve elektronike si dhe aplikimi në vazhdimësi i teknologjive bashkëkohore, konceptimi dhe mënyra e organizimit të strukturave që do të punojnë për këtë qëllim, bashkëveprimi i këtij shërbimi me shërbime analoge private e shtetërore, vlerësohet dhe është gjithmonë në vartësi të shkallës së kërcënimit dhe rrezikut që i paraqitet bankës.

Për përgatitjen e materialit u shfrytëzuan:

- Studime të Institutit Shqiptar të Marrëdhënieve Publike
- Botime të PESC-së (Politika e Jashtme e Sigurisë së Përbashkët Evropiane)
- Publikime të Bankës së Shqipërisë
- Botime të bankave të nivelit të dytë që veprojnë në Shqipëri

Roland Tashi në vitet 1994-2007 ka punuar në Departamentin e Sigurimit dhe Mbrojtjes së Bankës së Shqipërisë. Aktualisht është i angazhuar në një sipërmarrje private, objekti i së cilës është mbrojtja dhe sigurimi nëpërmjet pajisjeve elektronike.

ENGLISH SUMMARY

Albanian perceptions on NATO integration

By *Gjergji Vurmo* and *Enis Sulstarova*

The article presents the main finding of a survey conducted by IDM in the main 10 cities of the country, in the period March-May 2007 on the Albanian perceptions on NATO integration. The survey data reveal quite interesting findings about respondents' perceptions on NATO integration, the country's progress in this process, as well as their acquaintance with and support to this process. The survey analysis shows that there exist no "clashes" between different age generations, i.e. respondents' views and perceptions preserve the same tendencies even within different age groups. Furthermore, respondents from all the categories seem to be quite optimistic regarding specific conditions that Albania must meet in order to become a NATO member – i.e. they would support "what's necessary" for Albania to become a NATO member.

Representation of the military as a form of "trade unionism" in the Italian Armed Forces

By *Col. Skënder Kadiu*

The article looks into the phenomenon of the organization of the military within their profession to advance common interests. In the first part of the article the author explains the motives behind the trends of "military unionism", and compares it with the similar trends in other trades at the same times. Emphasizing the peculiarities of the military profession that determine the nature of their professional representation, then the author looks closer at the history, or-

ganization and some of the activities of the military representation associations in the Italian Armed Forces.

The German Military Association

By *Arben Zani*

The author makes an overview of the way the German military are represented within their trade. The right military to better organize in order to present their interests was acknowledged to the German Armed Forces in the Basic Law of the Federal Republic. The association defends the principle of the “citizen in uniform”, i.e. protects the human and citizen rights of the military and internally organized according to the democratic principles.

NATO Decisionmaking: How the ‘Consensus Rule’ Works

By *Leo Michel*

NATO decisions are the expression of the collective will of its member governments. Under the rule, no Ally can be forced to approve an action against its will. Consensus rule allows NATO to respect distinctive national legislation. Through the rule, NATO can build political and military solidarity. The consensus rule forces Allies to undertake the widest possible consultations to build support for their ideas.

Rethinking human security (II)

By *Gary King and Christopher J. L. Murray*

The authors note that many attempts to ensure the territorial security of nation-states through military power have failed to improve their total human condition. In response, the international community has moved to combine economic development with military security and other basic human rights to form a new concept “human security”. Unfortunately, by common assent the concept lack a clear definition or any agreed upon measure of it. The authors in this article address this issue.

Recommendations for improving democratic leadership and control of security sector

By *UNDP & DCAF*

These recommendations are directed to parliamentarians, NGOs and international community. They aim to support those countries that with build and maintain the sustainability of the democratic control of the security sector. The recommendations are based on the principles abstracted from the best practices of the reforms in the security sector and on the local ownership approach.

Enhancing the knowledge on NATO through the latest publication of the NATO's Handbook

By *Kudret Mita*

For better informing the Albanian public on NATO, in this crucial period in the integration process of Albania, this article reviews the NATO Handbook. This publication by NATO Public Diplomacy Division delineates in a comprehensive way the activities of the Alliance till the recent time.

Security is necessary everywhere and for all

By *Roland Tashi*

Based on his work experience with the security sector in the private companies inn Albania, the author argues that security is an integral part of the business climate. He emphasizes the preventive aspects of contemporary security measures, which guarantee the normality and smoothness of business operations, and enhance the confidence of the clients to the firms. Defending the principle that “prevention is less costly than the consequences”, the author wants to eradicate the often fatalist conceptions of the Albanian businessmen concerning the security climate where they operate. Security, against both passive and active threats, must be trusted to the specialists who use the latest high security technologies, as the example of “bank security” demonstrates.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
ÇËSHITJE TË SIGURISË - 4

Formati: 15,5x24 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tël: (4) 240116
Tiranë, 2007